

1 E mërkurë, 16 nëntor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.15

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kam një
12 urdhër të shkurtër me gojë që kam për të bërë që ka të bëjë me
13 dëshmitarët që ZPS-ja synon që të thërrasë për të dhënë
14 dëshmi.

15 Trupi Gjykses i kujton ZPS-ja detyrimin sipas paragrafit
16 73 për Urdhrin Për Zhvillimin e Procesit Gjyqësor sa i takon
17 njoftimit të dëshmitarëve që ZPS-ja synon që të thërrasë për
18 periudhën tre mujore në vijim.

19 Duke marrë parasysh këtë Trupi Gjykses urdhëron ZPS-në që
20 të dorëzojë një listë të dëshmitarëve që synon që të thërrasë
21 që të japin dëshmi gjatë periudhës janar deri në mars 2024, jo
22 më vonë sesa të enjten, më datë 14 dhjetor 2023.

23 Ky është fundi i urdhrin me gojë.

24 Tjetër, sa i takon çështjes që ngrihet nga Mbrojtja e z.
25 Veseli për vetëinkriminimin potencial të Dëshmitarit 04765.

1 Trupi Gjykses dëshiron që të qartësojë sa më poshtë.
2 Trupi Gjykses rikujton që gjatë intervistës me ZPS-në, ZPS-ja
3 në seancën përgatitore të saj, e ka informuar dëshmitarin që
4 ai konsiderohet si i dyshuar. Gjatë intervistave dhe gjatë
5 seancave përgatitore, ai gjithashtu është informuar për të
6 drejtat e të dyshuarit dhe, në veçanti, për të drejtat e tij
7 për të pasur një avokat të pranishëm, ndërkohë që jep dëshmi.

8 Kjo pasqyrohet në transkriptet e intervistës dhe në
9 shënimin përgatitor. Trupi Gjykses konsideron se ZPS-ja ka
10 vepruar në përputhje me procedurën e parashikuar në Rregullore
11 në Urdhrin për Zhvillimin e Procesit Gjyqësor dhe për këtë
12 arsye nuk ka arsye të mëtejshme që të trajtohet kjo çështje më
13 tej nga Prokuroria.

14 Trupi Gjykses dëshiron që të sqarojë dy çështje: Së pari,
15 avokatët mbrojtës janë kompetentë për të përfaqësuar interesat
16 e klientëve të tyre dhe askush tjetër në këto procese
17 gjyqësore.

18 Përgjegjësia për të mbrojtur interesat dhe të drejtat e
19 dëshmitarëve është përgjegjësi e këtij Trupi Gjykses dhe jo e
20 avokatëve mbrojtës. Në qoftë se një palë dëshiron të ngrejë
21 një çështje që ka të bëjë me të drejtat ose statusin e
22 viktimave, duhet që të jepet njoftim paraprak në mënyrën dhe
23 në kohën e duhur dhe me shkrim për palën kundërshtuese dhe për
24 Trupin Gjykses. Sa i takon synimit për të ngritur një çështje
25 të tillë dhe duhet që të jepen gjithashtu dhe hollësi të

1 përshtatshme për çështjen për të cilën dëshirojnë palët që të
2 ngrenë shqetësimin e tyre.

3 Znj. Sekretare e seancës, a ju duhet që të bëni
4 korrigjime të tjera të më tejshme në deklaratë sa i takon
5 dokumenteve të cilat janë dorëzuar nga z. Kehoe?

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni,
7 mund t'i caktoj numra të provave materiale këtyre dokumenteve.

8 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua të them që
9 nuk kundërshtojmë lidhur me atë çfarë thatë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
11 Kjo u mor vesh.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
13 dokumentet të cilat më përpara kanë qenë të shënuara si prova
14 materiale 1D63 dhe 1D64, z. Kehoe identifikoi që këto ishin
15 versione të redaktuara publike për këto dokumente dhe tani do
16 caktojme numrin e provës materiale 1D63.1 për dokumentin
17 109987 deri në 108990, ndërkohë që do caktohet numri i provës
18 materiale 1D64.1 për dokumentin nga 116768 në 116787.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
20 vazhdojmë më tej tani me dëshminë e Dëshmitarit 04765. Të
21 gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në sallën e gjyqit sot.

22 Znj. Sekretare, ju lutem mund ta sillni dëshmitarin në
23 sallë.

24 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

25 DËSHMITARI: Mirëmëngjes, të gjithëve.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
2 Dëshmitar. Faleminderit që jeni përsëri sot me ne.

3 Sot do të vazhdojmë me pyetjet Mbrojtjeve për ju. Z.
4 Emmerson, do të vazhdojë që t'ju bëj pyetje dhe pasi të
5 përfundojë ai do t'ju bëjnë pyetje avokatët e tjerë.

6 Ju kujtoj që t'i përgjigjeni pyetjeve me fjali të
7 thjeshta dhe të qarta. Në qoftë se nuk e kuptoni pyetjen, mund
8 t'i kërkonit Avokatit që ta përsërisë përsëri apo që ta sqarojë
9 atë më tej.

10 Ju lutem, po ashtu, mbani mend që duhet që thoni bazën e
11 njohurive, fakteve dhe rrethanave për të cilat do të pyeteni.

12 Ju kujtoj që ende jeni në detyrimin për të thënë të
13 vërtetën, siç e keni deklaruar në betimin solemn të bërë
14 përpara Trupit Gjykses.

15 Po ashtu mos harroni që të flisni përpara mikrofonit. Dhe
16 bëni një pauzë të shkurtër rreth sekonda përpara sesa t'i
17 përgjigjeni pyetjes, në mënyrë të tillë që të mos
18 mbivendoseni, të mos flisni në të njëjtën kohë me Avokatin. Po
19 ashtu flisni ngadalë në mënyrë të tillë që të mund t'ju kapin
20 përkthyesit.

21 Nëse e keni të nevojshme të bëni pushime, na e thoni këtë
22 gjë dhe ne do të bëjmë organizimet përkatëse sa më shpejt të
23 jetë e mundur.

24 z. Emmerson, fjala për ju.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar

1 Gjykatës.

2 Z. Veseli, më ka kërkuar që ta bëjë shumë të qartë
3 publikisht që ai nuk ka bërë dhe bën asnjë pretendim fare
4 kundër këtij dëshmitari për çështje të cilat neve i përmendëm
5 dje. Pasi i kam riparë shënimet e mia, më lejoni t'ju them, të
6 nderuar Gjykatës, që nuk kam pyetje të tjera për këtë
7 dëshmitar tani.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe.
9 Kehoe keni dy orë në dispozicion. Duhet të përpiqeni sa më
10 shumë të jetë e mundur.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] E mora mesazhin shumë qartë dje, i
12 nderuar Gjykatës.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E dini që ne
14 jemi të gatshëm t'ju japim pak kohë shtesë në fund në qoftë se
15 keni nevojë, por megjithatë duhet që të bëni më të mirën tuaj
16 për të respektuar këtë afat kohor.

17 DËSHMITARI: W04765 [Vijon]

18 Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe:

19 Z. KEHOE: [Përkthim]

20 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

21 PË. *Good morning* [Në anglisht].

22 PY. Unë jam Gregory Kehor. Jam përfaqësuesi ligjor i z.

23 Thaçi. Më lejoni të theksoj se një prej gjërave, që në fakt

24 jua tha edhe Gjykatësi Smith, po dua ta theksoj edhe një herë

25 tjetër. Nëse nuk e kuptoni pyetjen, në qoftë se pyetja është e

1 paplotë, në qoftë se është e paqartë, ma thoni këtë gjë në
2 mënyrë të tillë që unë të bëj më të mirën e mundshme që ta
3 shpreh dhe njëherë dhe ta sqarojë sa më shumë të jetë e
4 mundur.

5 Një gjë tjetër që ndodh zakonisht është që përgjithësisht
6 kam tendencën që të ndërpres, nuk është synimi im që të
7 ndërpres. Në qoftë se do t'ju ndërpres, ju kërkoj paraprakisht
8 falje. Pra, ju kërkoj falje dhe nuk është qëllimi që të
9 ndërpres sepse është shumë e rëndësishme që ne të dëgjojmë çdo
10 gjë që ti ke për të thënë në përgjigje të pyetjeve të mia. E
11 kuptoni këtë, Dëshmitar?

12 PË. E kuptoj. Faleminderit shumë. E kuptoj drejtë.

13 PY. Në rregull. Nuk do të mbuloj gjithçka që u mbulua dhe dje
14 dhe sigurisht që nuk do të mbuloj gjithçka që është trajtuar
15 në intervistën tuaj, megjithatë më lejoni të them që e kam
16 lexuar me interes librin tuaj, është një pasqyrim shumë i mirë
17 i asaj çfarë ka ndodhur, kështu që do të mundohem që të sqaroj
18 disa prej çështjeve që janë pasqyruar në librin tuaj, si edhe
19 disa prej çështjeve që kanë të bëjmë me provat materiale që
20 janë pranuar këtë proces gjyqësor.

21 Dua që të filloj me disa prej vështirësive që keni pasur.
22 Ju thoni që keni arritur në Budakovë në qershor të 1998 sipas
23 pyetjeve që ju bëri Prokuroria dhe z. Emmerson, disa prej
24 vështirësive i keni përshkruar shumë mirë në librin e shkruar
25 prej jush.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Kështu që për ta parë dhe një herë
2 do i kërkoja Sekretares të paraqesë në ekran dokumentin
3 SPOE00209392. Fillon në faqen 71. Mendoj që numri i referencës
4 është i njëjtë edhe në gjuhën shqipe. Duhet të jetë fillimi i
5 Kapitullit V.

6 PY. Në fillim, i keni thënë ZPS-së, që kjo ishte një ushtri
7 vullnetare e cila përbëhej nga fshatarët e zonave. Megjithatë
8 në këtë paragraf dhe në fakt nuk është se do ta lexoj të
9 gjithin, sepse është shumë domethënës vetë, megjithatë siç e
10 thoni dhe juve:

11 "Gjatë zhvillimit të luftës, situatat ndërroheshin me
12 shpejtësi shumë të madhe. UÇK-së i duhej që vazhdimisht të
13 kalonte mobilizim, organizim dhe ristrukturim të brendshëm.
14 Pasi që ajo nuk ishte e organizuar mirë e as e armatosur sa
15 duhet. Kishte mangësi në ndërlidhje, ishte e papërvojë në
16 vëzhgime, po ashtu pa përkrahje të fuqishme të ndonjë partie
17 politike për t'i planifikuar, ideuar e arsyetuar veprimet
18 luftarake".

19 Dhe i takon që nuk ka pasur as përvojë edhe sa i takon
20 elementeve operative, taktike, të cilat juve i trajtuat dhe në
21 përgjigjen tuaj sa i takon Budakovës. Pjesa tjetër e
22 paragrafit është e qartë. Megjithatë ajo çfarë dua të them
23 është që është e qartë që keni pasur mungesë burimesh,
24 organizimi, strukture dhe mungesë partie politike për t'ju
25 mbështetur apo për të për të përcaktuar, për të planifikuar

1 agjendën për ushtrinë dhe juve thatë që këtë punë e keni bërë
2 ju vet, apo jo?

3 PË. Po, z. Avokat Kehoe. E vërtetë është, ashtu siç e kam
4 përshkru unë në libër. Fillimi ka qenë shumë i vështirë.
5 Përvojat kanë qenë shumë vogla dhe vështirësitë shumë të
6 mëdha.

7 PY. Besoj që e thatë edhe më herët që nuk kishte brigada,
8 batalione, që ishin autonome, e vërtetë kjo?

9 PË. Këto ishin njësitë e para. Fillimisht, kanë dalë si
10 grupe ushtarësh. Pastaj janë bë struktura të niveleve të
11 vogla, skuadra, togje, kompani deri në batalion.

12 PY. Dhe të gjitha këto janë zhvilluar nga njerëz si puna jote
13 që ishit në terren që po mundoheshit që të organizonit
14 struktura --

15 PË. Po.

16 PY. -- apo jo?

17 PË. Nuk duhet thënë që vetëm unë isha i vetëm. Edhe të tjerë
18 rreth meje ishin, po kështu është siç e thoni ju. Siç e thoni
19 ju.

20 PY. Nuk po thojta që ishit i vetmi ju, Dëshmitar, se nuk do
21 isha i saktë po ta thojta këtë gjë. Po ju ishit një ndër
22 personat që mundeshit ta bënit këtë gjë, apo jo, Dëshmitar?

23 PË. Po, është e vërtetë. E vërtetë.

24 PY. Ju keni pasur vështirësi sa i takon drejtimit. Njerëzit
25 vinin e iknin, kishte dhe ca probleme të tjera me disa

1 udhëheqës të tjerë si, për shembull, Blerim Kuqi, a është e
2 vërtetë kjo, Dëshmitar?
3 PË. E vërtetë është. Ashtu siç e ka shkru në libër edhe Jakup
4 Krasniqi, ka pasë një shthurje nga data 22 gusht kur ka qenë
5 ofensive e madhe armike serbe. Kanë fillu të dezertojnë nga
6 UÇK-ja njerëzit, po jo nuk mendoj në asnjë mënyrë që nga
7 frika, por nga misioni i tyre që kanë pasë, siç ishte
8 dezertimi i Tahir Zemës, dorëzimi i armëve. Njëkohësisht ka
9 ikë dhe komanda e brigadës të Suharekës, kanë ndodhë këto,
10 ashtu siç e dini dhe ju.

11 PY. Në fakt, ju keni shkruar rreth të gjithë atyre
12 zhvillimeve në librin tuaj dhe, për shembull, në qoftë se mund
13 të kalojmë tek faqja tjetër e librit që kemi në ekran, ju
14 flisni për sulmet mbi ju dhe të tjerët, duke filluar këtu në
15 fillim të gushtit, flisni për sulmet në zonën e Pashtrikut, në
16 Dukagjin. Do të doja t'i hidhni një sy kësaj pjese të librit.
17 Ju aty në këtë faqe thoni që:

18 "Forcat e okupatorit u hodhën në ofensivë të përgjithshme
19 më 22, 23 gusht dhe 23, 24, 25 gusht dhe patën dhe në fakt
20 mundën shumë prej njësiveve të UÇK-së".

21 Kjo është pjesa e librit që keni shkruar. Pastaj disa
22 rreshta më poshtë ju thoni që, Ramush Haradinaj mbeti me pak
23 ushtarë me rezistencë.

24 Kjo ishte periudhë e vështirë për UÇK-në ndërkohë që po
25 mudohej që të ristrukturohej, ndërkohë që po mudohej të

1 strukturohej duhej që të merreshe dhe me sulmet e forcave
2 serbe, forcave policore serbe e të tjerë, a ka qenë kështu,
3 Dëshmitar?
4 PË. Krejt ashtu ka qenë, siç e thoni ju, z. Avokat.
5 PY. Këto sulme të forcave serbe u përshkallëzuan duke
6 vazhduar më tej në shtator në zonën tuaj dhe në zona të tjera,
7 por kur keni qenë ju në Budakovë në shtator vazhduan sulme të
8 tilla duke shkaktuar dëme të konsiderueshme për UÇK-në, a
9 është kështu, Dëshmitar?

10 PË. Po. Kemi pasë tri beteja në shtator: Njëra ka qenë më 22
11 shtator, tjetra ka qenë më 24 shtator, ku jam plagos edhe unë
12 bashkë me një dëshmor tani është Zaim Muça dhe tjetra ka qenë
13 ofensiva më e madhe e shtatorit më 27 shtator 1998. Kështu që
14 i kemi rezistuar për 12 orë rresht kësaj ofensive të madhe.
15 Pastaj jemi tërheq në pozicionet e dyta dhe kemi vazhdue pas
16 tri-katër dite në riorganizim dhe rigrupim të ushtarëve.
17 Kështu ka qenë.

18 PY. Nuk do e lexojmë të gjithë pjesën, po thjesht disa prej
19 sqarimeve të gjërave që ju i keni lidhur me 27 shtatorin në
20 Budakovë dhe gjetkë, në veçanti me Brigadën 123 që është
21 brigada juaj.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Për këtë do i kërkoja Sekretares të
23 paraqiste në ekran dokumentin SPOE00226697, faqja e parë.
24 Besoj që është i njëjti numër identifikimi dhe në shqip, do
25 kërkoja që të shfaqeshin dy dokumentet në mënyrë që dëshmitari

1 ta kuptojë se për çfarë dokumenti bëhet fjalë.

2 PY. Flitet për një raport kronologjik për organizimin ose
3 jetën ushtarake, organizative dhe luftarake në batalionin në
4 Budakovë. Ky është raporti ky që shikoni përpara në ekran.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Në qoftë se do të shkojmë në faqen
6 11 në versionin në anglisht, që është 226706. Mendoj që ka të
7 njëjtin numër në shqip.

8 PY. Po në qoftë se nuk është i njëjti dokument në shqip,
9 Dëshmitar, na e thuaj këtë gjë të lutem?

10 PË. Mirë është. Mirë është.

11 PY. Është i njëjti? Në rregull. Faleminderit. Në qoftë se do
12 të shkojmë në fund të kësaj faqeve, nuk është se do e lexojmë
13 të gjithë faqen, do lexojmë vetëm paragrafin e fundit, ju këtu
14 flisni për ofensivën serbe të datës 27. Dhe thoni, shtatë apo
15 tetë rreshta në versionin anglisht, nuk e di nëse është e
16 njëjta në shqip apo jo, po ju thoni:

17 "Përjetuam me dhimbje thyemjen e pozicioneve të ushtrisë
18 sonë dhe depërtimin e forcave armike në territoret ku i
19 mbronim me muaj të tërë".

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
21 z. Pace.

22 Z. PACE: [Përkthim] Avokati po konstaton ose konfirmon
23 faktet të cilat nuk janë në prova materiale, kështu që së pari
24 dëshiroj që t'i kërkoj që të japë referencën dhe lidhjen.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Së pari do ta pyes për sulmet.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
2 vazhdoni ashtu, pastaj mund të na jepni referencën.

3 Z. KEHOE: [Përkthim]

4 PY. Ju e njihni këtë dokument, Dëshmitar, apo jo?

5 PË. Po, po. Është shkrimi i jem nga Budakova që e kam
6 përshkru situatën ashtu siç e ka qenë. Dhe krejtësisht është
7 ashtu siç e kuptuat edhe ju, z. Avokat.

8 PY. Po, po këtu flitet "për futjen e ushtrisë, për depërtimin
9 e forcave armike në territor", ju thoni "kemi parë me sytë
10 tanë veprimet barbare, çnjerëzore e të pashembullta sesi
11 armiqtë veprimet barbare të tyre, ndiznit shtëpitë, shtazët
12 dhe bënin veprime të ndryshme makabre mbi popullatën civile të
13 paarmatosur, mbi fëmijë e mbi gra e pleq".

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Vazhdojmë me faqen tjetër.

15 PY. Te paragrafi i parë i faqes tjetër, ju thoni, popullata e
16 Vraniqit ishte e evakuuar. Dhe pastaj, në paragrafin tjetër,
17 thoni që ka pasur shtatë orë granatime nga serbët. Në
18 paragrafin e tretë thoni që:

19 "Këmbësoria ishte në numra të mëdhenj dhe më pas mësuam
20 nga shtypi serb që kishte 20.000 trupa ushtarako-policore dhe
21 mbi 300 mjete të motorizuara, tanksa, autobllinda, maune,
22 Pinzgauer, e tjerë".

23 Kalojmë tek paragrafi tjetër, ku thoni:

24 "Gjatë depërtimit nga Rrokopeqi ishte bë një luftë e
25 ashpër në mes forcave tona dhe atyre armike çka ka bërë dy

1 herë forcat tona të arrijnë të zbrapsen me sukses".

2 Dhe pastaj vazhdoni më tej dhe thoni:

3 "Togu i Buzhalës pas tërheqjes së spitalit dhe popullatës
4 tërhiqet në drejtim të staneve të Vraniqit".

5 A është ky një vlerësim ose përshkrim i situatës siç ka
6 qenë pra situata më 27 shtator në zonën e Budakovës?

7 PË. Është përshkrim real i situatës që ka qenë në atë
8 ofensivë të madhe ku kanë presuar shumë humbje popullata,
9 sidomos civile edhe ne na u kanë vranë katër ushtarë, na u
10 kanë plagos 13 të tjerë. Dhe është e vërtetë që kemi gjet
11 njerëz të djegur të futur në stog të sonës dhe të djegur e të
12 masakruar, shtazë të masakruara, shtëpi të djegura tërësisht.
13 Kështu ka qenë siç është e përshkrume, z. Avokat.

14 PY. Pasi ka ndodhur kjo në gusht dhe në shtator, ju kishit
15 komandant batalioni të tillë si Drini, për shembull, ose Zafir
16 Berisha dhe të tjerët të cilët u larguan? U larguan nga Kosova
17 dhe shkuan në Shqipëri, është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

18 PË. Po kjo ka ndodhur më 2 shtator 3, 4 dhe 5 shtator të
19 1998. Batalioni i Vrinit që a një distancë shumë të madhe me
20 batalionin e Budakovës, ka pasë një betejë atje ku kanë ranë
21 19 dëshmorë, janë plagosë me dhjetëra të tjerë dhe komanda e
22 atij batalioni, njësoj si komanda e brigadës të Suharekës, e
23 kanë pasë më afër kufirin anej të Shqipërisë dhe kanë ikë për
24 Shqipëri. Drini, domethënë, Ekrem Rexha, Zafir Berisha bashkë
25 me 20 të tjerë kanë dalë në Shqipëri. Dhe Drini është kthye në

1 dhjetor 1998. Ndërsa Zafiri diku në mars apo në shkurt 1999.
2 Kështu që janë shkëputë prej lufte. Ne atëherë i kemi quaj
3 dezertorë. Besoj se e kuptut.
4 PY. E kuptova shumë mirë. Pra, ushtarë si puna juaq qëndruan
5 aty, ndërkohë që shumë prej komandantëve të tjerë dhe
6 pjesëtarëve të UÇK-së u larguan dhe dezertuan shkuan në
7 Shqipëri, kështu?
8 PË. Po, z. Avokat. Jam ndër të rrallët që nuk kam dalë asnjë
9 ditë, asnjë orë jashtë fushëveprimeve të luftës. Besoj se e
10 kem edhe Rexhep Selimin. Është njëri prej atyne që s'ka dalë
11 kurrë nga fusha e luftës nga fillimi deri në mbarim.
12 PY. Ndërkohë që kalon koha dhe shkojmë në vjeshtën e 1998
13 dhe, meqenëse ra fjala, ofensiva serbe, përveç krijimit të
14 problemeve për UÇK-në, krijoi dhe probleme për popullatën
15 civile, apo jo, Dëshmitar?
16 PË. Më shumë ishte problemi i popullatës civile sepse i nxori
17 nga shtëpitë, i djegu të gjitha dhe ata me vështirësi i kemi
18 strehu nëpër tenda në përroje, lugina, afër lumenjve dhe i
19 kemi mbrojt në kodrat përreth tyre me çdo kusht, me çdo gjë
20 dhe me jetën tonë i kena mbrojt. Dhe nuk kanë qenë pak. 15.000
21 kanë qenë në Llanishtë, 75.000 deri në 80.000 në Divjakë,
22 Krojmir në atë pjesë, 42.000 në luginën e Pagarushës, 12.000
23 civilë në malet e Panorcit, 8.000 civilë kanë qenë në malet e
24 Domanekut, 5.000 në Kabash. Kështu që mbi 200.000 civilë jemi
25 detyru t'i mbajmë nëpër tenda të strehuar nëpër pyjet tona.

1 PY. Pra, përveç kujdesit ndaj çështjeve ushtarake, ju edhe
2 pjesëtarët që kishin mbetur të UÇK-së, ishit përgjegjës edhe
3 për t'u kujdesur për popullatën civile, apo jo?

4 PË. Ne këtë përgjegjësi ia kemi dhënë vetvetes, se s'ka pasë
5 kush të na bëjë përgjegjës. Sepse vetë kemi qenun në krye të
6 kësaj lufte dhe e kemi ndi moralisht që duhet mbrojtur ajo
7 popullatë e pambrojtur.

8 PY. E kuptoj, Dëshmitar. E kuptoj shumë mirë. Tani le të
9 kalojmë edhe njëherë tek zona operative e Pashtrikut. Ju thatë
10 që Remzi Ademi ishte komandant i parë i zonës dhe ai u vra
11 ditën e parë që u caktua në atë pozitë. Thoni pastaj që
12 komandanti tjetër ishte Musë Jashari dhe ai nuk është se ka
13 bërë gjë të madhe, nuk ka bërë shumë gjë për të riorganizuar
14 gjërat në zonën e Pashtrikut, është e vërtetë kjo, Dëshmitar?

15 PË. Këto janë emërtimet para lindjes së zonave, do të thotë,
16 në gusht 1998 emërtohet Remzi Ademaj komandant i zonës dhe po
17 në atë kohë vritet me një pritë serbe në fshatin Nashec. Pas
18 tina, emërohet Musë Jashari që ta krijojë zonën, ta bëjë zonën.
19 Se jo si komandant këtu ndoshta është edhe e keqinterpretume
20 komandant zone. Ata që janë emëru, janë emëru për ta bë. Jo se
21 ka qenë zona në atë kohë. Nuk ka qenë e kompletume, s'ka qenë
22 e organizume, po është emëru Musë Jashari për ta bë zonën.

23 Ai nuk ka mund të japë kontribut shumë të madh se ka qenë
24 nga një distancë tjetër prej Drenice në Pashtrik. Kështu që
25 ajo ka vazhdu pas Musës, vjen Ekrem Rexha, Drini dhe deri te

1 Tahir Sinani, kur emërohet.

2 PY. Të flasim pak për këtë. Ju thatë që Musë Jashari nuk ka
3 bërë shumë, nuk ka pasë mundësi me bë gjë shumë, Drini është
4 emëru në janar të 1999. Dhe ne kemi parë çështje të brendshme,
5 probleme organizative të brendshme, në qoftë se mund të
6 shprehem kështu, sa i takon aftësisë së Drinit për të
7 komanduar zonën e Pashtrikut, a është kështu, Dëshmitar?
8 PË. Ka qenë një tendencë e këtyne oficerëve të JNA-së të
9 ushtrisë Jugosllavë, që ta marrin nën komandë UÇK-në edhe pse
10 kanë ardhë me vonesë. Kështu që UÇK-ja ka pasë struktura deri
11 tek niveli i brigadave. Brigadat akoma janë kanë të paformume
12 sa duhet. Këta kanë mëndu me emërtimin e komandantëve të
13 brigadave dhe marrjen e komandës nga qendra, ta marrin UÇK-në
14 nën komandim dhe sigurisht do të ishin më duar lirë për
15 pushtuesin për ndonjë marrëveshje të përfundshme, të fundit.

16 PY. Disa nga problemet me komandimin e Drinit që janë
17 pasqyruar në provat materiale të përdorura nga Prokuroria dhe
18 për procesverbal është prova materiale 500, një deklaratë e
19 Halil Qadrakut dhe jua j datë 14 mars 1999.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të na e
21 paraqiste në ekran.

22 PY. E di që e keni parë këtë deklaratë më përpara. Ky
23 dokument pasqyron disa prej problemeve që keni pasur në zonën
24 operative të Pashtrikut me komandant Drinin dhe me të tjerët.
25 Për shembull, në këtë dokument, ju thoni që Drini ka dëshirë

1 për të kontrolluar çdo gjë, që nuk ka plane pune. Nuk ka
2 rregullore për korrespondencën për moralin, pra, çështje që
3 kanë të bëjnë me shërbimin informativ, ose nuk ka rregullore
4 për shërbimin informativ. Pra, këto janë të gjitha çështje ose
5 probleme organizative për të cilat ishit të interesuar apo të
6 shqetësuar ju dhe z. Qadraku, a është kështu, Dëshmitar?
7 PË. Po, z. Avokat. Ne e kemi pa një zbrazëti dhe një mangësi
8 të funksionalitetit mes zinxhirit komandues të brigadave me
9 zonën sepse komanda e zonës ka dashe që të ketë një kontroll
10 në zhvillimin e brigadave dhe njësive mëposhtme. Duke qenë
11 Drini komandant i zonës, as nuk ka raportue, s'kemi mbajtur një
12 kohë briefing [Në anglisht] fare. Nuk janë kanë njohuri
13 departamentet e zonës, drejtoritë e zonës për asnjë ngjarje se
14 çka po ndodh në brigadën tjetër në terren.

15 Duke i emëruar njerëzit si ai ka menduar t'i ketë
16 njerëzit e vetë. Dhe ka menduar sigurisht për ta pasë
17 nënkomandant edhe Shtabin e Përgjithshëm. Ai nuk ka mbajtur
18 informim as mbledhje të rregullta me neve të nivelit të zonës.
19 Dhe kjo letër i kushtohet kësaj natyre pse nuk funksionon
20 raportet mes brigadave, mes zonës dhe brigadave.

21 PY. Atëherë, ju thatë që ndërmjet drejtorive në zonë nuk
22 kishte bashkërendim të punës kur ishte Drini në krye?

23 PË. Ka mungu kjo. Edhe ndoshta ka mungu jo prej natyrës së
24 krejt qëllimshme, po edhe prej paaftësisë për ta vënë në
25 kontroll dhe në funksion këtë natyrë të punës.

1 PY. Dhe gjithashtu, nuk kishte gjykatë ushtarake, për
2 shembull, për ju, për personat në brigadë dhe në zonë që, për
3 shembull, ju të fillonit që të vinit në zbatim disa masa të
4 caktuara në atë zonë, apo jo?

5 PË. Ashtu është, z. Avokat.

6 PY. Një çështje tjetër e cila kishte të bënte me një veçori
7 për sa i përket linjës së komandës, ju keni sjellë edhe një
8 shqetësim i cili gjendet në faqen e dytë. Për sa i përket
9 zinxhirit të komandës, është në faqen e dytë. Por besoj që ju
10 keni fjalën, që besoj se e di edhe në kuptimin e NATO-s që ka
11 vetëm një komandë domethënë.

12 Pra, në paragrafin e dytë, flitet për çështjet që kanë të
13 bëjnë me një lloj zinxhiri të komandës të dublikuar që kishte
14 persona që raportonin ose që merrnin urdhra nga pjesëtarë të
15 qeverisë në mërgim, z. Bicaaj. E shihni atë pjesë?

16 PË. Po, këtu kanë qenë problemet ashtu siç janë të shkruara.
17 Po më dhimbseni ju që duhet trajtu kjo ma gjerësisht dhe ka
18 nevojë që të flitet më shumë. Këtu në këtë rast, ka ardhun për
19 t'u bë komandant i zonës Sulejman Kollçaku, një ish-oficer i
20 JNA-së i shërbimit të KOS-it është quajtur atëherë [Flet
21 serbisht] që do të thotë në shqip shërbim kundërinformativ.
22 Dhe ne nuk e kemi ditë që ka qenë nga ajo pozitë. Kur është
23 ardhë në Kosovë, ai është caktuar zëvendëskomandant i zonës,
24 ndërsa Drini komandant zone.

25 Tash mjaftonte lidhja e Drinit me zëvendësin e vet dhe

1 zëvendësi i vet përmes telefonave satelitorë, që kishte dhe
2 njerëzve që kishte rreth vetes, që ka ardhë me 136 nënoficerë
3 dhe ushtarë, ata komunikonin drejtpërdrejt me qeverinë në
4 ekzil, me Halil Bicën. Dhe mungesa e koordinimit të punës në
5 nivel të zonës operative të Pashtrikut që të jetë e koordinuar
6 në një pikë të caktuar bënte një fraksion të dyfishtë, ndarjen
7 në dy pjesë dhe ky ishte reagimi ynë me vend dhe me kohë
8 atëherë.

9 PY. Dhe ashtu siç i thatë edhe ZPS-së dhe kjo është tek
10 Shënimi Përgatitor numër 1, në paragrafin 15 të faqes 5.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Do t'ju jap tani edhe numrin e
12 provës materiale, i nderuar Gjykatës. Është numri 716. Ndjesë.
13 P716 dhe ky është shënimi përgatitor.

14 PY. Dhe ju thoni që këto individë, për të cilët folët, e
15 shpërfillën në fakt komplet zinxhirin e komandës dhe
16 strukturat e UÇK-së dhe nuk raportonin as te Drini, as te G2.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Megjithatë është 714, jo 716. Ju
18 kërkoj ndjesë për numrin.

19 PY. Pra, këta individë e shpërfillën tërësisht zinxhirin e
20 komandës së UÇK-së dhe nuk raportuan tek Drini ose G2, e
21 saktë?

22 PË. Këta e filluan edhe të ushqeheshin veç neve sepse kishin
23 ardhë me paratë e tyre nga qeveria e ekzilit në Shqipëri. Dhe
24 filluan të ushqehen veç duke u arsyetuar se këta agjërojnë
25 ramazan. Dhe zgjoheshin natën hanin bukë. Nuk ushqeheshin

1 bashkë me ne. Filloj një farë ndarjeje, i vunë barrierat
2 Brigadës 123 në dy anët e rrugës kryesore që të mos mund të
3 kalojnë as ushtarët as luftëtarët pa kontroll.

4 Dhe kjo ishte hera e parë që u dashtë t'i pajisim
5 ushtarët me leje qarkullimi. Dhe këtë e bëna unë. Ju lëshova
6 leje qarkullimi sepse ushtari i armatosur mos me pasë leje
7 qarkullimi në fushën e luftës, kjo ishte një pengesë e madhe
8 për luftën. Kështu ka ndodhun. Po pastaj, ai iku nga Kosova,
9 dezertoi, bashkë me një turk, që kishte përcjellës të vetin.
10 Sulejman Kollçaku a fjala. Nuk e di sesi e kam gjet ta këtë me
11 vete një turk që nuk dinin të mirrshin vesh as ata në mes veti
12 as na me ta. Ai e përcillte. Nuk i besojë të gjithë atyne
13 luftëtarëve shqiptarë që ishin me mijëra, i besoj një turku
14 jetën e vetë. Atë kishte përcjellës dhe ka ikën për Shqipëri,
15 pastaj për Turqi apo Gjermani. Nuk e di ku ka shku. Mirëpo në
16 ikje e kanë pa duke numëruar shumë para në një vend ku kanë
17 pushuar për të dalë jashtë kufinit. Kishte pasë shumë dollarë
18 me vete.

19 PY. Pra, me pak fjalë, si komandant, duket sikur ka në fakt
20 një zinxhir të dublikuar komande dhe personi që ishte
21 zëvendëskomandant, Qadraku, ai dezertoi dhe, në fakt, u largua
22 në mes të pranverës, si i bie të dimrit 1999 dhe UÇK-ja ishte
23 ende e rrethuar nga forcat serbe, apo jo?

24 PË. Ju lutem, z. Avokat, ta korrigjoni, jo Qadraku, Kollçaku.
25 Qadraku s'ka ikun, nuk ka dezertuar. Kollçaku. Sulejman

1 Kollçaku. Ju lutem se është seancë publike. Të tjerat janë të
2 sakta. Sikur që thatë ju, të tjerat janë të gjitha të sakta.
3 PY. Dhe ju lutem natyrisht që mund të më thoni kur e kam
4 gabim, sidomos kur i them gabim fjalët në shqip.

5 Dhe përveç kësaj, përveç këtyre problemeve, kishte dhe
6 probleme me komandantët e brigadave, si për shembull, me
7 Skënder Hoxhën, apo jo?

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Ja të vendosim këtu tani provën P650
9 në ekran. Do të kalojmë tek faqja e saj e parë.

10 DËSHMITARI: Këtu më dalin disa shkrime qirilic. Më vjen
11 keq që i shoh kështu shkrimet qirilic në gjuhën sllave. Nuk e
12 di nga e keni marrë këto, po më vjen keq që materialet ju kanë
13 ardhun nga duart e Serbisë për luftëtarët e lirisë. Shumë
14 rëndë po më vjen që po i shoh në ekran dhe në këtë Gjykatë.

15 Z. KEHOE: [Përkthim]

16 PY. Dëshmitar, thjesht që ta dini kjo i është dorëzuar ZPS-së
17 dhe pastaj na është dhënë ne. Ky është dokumenti për të cilin
18 në fakt unë doja të flisja për ju dhe për Skënder Hoxhën.
19 Skënder Hoxha, ka qenë komandant i Brigadës 124, apo jo?
20 PË. Po.

21 PY. Dhe ju patët vështirësi me të. Po të lexojmë paragrafin e
22 parë, për shembull dhe kur flisni për të:

23 "... që kur ka ardhur ai u pozicionua kundrejt atyre
24 njerëzve dhe po ashtu edhe sa i përket veprimtarisë, për
25 shembull, që kishte të bënte..." nuk e di nëse e lexoni atë

1 pjesën --

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Duhet të kalojmë pak më poshtë edhe
3 në paragrafin e parë nëse mundemi në gjuhën shqipe.

4 PY. "... edhe për zbulimin e femrave dhe të burimeve të
5 kënaqësisë që nuk duhet t'i ketë një ushtarak, makinave, të
6 hollave, vajzat ..."

7 PË. Tani nuk më kujtohen detale krejt ato. Por shkrimi ka të
8 bëjë me parregullsitë se ai rreth vetes pat disa njerëz që
9 kanë qenë bashkëpunëtorë të shërbimit sekret jugosllav si
10 Nasim Mullabazi e të tjerë, të cilët e tërhoqën nga pozicioni
11 i brigadës ku ishte në Reti, ai më shumë qëndronte në Krushë
12 të Madhe dhe atje te marësoret te njerëzit e njohur, te tezja
13 e vet e te ata.

14 Bënin një grupim të ushtarëve duke mos respektu rregullat
15 për të qenë në komandën e zonës. Dhe në këtë fushë, ne i kemi
16 dhënë vërejtje, se nuk po sillet si komandant zone por po
17 sillet si një kapadai apo si ta them ashtu. Nëse kam gabu, nuk
18 e kam thënë si komandant brigade u deshtë ta them, jo
19 komandant zone. Ta korrigjojmë.

20 PY. Dhe ky është i njëjti Skënder Hoxha për të cilin ju thatë
21 që Jakup Muharremi dhe më falni në qoftë se e shpreh gabim në
22 gjuhën shqipe, po ishte mbajtur ndaluar dhe ishte rrahur nga
23 grupi i Hoxhës dhe kjo ishte në fakt të një mosmarrëveshjeje
24 personale, familjare, të familjes së tyre. Dhe ishte diçka që
25 ishte një armiqësi ndërmjet tyre përpara luftës dhe me luftën

1 Hoxhës ju dha mundësia që me grupin e tij ta merrte këtë njeri
2 dhe ta rrihte atë. Unë e di që ju morët vesh për këtë gjë dhe
3 që Hoxha ishte personi që lejoi që ky personi tjetër të rrihej
4 duke u bazuar tek hakmarrja personale që kishte të bënte me
5 çështje të familjes, apo jo?

6 PË. Përafërsisht është korrekte. Vetëm duhet korrigjuar që
7 drejtpërdrejti nuk ka pasë konflikt Skënder Hoxha me Jakup
8 Muharremin, por dikush nga njerëzit e afërt me Skënder Hoxhën
9 ka qenë në bela, ka qenë në ngatërresa para lufte me Jakup
10 Muharremin dhe e ka shfrytëzuar rastin që ta sjellë aty dhe ta
11 prezantojnë si spiun, si bashkëpunëtor të shërbimit sekret
12 jugosllav dhe e kanë maltratuë.

13 PY. Dhe e gjitha kjo për shkak se kishte një lloj
14 mosmarrëveshjeje brenda familjes ose fisit përpara se të
15 fillonte lufta, apo jo?

16 PË. Po, kjo ka ndodhë për shkak se kanë pasë një konflikt mes
17 veti para lufte. Ashtu është.

18 PY. Dëshmitar, unë e di që ju e morët vesh këtë goxha më
19 vonë, pra, jo në atë moment kur ka ndodhur, apo jo?

20 PË. Unë nuk e kam ditë momentin kur ka ndodhë. Për këtë ka
21 qenë i njoftum Tahir Sinani dhe Tahir Sinani paska dhënë
22 vërejtje Skënder Hoxhës pse ke vepru kështu. Nuk e kam ditë.
23 Vërejtja ka qenë me gojë, nuk ka qenë me shkrim. Unë e kam
24 mësu rastin pas lufte nga vetë Jakup Muharremi se kemi dhe
25 lidhshmëri familjare, jemi fare-fis.

1 PY. Faleminderit. Nëse mund të vijojmë me faqen e dytë, ku
2 thuhet që ka patur probleme dhe me problemë të tjerë në zonë.
3 Njëri prej tyre është Nasim Mullabazi për të cilin z. Qadraku
4 thotë që nuk bashkëpunoj me të. Dhe që Rexhep Krasniqi që
5 ishte shefi për moralin, i sektorit të moralit dhe për
6 informimin, ai nuk donte që të kishte këtë pozicion, po
7 thjesht donte të ishte polic ushtarak.

8 PË. Halil Qadraku ka mund t'i njoh më mirë se është i atij
9 vendi, është prej anës së Rahovecit. Dhe këta janë, fjala
10 është për të gjithë që i përmendët të Rahovecit edhe Nasim
11 Mullabazi edhe Rexhep Krasniqi. Rexhep Krasniqi ka qenë
12 zëvendëskomandant i Brigadës 124, ku ishte komandant Skënder
13 Hoxha.

14 PY. Ndërkohë që ju dhe z. Qadraku kërkonit që të bëheshin
15 ndryshime në pjesën kryesore, donit që të zëvendësoheshin këta
16 persona, apo jo?

17 PË. Jo, ne donim të ketë një këshill kadrovik, të bëj
18 verifikimin e personave para se të emërtohen, para se të
19 vendosin në pozita, kështu që mos të jetë në kokën e një
20 njeriu t'i vendosë njerëzit apo t'i heq. Ne këtë kërkonim.
21 Kërkonim organizim. Kërkonim këshill kadrovik për personat që
22 duhen emërtuar.

23 PY. Dhe e bëj këtë pyetje Dëshmitar dhe ju i dini këto gjëra
24 më mirë se unë, po në paragrafin e parafundit, ju thoni që:

25 "Unë, ashtu si edhe Qadraku mendojmë që duhet të ketë

1 ndryshime në brigadë ...”.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Duhet të shkojmë në fund të faqes në
3 fakt si tek gjuha shqipe ashtu edhe tek anglishtja. Ose
4 ndoshta një pjesë e saj në gjuhën shqipe është në faqen
5 tjetër.

6 PY. Që ju donit që të kishte ndryshime në komandën e Brigadës
7 124, apo jo?

8 PË. Po me siguri kemi pa të arsyeshme që aty nuk u ka
9 veprohet siç duhet me rregullat e duhura, prandaj kemi kërku
10 ndryshim. Dhe kjo ka ardhë si kërkesë e mbrendshme dhe të vetë
11 Brigadës 124, nga Selim Gashi dhe nga njerëzit aty që kanë
12 qenë prej ditëve të para në luftë.

13 PY. Dëshmitar, duke u bazuar tek pozicioni që kishit ju dhe
14 te pozicioni i z. Qadraku, Drini nuk ishte personi i duhur në
15 fakt për ta bërë organizimin siç duhet të zonës së Pashtrikut,
16 apo jo?

17 PË. Drini ka qenë një oficer i aftë, ka qenë i vetmi oficer
18 shqiptar që u ka leju në armatën jugosllave të jetë atashe
19 ushtarak, të jetë i besuar për një ushtri jugosllave. Por
20 Drini ka pasë mangësitë e veta dhe ndoshta ka pasë edhe
21 qëllime që ne nuk i dimë çfarë qëllimi. Po ne e kena pa si
22 dobësi të tija duke kërkuar njerëz të besueshëm rreth veti, ai
23 shkëputej nga realiteti i strukturimit, i zhvillimit dhe i
24 komandimit të zonës.

25 PY. Atëherë dhe të vijojmë dhe në formë kronologjike, ju i

1 keni thënë edhe SPO [Në anglisht] edhe z. Emmerson, që Drini
2 iku dhe shkoi në krye të akademisë ushtarake dhe që
3 zëvendëskomandanti Sulejman Kollçaku, më duket se e shqiptova
4 siç duhet, apo jo, që ai dezertoi dhe nuk mbeti njeri për të
5 qenë komandant i zonës së Pashtrikut mu në mes të një ofensive
6 serbe dhe ju morën rolin, apo jo?

7 PË. Ashtu është, z. Avokat. Sulejman Kollçaku kur iku i
8 dështoi plani që Drini kishte plan të bëhej shef i shtabit të
9 UÇK-së. Në përgjithësi, Sulejman Kollçaku, komandanti i zonës
10 operative të Pashtrikut, largimi i tij, ikja e tij, dezertimi
11 i tij e bëni të shkëputshim Drinin nga rrjeti i atij fraksioni
12 që përmendëm më përpara. Dhe ai kërkoi të vendoset dikun ma
13 lartë që të muj nga lart prapë të ndikojë në zonën operative
14 të Pashtrikut dhe te rrjeti i tyre.

15 Dhe në atje në Shtab të Përgjithshëm emërtohet komandant
16 i akademisë ushtarake.

17 PY. Dëshmitar, për të pasur edhe vëmendjen tek ju tani, pra,
18 kanë ikur komandantët, zëvendëskomandanti, ju si individ
19 merrni përsipër përgjegjësinë pa ju emëruar dikush dhe merrni
20 komandimin e zonës operative të Pashtrikut deri sa vjen Tahir
21 Sinani, apo jo?

22 PË. Këtë përgjegjësi ma dha armiku, sepse ata na sulmonin.
23 Nuk pyetshin a kem na komandant a s'kem. Dhe ua dasht të
24 rezistonim.

25 PY. Zotëri, në fakt, nuk po ju them që bëtë gabim në vendimin

1 që morët, po thjesht po them, që ju patë që kishte një problem
2 dhe ju morët komandën dhe ju ishte gjëja e duhur për të bërë
3 po ju u vutë në komandë, apo jo?

4 PË. Është logjikë ushtarake kur mungon komandanti, vendoset
5 zëvendësi, kur mungon edhe zëvendësi, një ushtar më i forti
6 apo një luftarak më i miri do ta merrte komandën. Unë asgjë
7 s'i kam marrë Drinit. As nuk ka ik Drini prej meje. Kam pasë
8 shumë respekt edhe sinqerisht njëherë jam përpjekë për t'ia
9 shpëtu jetën. Kam shku këmbë e duar ma shumë se 200 metra
10 këmbë e duar për ta ndalë makinën që ai të mos futet në
11 rrezik. Ishte me xhipin e vet. Dhe arrita ta ndali.
12 Përkundrazi atë ditë u plagos në këmbë. Kur nuk e do fati, s'e
13 don. Ama ishte përpjekja jeme që ai të mos dëmtohej.

14 Nuk kam pasë asgjë kundra Drinit personale. Flasim për
15 problemet e organizimit, problemet e brendshme të luftës, kjo
16 është normale, shumë normale.

17 PY. Jo, as unë nuk e çova në nivel personal. Thjesht dhe nuk
18 e kuptova ashtu, po thjesht thashë që ju patë një boshllëk në
19 zonë duke mos patur komandantë, duke mos patur
20 zëvendëskomandant, askush nuk ishte emëruar për të marrë
21 komandën dhe ju e bëtë këtë gjë vetë dhe në fakt u vutë, pra,
22 e kryet këtë punë derisa erdhi komandanti?

23 PË. Po, ashtu është.

24 PY. Okej. Nëse mund të kalojmë pak tashmë për një çështje
25 tjetër, për disa çështje, të cilave u jeni referuar në

1 deklaraten që keni dhënë më parë tek ZPS-ja dhe që, në fakt,
2 nuk doli gjatë pyetjeve që ju bëri Prokuroria juve. Kështu që
3 ju lutem më jepni pak kohë.

4 Dhe unë dëshiroj të flas me ju për disa nga informatat që
5 keni marrë, jo vetëm kur ishit në Budakovë, por edhe kur ishit
6 personi, pra, që merreshit me moralin. Dhe është e vërtetë në
7 fakt që këto këshillat në fshatra përpiqeshin t'ju jepnin një
8 listë me emrat e personave të cilët ata mendonin që ishin
9 bashkëpunëtorë, apo jo?

10 PË. Po ka ndodhun që këshillat e fshatrave kanë sjellë emna,
11 lista për t'i fajësuar njerëzit si bashkëpunëtorë të shërbimit
12 sekret të jugosllav. Dhe unë një rast kam pasë të vijë një
13 listë nga fshati im që ata njerëz i njifsha, të gjithë i
14 njoha. Dhe e pashë se ishte krejt fallco. Ishin qëllime, tekat
15 e tyre për t'u hakmarrë mes veti, pse kanë pi birra bashkë me
16 serbët, kanë hëngër pula bashkë, kanë bë muhabete, donin t'i
17 paraqitshin si të rrezikshëm me shërbimin sekret jugosllav dhe
18 unë atë listë e shkeva para atyre që e sollën. Thashë "Ikni,
19 jupni, shkoni në shtëpi se nuk janë këta njerëz çfarë i
20 paraqesin këtu"

21 Sepse askush nuk ka pasë pasoja nga ata. As nuk është
22 marrë në burg, as u rrahë, as u likujdu. Çfarë spiuna janë
23 këta? Kështu që unë i kam kuptu shumë drejt se aty ka pasë
24 tendenca nga civilët të depërtojnë te ushtarët që t'i cytin,
25 që t'i shtinë që të hakmerren ndaj dikuj në emër të asaj se

1 është bashkëpunëtori i shërbimeve sekrete jugosllave. Keni të
2 drejtë ju.

3 PY. Dhe ju në fakt e kuptuat që, jo vetëm në fshatin tuaj,
4 por edhe në Budakovë kur ju ishit zëvendëskomandant, sesa e
5 rëndësishme ishte për një person mendoni që ai të quhej
6 bashkëpunëtor ose sa dëm i shkaktonte atij personi dhe
7 familjes së vetë ky lloj emërtimi, apo jo?

8 PË. Shumë drejtë e kam kuptu me kohë dhe kam vepru drejtë.
9 Sepse çfarëdo dëmi që t'i shkaktojë dikujt që do ta sillnin me
10 lista apo do ta liniçonin si spiun apo bashkëpunëtor të
11 shërbimit sekret jugosllav, ai do ta dëmtonte edhe nipin e
12 vetë edhe stërnipin edhe disa breza më vonë do të thonin se ka
13 pasë gjyshin, stërgjyshin spiun jugosllav, e ka pasë të
14 shitur. Prandaj kjo ka qenë me shumë kujdesje që të mos
15 dëmtohet askush për të lënë pasoja shumë më vonë për
16 pasardhësit tanë

17 PY. Dhe kur ju erdhi kjo lista që ju e grisët, ju i kërkuat
18 atyre që "Më jepni provat mbi të cilat i bazoni këto
19 pretendime që keni për këta persona", apo jo?

20 PË. Po thashë "Në çka jeni bazu që keni bë ju listën?" Thanë
21 se ata kanë dikush shitore, dikush kishte taksi, dikush makinë
22 dhe hajnë e pinë bashkë me serbët. Ata spiunojnë fshatin".
23 Thashë "Kush ka pasë pasoja nga veprimet e tyre?". Nuk ishin
24 në gjendje të thonin asnjë send. Thashë "A e shifni që s'janë
25 ata fajtorë". Dhe kështu që i përzuna.

1 PY. Dhe e grisët letrën e shqyet, apo jo?

2 PË. Ashtu është.

3 PY. Atëherë më lejoni që të flas për nja dy çështje
4 shkurtimisht, ndoshta nuk do të jetë shumë e qartë nga aspekti
5 kronologjik, po ju lutem më jepni pak kohë sepse po përpiqem
6 që ta bëjë këtë punë sa më shpejt që të jetë e mundur,
7 Dëshmitar. Dhe po kaloj njëherë nga njëra çështje pastaj tek
8 tjetra. Kështu që ju lutem kini pak durim me mua dhe do
9 përpiqem që të vijoj sa më shpejt.

10 Ju keni folur gjithashtu edhe për Prizrenin e pas-luftës.
11 Dhe ju i keni treguar ZPS-së në Pjesën 3, faqen 32, në
12 rreshtin 15, që ushtarët në burg nuk ishin -- ushtarët në
13 Prizren - më falni - nuk ishte situata nën kontroll, është e
14 saktë kjo?

15 PË. E saktë është. Për të gjithë ne kur është dita e çlirimit
16 dhe kur bëhet një dyndje drejt një qyteti, siç është Prizreni
17 me 180.000 banorë, vrulli i madh, parregullsi shumë të mëdha.
18 Aty lutesh, sikur t'i lutesh Zotit kur është ndonjë vërshim i
19 madh, ndale Zot këtë shi, ndale këtë ujë, përndryshe shumë
20 vështirë ta mbajsh nën kontroll. Të njëjtën kohë, ishin akoma
21 forcat serbe aty. Në të njëjtën kohë erdhën forcat e KFOR-it
22 gjerman në Prizren, po flas për Prizrenin. Në të njëjtën kohë
23 ishim ne aty, UÇK-ja.

24 Dhe ishte një përzierje shumë e madhe, ka qenë vështirësi
25 shumë e madhe për t'i stacionuar ushtarët, për t'i fut nën

1 ombrellë me i mbajt nën kontroll me armët e tyre që kishin
2 sepse të gjithë bënë turr të shkonin nëpër shtëpitë e tyre
3 për t'i pa të djegura, për t'i gjet anëtarët e familjes të
4 masakrum, të munguar, të kidnapuar. Dhe kështu ishte e
5 vështirë për t'i ruajt ushtarët nën komandë disiplinore.

6 Jemi përpjekë që mbrenda një jave, dhjetë ditëve kemi bë
7 mbylljen e ushtarëve në ato area, siç e quanin atëherë KFOR-i,
8 në vendqëndrime. Dhe më vonë ka fillu çarmatimi i tyre. Kështu
9 ka qenë siç e përshkrut edhe ju pak.

10 PY. Dhe gjithashtu kishte dhe disa komandantë të UÇK-së, si
11 komandant Drini, që vajtën në Prizren pa patur autoritetin,
12 mandatin për ta bërë këtë gjë?

13 PË. Drini ishte kohën e fundin gati thuaj i strehuar në
14 Kabash, në batalionin e dytë të Lulzim Kabashi, sepse Lulzimin
15 e kishte baxhanak, gratë motra i kishin me Lulzimin. Dhe kur
16 erdh puna që të futeshim në qytete, ata kanë zbrit nga Kabashi
17 Batalioni i Dytë dhe kanë ardhë në Prizren. Në Prizren, Drini
18 duke e pasë përvojën e oficerit të Bosnjës dhe oficerit të
19 JNA-së, ai filloj të paraqitej jo veç si komandant zone, po
20 gati si komandant i UÇK-së, gjeneral Drini. Gjeneral Drini. Ne
21 nuk kemi pasë grada. As Drini s'ka pasë gradën e gjeneralit,
22 ka qenë në nivelin e kapitenit në ushtrinë jugosllave apo të
23 majorit. Dhe paraqitja e tij para mediave dhe aftësia e tij,
24 se njifte katër-pesë gjuhë të huaja, ishte jo normale në bazë
25 të rregullave të Ushtrisë çlirimtare të Kosovës.

1 Se ne duhej të flitnim para mediave vetëm me lejen e Adem
2 Demaçit e jo të flisnim si të na teket neve dhe ta quajmë
3 veten siç e dojm ne. Prandaj në këtë kuptim ka qenë diçka e
4 parregullt. Ai duke qenë komandant i akademisë ushtarake,
5 paraqitej si komandant zone, herë si komandant i përgjithshëm.
6 Kjo ka ndodhur në Prizren kur kemi hy. Më kërkoi dhe mua që të
7 bashkohesha me të atje, t'i lë ushtarët le të shkojnë ku të
8 dojnë se tash lufta ka mbaru. Unë nuk isha dakord. Thashë "Jo,
9 jo. Ushtarët duhen të sistemohen dikund, duhet të
10 kontrollohen, duhet të çarmatosen pastaj të shkojnë". Kjo ka
11 ndodhë.

12 PY. Pra, në momentin që është në Prizren, ai nuk është as
13 komandant i zonës, as komandant ushtarak. Është thjeshtë i
14 përfshirë në akademinë ushtarake, apo jo?

15 PË. Unë ju drejtova komandant, shefit të shtabit Agim Çekut
16 me radiolidhje dhe i thashë "Me urdhrat e kuj vepron Drini në
17 Prizren?" Ai tha më paraqitet kështu-kështu. Thotë "Nuk është
18 me urdhra tonë". "Po a din" them "kush i ka dhënë urdhrat?"
19 Thotë "Nuk ka asnjë urdhër. Unë merrna vesh me të. Unë flas me
20 ta. Ai është kokë më veti tuj vepru". Kështu ka ndodhur.

21 PY. E përmendët në fakt, që ka pasur dhunë në Prizren. Madje
22 dhe në fshatin tuaj, ka pasur ca hakmarrje, kacafytje, për
23 shembull, civilët që u kthyen mbrapsht, pra, dogjën kishën
24 sepse xhamia ishte djegur, domethënë, ka pasë zhvillime të
25 tilla, ngjarje të tillë, apo jo, Dëshmitar?

1 PË. Ta them të vërtetën ka pasë shumë anomali të
2 padëshirueshme, po e keqja më e madhe ka qenë kur në tërheqjen
3 e tyre serbët i kanë marrë të burgosurit me vete, i kanë
4 ngarku dy kamiona, dy maune me të burgosur. Dhe e keqja e
5 madhe është kur jemi kthyer, jo veç xhamia që a kanë shkatërrime
6 po dhe shkollat, edhe fabrikat, edhe shtëpitë. Dhe kështu, siç
7 e thatë ju, ka ndodhur edhe me kishat që vetë populli kur janë
8 kthyer e kanë pa se xhamia është shembur dhe shtëpitë janë djegë
9 98 për qind, kanë shkue dhe ua kanë marrë kulmet e shtëpive të
10 minoritetit grek, minoritetit serbë dhe i kanë vendosur nëpër
11 shtëpitë e veta të djegurat. Në këtë situatë është kalli edhe
12 kisha siç e thoni ju. Kishat kanë qenë ortodokse shqiptare.
13 Për fat të keq nga koha e monizimit i ka shtetëzuar pushtimi
14 serb dhe i ka bërë ortodokse sllave.

15 T'i kishim na ato kisha tonat siç kanë qenë dhe siç kemi
16 qenë ortodoks shqiptar, do të ishin relacione shumë më të mira
17 dhe me Evropën dhe me vetveten, por na kanë tjetërsuar me dhunë,
18 z. Avokat.

19 PY. Faleminderit, për këtë shpjegim, Dëshmitar. Tani më
20 lejoni që të kthehem përsëri tek tema që do diskutojmë tani
21 për presidentin Thaçin. Besoj që i keni thënë ZPS-së - dhe për
22 procesverbalin këtë e keni thënë në provën materiale P707.1.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares ta paraqiste
24 këtë pjesë të intervistës tuaj në ekran. Pra, është edhe
25 njëherë prova materiale 707.1, faqja 15, rreshtat 11 deri në

1 20. Ndërkohë që versionin në shqip është faqja 15, rreshtat 13
2 deri 21. Në versionin në shqip janë rreshtat 13 deri në 21.

3 PY. Prokurori ju bën këtë pyetje lidhur me President Thaçin:

4 "Ju përmendët që është krijuar gjatë luftës. A e mbani
5 mend pak a shumë kur në çfarë kohe?"

6 Ju thoni:

7 "Korriku më duket, atëherë ka qenë nga fundi i korrikut.
8 Kam pasë një vizitë në batalionin tim nga Hashim Thaçi. Dhe
9 nga ajo që mund të konstatoja, mbante shënime rreth gjendjes
10 që kam në batalion, strukturat e batalionit, mënyrat e
11 organizimit, vendpozicionet tona, transhet, kanalet, si quhen,
12 bunkerët. Dhe më dukej se nuk e ka me vetë gjithë kapacitetin
13 e politikbërjes së luftës".

14 Ky ishte fakt, apo jo, Dëshmitar, që Hashim Thaçi nuk
15 ishte persona ushtarak, nuk kishte trajnim si i tillë dhe se
16 ju besonit që ai nuk kishte kapacitetin për të ndihmuar për të
17 organizuar UÇK-në si forcë ushtarake, luftarake, a është e
18 vërtetë kjo, Dëshmitar?

19 PË. Në radhë të parë, unë mendoj se është caktuar nga Adem
20 Demaçi apo nuk di kush e ka caktuar, drejtor të drejtorisë
21 politike. Në radhë të dytë, mendoj sikur ju që thatë, ai më
22 shumë i ngjante një politikani, një komisari sesa një
23 luftaraku, cili vetëm të përpigëj në aspektin teorik ta dijë
24 sesi zhvillohet lufta, se çfarë kemi në gjendje në
25 dispozicion, ku jemi, kush jemi.

1 Dhe ardhja e tij në korrik në Budakovë ma tepër ka qenë
2 kureshtje, për shkak të dy betejave më 3 korrik dhe 4 korrik
3 të fituara kundër pushtuesit dhe moralit të madh që u ngrit
4 nga popullatat e mbushën radhët e UÇK-së, ka ardhë e më ka bë
5 vizitë në batalionin e Budakovës.

6 PY. Të shohim provën materiale 1D50. Është një provë
7 materiale e cila është pranuar si provë që është një deklaratë
8 politike.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares ta paraqiste
10 në ekran këtë dokument njëherë. Më mirë ta shohim në ekran dhe
11 pastaj e trajtojmë

12 PY. Dëshmitar, ky është një dokument i cili flet për emërimin
13 e Shtabit të Përgjithshëm ku thuhet që u bë publik Jakup
14 Krasniqi, Xhavit Haliti, Bardhyl Mahmuti, Hashim Thaçi, Faton
15 Mehmetaj, Sokol Bashota janë përfaqësuesit politik të UÇK-së.

16 Më vonë në nëntor, besoj që ju e dini, që ai u bë shefi i
17 drejtorisë politike. Do të doja që t'ju tërhiqja vëmendjen tek
18 libri juaj dhe komenti që keni bërë lidhur me këtë zhvillim.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Për këtë dua që të kthehem përsëri
20 në dokumentin SPOE029,

21 PY. Domethënë, kërkoj që të paraqitet libri juaj, Dëshmitar.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Pra, dëshiroj që të jepet dokumenti
23 9312429 dhe numri i provës materiale është P712. Edhe njëherë
24 9410.

25 PY. Këtu ju thoni që sa i takon drejtorisë politike të

1 formuar ju thoni:

2 "Ndërkaq u organizuar dhe u formua drejtoria politike
3 pranë shtabit e cila ishte e pakët në njerëz dhe kuadro dhe po
4 ashtu e papërvojë. Por, megjithatë, luajti rol të rëndësishëm
5 në kontaktet dhe zhvillimet diplomatike që zhvilluan më vonë
6 si brenda Kosovës dhe ashtu edhe në atë në Rambuje".

7 Në kohën kur Hashim Thaçi mori këtë rol, sipas mendimit
8 tuaj, Dëshmitar, ai ishte i ri dhe i papërvojë, shumë i
9 papërvojë, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

10 PË. Është shumë e vërtetë. Na ndoshta të gjithë kemi qenë
11 papërvojë se kemi qenë në përballjen e një lufte që është për
12 herë të parë të ndodhin disa gjena në jetë. Po kontaktet me
13 Tina Kajdanova, me Holbrooke, me të gjithë përfaqësuesit që
14 kanë ardhë ta takojnë kanë qenë të nivelit politik aty ku ka
15 përfaqësue Presidenti Thaçi.

16 PY. Sa i takon asaj çfarë bënit ju në terren si komandant
17 brigade dhe si zëvendëskomandant, raportet që dërgoheshin, në
18 qoftë se i dërgoheshin Shtabit të Përgjithshëm ose deri në
19 masën që ju merrnit ndonjë gjë ndonjë raport nga Shtabi i
20 Përgjithshëm, këto nuk vinin nga Hashim Thaçi, apo jo?

21 PË. Jo. Ju ma ngatërruat pak pozicionin. U hidhnova. Se më
22 zbritët në nivel brigade, zëvendëskomandant brigade më thatë.
23 Nuk duhet të zbresi, zëvendëskomandant zone. Pak ma ngatërruar
24 pozicionin kur e shpjeguar, z. Avokat.

25 PY. Ju kërkoi falje për këtë.

1 PË. Jo. Për hir të korrektësisë.

2 PË. Ju kërkoj falje. Komandant brigade, jo domethënë.

3 Patjetër. Patjetër. Duhet t'i themi gjërat siç ka qenë.

4 PË. Nuk vinin urdhrat nga Hashim Thaçi. Po nuk vinin as të
5 tjerët mjerisht që ne kemi pritë. Ne kemi idealizue një Shtab
6 të Përgjithshëm i cili duhet të jetë krejt funksional, i cili
7 duhet të ketë nivelin më të lartë të detyrës, po realisht ka
8 qenë gati thuaj afiktiv, gati thuaj afiktiv, me shumë pak
9 njerëz, shumë pak njerëz. Unë s'besoj Hashim Thaçi që ka pasë
10 dy-tre vetë jo më shumë rreth vetes dhe nuk ka mund të bëjë
11 edhe punën që e ka pasë për detyrë si duhet. Po sidoqoftë
12 urdhra s'kanë ardhë prej Hashim Thaçit.

13 PY. Mendoj që i keni thënë ZPS-së që jeni takuar me Hashim
14 Thaçi vetëm dy herë, a është e saktë kjo, Dëshmitar? Dy ose
15 tre herë keni thënë, apo jo?

16 PË. Dy herë më duket se jemi taku, nëse s'kam harru. Ndoshta
17 dhe tri herë. Ka mundësi dhe harresa. Nuk jam edhe unë i
18 paharrueshëm, po me mshef nuk mshefi asnjë gjë. Të gjithë të
19 vërtetën e them edhe duhet që ky proces të pastrohet njëherë e
20 përgjithmonë UÇK-ja me të vërtetat e veta. Jam takue në
21 Budakovë herën e parë, siç e thashë, dikun ka mes i korrikut
22 apo ka fundi i korrikut ka qenë. Ka fundi i korrikut se kam
23 pasë njësi edhe në Maçitevë.

24 Edhe herën tjetër jam takue më duket - kohën ndoshta
25 s'mund ta specifikoj. Nëse u kthye, ai e din më mirë prej

1 Rambujesë, jam takue te Shtabi i Përgjithshëm kam shku me
2 kërku armë në magazinë, municion mu ka vyt. E kam pa te kroni,
3 te çesmja tuj la fytyrën. Sa ishte zgju në mëngjes dhe më
4 pyeti "Hë" thotë "çfarë ke ardhë? Për çfarë ke ardhë këtu?"
5 Thashë unë "Më duhet municion se shumë pak kemi". Më tha "Nëse
6 ke naj kund betejë sot po vij edhe me ty teposhtë". Thashë
7 "Jo, jo. Sot jo, po pritet këto dy-tri ditë pritet beteja".
8 Kaq kam pasë punë me Hashim Thaçi gjatë krejt luftës.

9 Bile duhet ta them edhe një diçka që s'po ma kërkoni.
10 Edhe mbas luftës unë e kam taku. 20 vjet s'kam mund ta takoj
11 mbas lufte. Ndoshta e çuditshme a. E kam kërku me taku, s'un e
12 kam taku. Dhe ai le ta sqaron këtë vetë pse.

13 PY. E kuptoj, Dëshmitar. A e dini që nga mesi i marsit 1998
14 deri pas Rambujesë -- ta them ndryshe. Nga mesi i nëntorit të
15 1998 deri pas Rambujesë në mars të 1999, presidenti Thaçi nuk
16 ka qenë fare në Kosovë?

17 PË. Presidenti Thaçi as vetë nuk mund ta përshkruajë rrugën e
18 vet ku ka qenë. Aq shumë ka lëvizë sa në Shqipëri, sa në
19 Maqedoni, sa jashtë vendit, unë nuk e di ku ka qenë, po nuk ka
20 qenë në Kosovë. Ku ka qenë ai më mirë duhet ta thotë. Nuk ka
21 qenë në Kosovë edhe nuk ka qenë e mirë për ne që s'ka qenë.
22 Për ne komandantët e zonave nuk ka qenë e mirë, s'e ka kry
23 detyrën si duhet. Çfarëdo qoftë. Ai ka kry detyra shumë më të
24 mëdhaja derisa u taku me diplomatët e botës, derisa, po për
25 neve u kanë dashtë ta kemi aty.

1 PY. Me komandant zone dhe juve si zëvendëskomandant i zonës,
2 ju njerëzit nëpër zona ishit personat që bënit luftën që
3 merrnit pjesë nëpër beteja kundër serbëve, apo jo?

4 PË. Ne ishim të detyrur të rezistojmë dhe të mbrojmë civilët,
5 siç e thashë më përpara dhe sigurisht kemi bë luftë, z.
6 Avokat, nuk e mshefin kemi bërë me dhjetëra e me qindra
7 beteja, kemi shkatërru makinerinë ushtarake jugosllave,
8 tanksat, pragat, autobлиндat. Batalioni jem ka rrëzu një
9 helikopter, ka djegë autoblinda, Pizgauer e shumë e shumë që
10 në fillin. Pastaj të mos të flas me dhjetëra e qindra të tilla
11 në nivel të zonës. Luftë është bë. Ka pasë urdhra për beteja.
12 Ka pasë urdhra për tërheqje. Ka pasë plane për operacione, për
13 luftë, për prita, ma të suksesshme i kena pasë pritat kundër
14 tyne.

15 PY. Dëshmitar, të vazhdojmë më tej. Ju e dini që President
16 Thaçi ka qenë në misionin diplomatik në Rambuje në shkurt dhe
17 në mars të 1999, këtë e dini, besoj, Dëshmitar, apo jo?

18 PË. Ne e dimë po është mirë që ta sqarojë edhe ai vetë kush e
19 ka dërgu atje.

20 PY. E kuptoj. Por kur Presidenti Thaçi dhe delegatët e tjerë
21 dhe udhëheqësit e tjerë të UÇK-së ishin në Rambuje, në fakt,
22 ka pasë një grusht ushtarak në nivel ushtarak ndërmjet
23 komandantëve të brigadës që e kanë zëvendësuar Azem Sylën që
24 ishte në Rambuje me Sylejman Selimin, a ka qenë kështu,
25 Dëshmitar?

1 PË. Po, ka qenë diku nga data 9 shkurtit, besoj, nëse s'e kam
2 gabim datën. S'guxoj të gaboj. Është mbajtur një mbledhje ku ka
3 marrë pjesë Bislir Zyrapi, Ekrem Rexha, komandant Drini,
4 Ramush Haradinaj, Remi, Sulejman Selimi dhe Sokol Bashota.
5 Këta kanë marrë pjesë dhe kanë kërkuar, jo veç kanë kërkuar po
6 kanë vendosë komandant të përgjithshëm Sulejman Selimin. Në
7 këtë rast Sokol Bashota ka lëshuar mbledhjen i pakënaqur ka
8 qenë. Për Remin kur u thashë si u shprehur Remi është Rustem
9 Mustafa se nuk e thashë emrin e plotë.

10 Domethënë, në atë mbledhje është vendosë komandant i
11 përgjithshëm Sulejman Selimi. Dhe Sulejman Selimi asnjëherë
12 nuk e ka realizuar detyrën që u ka dhënë. Nuk kemi asnjë
13 urdhër prej tij, nuk kemi asnjë vizitë, asnjë bashkëpunim me
14 zonat. Ndoshta pikërisht se zona jeme, ku isha unë, Pashtriku,
15 zona Nerodimës, zona e Karadakut dhe zona e Shalës, nuk e kanë
16 njohë për komandant Sulejman Selimin. Por e kanë njoftë për
17 komandant atë që ka qenë më herët, Azem Sylën. Kështu ka qenë.
18 PY. Në qoftë se i kthehem temës së President Thaçit ai nuk
19 kishte as kompetencë dhe asnjë lloj përgjesisie komande mbi këta
20 komandantë zone kur ata kanë marrë këtë vendim në këtë akt që
21 bënë apo jo?

22 PË. Ai nuk ishte as aty. Edhe sigurisht se s'ka pasë
23 përgjegjësi të tilla, ma tepër ka qenë detyrë e Presidentit
24 Thaçi, që ai e di më mirë se unë, ai t'i bëjë politikat e
25 luftës, po sa ka mund t'i bëjë se ka qenë shumë i vetmum. Unë

1 nuk di sa ka pasë në ekipin e vet. S'besoj që ka pasë më shumë
2 tre vetë, tre persona.

3 PY. Pra, mesa dini ju, gjithçka që ka bërë ai ka qenë në
4 fushën apo terrenin diplomatik apo jo?

5 PË. Më së shumti në atë fushë dhe në atë fushë ka pasë
6 suksese.

7 PY. Ju na keni thënë dhe do të diskutojmë gjithashtu edhe ca
8 ngjarje që kanë ndodhur pas Rambujesë, megjithëse nuk do të
9 trajtoj çdo gjë që keni cekur dhe me z. Emmerson dje që kishin
10 të bënte me faktin që njerëzit nuk e dinin çfarë rolesh dhe
11 përgjegjësish kishin. Besoj se dje na thatë dhe për
12 procesverbal kjo është në faqen 91, rreshti 6. Këtu flisni për
13 Shtabin e Përgjithshëm dhe në mënyrë të tillë që gjërat të
14 fillonin e të lëviznin, ishte lëvizje e vazhdueshme dhe këto
15 ishin 30, mund të ishin, për shembull, 30 organigrama të
16 ndryshme për të pasqyruar, mund të nevojiteshin 30 organigrama
17 të ndryshme për të pasqyruar këto lëvizje. A ishin këto
18 lëvizje brenda Shtabit të Përgjithshëm? Edhe brenda shtabit
19 ishin, apo jo, Dëshmitar?

20 PË. Ishin të Shtabit të Përgjithshëm dhe mbrena Shtabit të
21 Përgjithshëm dhe një regjisor më i miri nuk do të mundej me i
22 regjistruar në kamera lëvizjet e Shtabit të Përgjithshëm
23 njëherë në Likoc, tjetër herë në Kleçkë, tjetër herë në
24 Divjakë, tjetër herë te ne aty në Nishor, herë në Shqipëri,
25 herë në Maqedoni. Kështu që lëvizje të tilla kanë qenë edhe

1 lëvizje fizike po edhe lëvizje në ndërrim të kuadrove, të
2 njerëzve brenda shtabit.

3 PY. Në këtë temë, besoj që i keni thënë Prokurorit, nuk e di
4 në qoftë se e thatë dje apo jo, po Prokurorit i keni thënë që
5 për 90 për qind të kohës, ju personat që ishin në terren nuk e
6 dinit fare se kush ishte pjesë e Shtabit të Përgjithshëm, apo
7 jo?

8 PË. Ne imagjinonim që kemi dikën në Shtabin e Përgjithshëm
9 dhe e dinim që duhet të ishte dikush. Kryesorja për ne ka
10 qenun ideja e luftës për çlirim. E dinim që Adem Demaçin e kem
11 përgjegjës politik për politikat e luftës. Ndërsa nuk e dinim
12 për individin, cilido qoftë ai, Kadri Veseli, Hashim Thaçi,
13 Jakup Krasniqi, kushdo qoftë nuk e dinim ku a në atë kohë.
14 Sepse lëvizjet e tyre ishin të tilla edhe ndoshta kanë pasë
15 taktikën e tillë që unë me një vend e kam thënë si taktikë e
16 mirë për t'i shpëtuar armikut. Po neve na kanë mungu shumë,
17 për ne s'ka qenë e dëshirueshme ashtu.

18 PY. E kuptojmë. Ju e keni përjetuar këtë në mënyrë të
19 drejtpërdrejtë për atë periudhë të shkurtër kur keni shkuar në
20 Shtabin e Përgjithshëm kur keni punuar për J1 dhe keni punuar
21 për Shtabin e Përgjithshëm, për vendin, selinë kryesore të
22 Shtabit të Përgjithshëm dhe nuk patë asnjë njeri, s'kishte
23 asnjë njëri aty? Domethënë, mund të duket pak si për qeshur,
24 po kjo ishte situata, apo jo?

25 PË. Unë mbasi që shkoi Adem Grabofci nga aty, mbeta i vetëm.

1 Edhe pos rojave edhe dy tre të stafit të teknik që merreshin
2 aty, nuk kish njeri tjetër. Mu duk vetja sikur të jem i
3 izoluem dhe i ndamë nga lufta. Dhe me rastin e shpërthimit të
4 masakrës të Reçakut, unë mora shoqëruesin tem dhe shkova në
5 drejtim të Budakovës organizova mbrojtjen e Reçakut, mbrojtjen
6 e popullatës atje dhe mbrojtjen e kufomave, që është e
7 çuditshme për juve, po dy ditë është bë luftë për kufomat, për
8 mos me na i marrë serbët, tjetërsojshin natyrën e vdekjes së
9 tyre.

10 PY. E kuptoj plotësisht, Dëshmitar. E kuptoj çfarë doni të
11 thoni.

12 Megjithatë t'i kthehemi dhe një herë Shtabit të
13 Përgjithshëm. Juve shkuat te Shtabi i Përgjithshëm sepse u
14 plagosët tek J1. Një person që ishte pjesë e J1, Adem
15 Grabofci, ju thotë juve të bëni disa gjëra të caktuara dhe
16 pastaj largohet, a ka qenë kështu, Dëshmitar?

17 PË. Po, kështu ka qenë. Unë ma tepër jam ftuar në Shtab të
18 Përgjithshëm si të kurohem, të shërohem nga plagët, të vazhdoj
19 të jem aty, pak më i qetë me lëvizje pak ma të vogla të
20 terrenit. Dhe unë kam shku aty. Dhe kështu ka ndodhur, pasi
21 kam shku unë, Ademi është largu. Nuk di ku ka shku fare. S'më
22 ka raportu mu, se ai ka qenë shefi i J1. Unë krejt detyrën që
23 kam bë në atë kohë për një muaj kam dërgue vetëm ka një letër
24 zonave operative që të bëjnë kompletimin dhe organizimin e
25 zonave. Asnjë punë tjetër s'kam bë për një muaj sa ka nej, më

1 tepër se një muaj aty.

2 PY. Është fakt apo jo që Shtabi i Përgjithshëm sipas përvojës
3 tuaj nuk takohej për muaj të tërë, domethënë, kalonin nga dy
4 tre muaj derisa të mblidheshin përsëri në mbledhje Shtabi i
5 Përgjithshëm, a është kështu, Dëshmitar?

6 PË. Kjo natyrë e veprimit, mos ta quaj anarkik,
7 papërgjegjësi, kjo më ka shty të mendoj unë për ta kriju
8 organogramin dhe gjatë kohës ku ndeja aty, ku qëndroja në
9 shtab, unë bëja vizatime të organogramit në fletore për të
10 qenë funksional në të ardhmen.

11 PY. Të flasim pak për organogramën.

12 Z. KEHOE: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares dhe për ju
13 Dëshmitar, dua që të kalojmë gjërat hap pas hapi, në mënyrë
14 graduale siç kanë ndodhur. Në zonën operative të Pashtrikut
15 organizimi në nivel brigade dhe pastaj urdhrin e Shtabit të
16 Përgjithshëm për luftim.

17 Z. KEHOE: [Përkthim] Sërish do i kërkoja Sekretares që të
18 kalojmë në faqen 9930 në provën materiale 712.

19 PY. Dëshmitar, e kuptoj që i treguat kolegut tim z. Emmerson
20 që këto organigrama pasqyrojnë situatën si duhet të kishte
21 qenë, jo domosdoshmërisht sesi ishte në terren. Ju këtu thoni
22 që ka një linjë të drejtpërdrejtë komandimi nga Tahir Sinani
23 te juve dhe pastaj vazhdohet më tej me linjën e komandimit në
24 departamentet dhe në zonat operative.

25 Besoj që na e thatë, po më korrigjoni në qoftë se e kam

1 gabim, kur Tahir Sinani nuk ishte i pranishëm kjo vija me
2 ndërprerje tregon përgjegjësinë e drejtpërdrejtë tek juve, në
3 qoftë se Tahir Sinani s'ishte i pranishëm i takon që ju kishit
4 përgjegjësi të drejtpërdrejtë sipas kësaj shigjetës me
5 ndërprerje, apo jo?

6 PË. Ju them të drejtën, z. Avokat, se ky organogram ka
7 funksionu për mrekulli në nivel zone, tash dallon nga ai
8 niveli i Shtabit të Përgjithshëm kur nuk ka qenë Tahiri, kam
9 qenë unë. Kur s'kam qenë unë, kanë qenë këta shefat e
10 departamentit G1, G2, G3 deri në G6, të cilët e kanë mbajtur në
11 mënyrë kolegjiale komandën e zonës. Po fati është që unë
12 asnjëherë s'kam mungu. Asnjë orë, asnjë ditë, asnjë minutë.

13 Ndërsa raportet me brigadat tani janë vendosë të
14 rregullta që kanë dhënë raporte komandantët e brigadave në
15 nivel të zonës dhe ato raporte janë biseduar dhe nxjerrë
16 konkluzione në briefingjet e zonës. Zona ka mbajtur briefing të
17 domosdoshëm një herë në javë, shumicën e rasteve dy herë dhe
18 në bazë të situatave ndoshta dhe përditë. Briefing u kuptua
19 rrjedha zinxhirore e komandimit zonë-brigadë-batalion-kompani
20 deri në skuadër.

21 Ky organogram i zonës komplet kështu ka funksionu. Siç
22 është. Kur s'ka qenë Tahiri, kam qenë unë. Tahiri ka mungu nja
23 dy raste ka pak, po pak dy-tri ditë, ka katër-pesë ditë. Nuk
24 ka mungu gjatë.

25 PY. Për të sqaruar nja dy tre pika. Tahir Sinani si komandant

1 në qoftë se atij i jepej një urdhër, në qoftë se i jepte
2 urdhër për komandat e brigadës, jo domosdoshmërisht ai duhej të
3 shkonte përmes jush, mund të t'i jepte në mënyrë të
4 drejtpërdrejtë urdhrat për to, apo jo?

5 PË. Sigurisht ai do t'i thirrte komandantët e brigadave dhe
6 do t'i jepte urdhra drejtpërdrejt. Po shumicën e rasteve kam
7 ndodhë dhe unë me kanë aty, përndryshe nuk kam qenë i detyrur.
8 Kur ai më autorizon mu, atëherë unë e kisha kry punën e tij,
9 po unë për me kry punën e tij ai duhet të mos të ishte aty.
10 Kur ishe vetë e kryente vetë.

11 PY. Në të njëjtën mënyrë ai kishte komandë edhe mbi brigadat
12 pro edhe mbi departamentet.

13 PË. Po.

14 PY. Pra, departamentet apo drejtoritë, siç i quani juve
15 departamente. Sa i takon departamenteve, asnjë departament nuk
16 kishte kompetencë mbi një departament tjetër, apo jo?

17 PË. Departamentet e zonës normalisht që duhet me segmentet e
18 tyre, duhet edhe ka qenë lidhja të funksionojë logjistika
19 përmes brigadave, batalioneve deri te populli, deri te
20 civilët, për furnizim me ushqim, me veshmbathje, me armë,
21 rrjeti i logjistikës. Departamenti numër 1 ka qenë
22 administrata që e ka evidentu, administru gjendjen ushtarake,
23 gjendjen e luftëtarëve.

24 Departamenti numër 2 ka qenë G2, që i kam thënë
25 zbulim/kundërzbulimi. Departamenti numër 3 ka qenë planifikim

1 operacional për operacionet e luftës, prita, bëtaja, lufta dhe
2 komandimet. Departamenti G4 ka qenë logjistika, që ka
3 furnizuar gjithë zonën me logjistikë, ushqime, veshmbathje,
4 armatim e të tjera. Departamenti G5 ka qenë marrëdhëniet
5 ushtarako-civile. Sabaudin Cenaj ka qenë profesori i lidhur me
6 popullatën për problemet civile. Departamenti G6 ka qenë
7 ndërlidhja. "Ndërlidhja" ka kuptimin me radiolidhje, me
8 telefona, me vëzhgues, me korrierë e të tjera.

9 Këto departamente i kanë pasë domosdoshmërisht ndërlidhjen
10 edhe me zonën edhe në nivelet e zonës, përmes në brigada dhe
11 nën vileve të brigadave. Domethënë, çdo departament u kanë i
12 lidhur me brigadën në sektorin e vet. Kanë ekzistuar këto lidhje
13 dhe kanë funksionuar këto lidhje.

14 PY. Sa i takon J1 dhe J3, ata a i raportonin mbrapsht Tahir
15 Sinanit, apo jo? Sepse edhe dje besoj që na thatë që edhe J2 i
16 raportonte Sinanit, apo jo?

17 PË. Të gjitha këto departamente i raportonin komandantit, po
18 zakonisht edhe bëhej në briefing, kur ndodhi briefing në
19 mëngjes apo në mbrëmje, shumë herë në mbrëmje për shkak të
20 rrethanave të luftës kur ndalej lufta. Sepse kur errësohej
21 bëhej vonë mbas darke, forcat serbe tërhiqeshin natën e kanë
22 pasë tmerr, nata ishte gjithmonë e jona, ditën ata dominonin.

23 Kështu që briefing raportohesh edhe nga këto G-ja që
24 thamë, të gjitha kanë raportu te Tahir Sinani.

25 PY. Dhe nuk ju vë faj që nuk donin të luftonin natën. Po që

1 të gjitha këto - G1, G2, G3 - pyetja është për përgjegjësitë e
2 komandës për tek Tahir Sinani se nuk shigjetë për tek
3 komandanti, pra, pyetja ime është që ishte kjo po ju thatë që
4 ata raportonin te Tahir Sinani.

5 Pra, në rast se kalojmë tek zonat -- më falni, mos doni
6 të thoni diçka?

7 PË. Po. Në aspektin teknik e pamundshme është me i marrë
8 shigjetat me i sjellë kështu edhe me i lidhë atje te
9 komandanti i zonës. Se shife ka janë këto shigjetat që barten
10 në mënyrë vertikale. Po t'i marrim krejt shigjetat kështu do
11 të ishte një konfuz.

12 PY. E kuptoj. E kuptoj që mendonit që të gjitha këto gjëra
13 t'i vendosnit në një faqe të vetme me gjithë shigjetat
14 përkatëse.

15 Por duke ju kthyer brigadave. 126 ju thatë që nuk filloj
16 deri në prill. 127 nuk ekzistonte. Po kjo ka qenë e njëjta gjë
17 edhe me 128, apo jo, as ajo nuk ekzistonte?

18 PË. Janë pak ma specifike këto tria që i përmendët. 126 ka
19 pasë funksionalitet si pjesë e Hasit me ushtarë dhe luftëtarë
20 prej fillimit të luftës. Mirëpo për t'u kompletuar diçka e
21 tillë si brigadë ka qenë shumë e vështirë se ajo pjesë goditej
22 nga forcat serbe, ishte pranë kufinit shqiptaro-shqiptar,
23 Kosovë-Shqipëri.

24 Tjetër, Brigada 127 ishte e caktuar të formohej në
25 Dragash, në Sharrë që i thojmë ne. Është caktuar komandant

1 Shefkat Halimi dhe zëvendëskomandant Bedri Halimi. Asnjëherë
2 nuk kanë arritur ta shtrijnë atë në nivel të brigada apo të
3 zonës. U shtri në një nivel kompanie jo më shumë. Dhe për atë
4 nuk quhet brigadë, quhet brigadë fiktive.

5 Brigada 128, e komanduar nga Ruzhdi Saramati. Kjo brigadë
6 fillet e lëvizjes së vet, të veprimeve të veta, të kontrollit
7 të kufinit, depërtimit në kufi, armatimit të sjellur nga
8 Shqipëria dhe depërtimit me njerëz anasjelltas Shqipëri-Kosovë
9 dhe Kosovë-Shqipëri ka funksionuar që nga fillimi i luftës dhe
10 në brendinë e saj ka pasë dikund 30 deri 60 ushtarë.

11 Me urdhër të Azem Sylës dhe prezenca ime aty ishte kur u bë
12 një telefon që urdhërohet Ruzhdi Saamati ta kompletojë
13 brigadën, t'i bëjë 1000 ushtarë dhe të futet në Kosovë. Kjo ka
14 qenë dikun në muajin prill 1999. Mirëpo futja e kësaj brigade
15 realisht u realizue bashkë me futjen e Shigjetës, operacioni
16 Shigjeta kur organizohet më 24 maj 1999.

17 Kjo brigadë u kompletua edhe me një segment tjetër që
18 ishin të ndara nëpër TF, TF1, TF2, TF3, TF0. Këto grupime
19 ishin task forca të shpejta për t'u fut në Kosovë gati në
20 përfundim të luftës, po ne nuk e kemi ditë se po përfundon
21 lufta.

22 Dhe kjo brigadë në momentet e fundit arrin një numër
23 1.300 deri në 1.600 ushtarë. Brigada 128.

24 PY. Në rregull. Faleminderit. Faleminderit, zotëri. Vetëm për
25 arsye të kohës do të kalojmë tek diagrami tjetër që është

1 prova 712 dhe ky është urdhri që është dhënë për betejën në
2 nivel brigade. Megjithatë ja ta shikojmë.

3 Nuk ka shumë pyetje për Dëshmitarin. Thjesht dëshiroj që
4 të sqaroj edhe njëherë që kemi drejtoritë S1, S2, S3, S4, S5,
5 S6, të gjitha raportojnë tek 123. Kjo është vetëm për Brigadën
6 123, pra raportojnë tek Gëzim Hazrolli, apo jo?

7 PË. Është shumë e vërtetë. Këto normalisht iu dashtë ta
8 ruajnë lidhjen me G-t e zonës, me drejtoritë e zonës dhe të
9 përkatëset siç janë S1, S2, S3, S4, S5, S6 duhet të raportonin
10 edhe te G1, G2, G3, G4, G5. Mirëpo këto edhe për shkak të
11 rrethanave relievit gjeografik të situatës në luftë këto
12 raportonin vetëm tek komandanti i vet Gëzim Hazrolli. Ka pasë
13 ndoshta ndonjëherë edhe ndonjë raport spontan.

14 PY. E kuptova, zotëri. Ju faleminderit. Të kalojmë tek tre
15 batalionet po të jetë e mundur. Kemi tre batalione. Flasim për
16 batalionin e parë. Dhe aty kemi tre kompani, Kompania 1, 2 dhe
17 3. Pra, nëse e kuptoj mirë, në këto batalione, me kompanitë
18 përbërëse, ka një vijë të drejtë. Me anën e saj ju nuk po
19 thoni që kompania e parë ka autoritet, pra, mbi të dytën dhe e
20 dyta mbi të tretën, apo jo? Thjesht të tria janë të lidhura
21 bashkë për te batalioni, apo jo?

22 PË. Jo. Këto i lidh batalioni. Batalionet lidhen me brigadën.
23 Zakonisht në normat ushtarake duhet të jenë tri e më shumë
24 kompani që ta formojnë një batalion. Tri e ma shumë togje ta
25 formojnë një kompani. Tri e më shumë skuadra ta formojnë një

1 tog.

2 Po nuk do të thotë se vetëm kështu kanë qenë. Ka pasë
3 edhe më shumë. Ka pasë jo veç tre togje, jo veç tri kompani.
4 Po ka pasë në disa raste, për shembull, batalioni i Budakovës
5 ka pasë katër kompani, ka pasë njësi tjera të veçanta, diku në
6 nivel brigade gati ka qenë, po është quajt batalion, për shkak
7 të modestisë. S'kem dash të fryhemi me ato emra.

8 PY. E kuptova. E kuptova. Po, po të gjitha ushtritë duan ta
9 bëjnë këtë deri në një farë pike, zotëri. Po thjesht për ta
10 sqaruar, thjesht për arsye se janë të lidhura me këtë vijën e
11 pandërprerë, domethënë, njëra kompani nuk ka përgjegjësi mbi
12 tjetrën, Kompania 1 mbi 2, 2 mbi 3?

13 PË. Përgjegjësi horizontale nuk kanë pasë dhe nuk kanë mund
14 të kenë për shkak se në ushtri shkon përgjegjësia vertikale.
15 Dhe për shkak të pozitive, pozicioneve gjeografike, kur ato
16 kanë qenë të lidhura në qendër te brigada. Jo në mes veti.
17 Përndryshe bashkëpunim ka pasë *full* ta quaj kështu në gjuhën e
18 juaj, të plotë. Bashkëpunim ka pasë të plotë.

19 PY. E kuptova. E kuptova. Faleminderit, Dëshmitar. Dhe tani
20 dëshiroj që të flasim për një grafik tjetër që është
21 gjithashtu me numrin përkatës së është 00209329.

22 Dhe e kuptoj që i thatë z. Emmerson, kolegut tim, që do
23 t'ju duheshin ose as 30 organigrama nuk do të mjaftonin për ta
24 krijuar panoramën e plotë. Dhe këtë e thatë në faqen 90 në
25 rreshtin 16 dhe 17, pra, që "ky është pasqyrim i situatës siç

1 duhet të kishte qenë, siç duhet të kishte funksionuar”.

2 Dhe thjesht dëshiroj të flasim pak së bashku se kjo ka
3 ndodhur përpara Rambujesë. Kemi patur Sokol Bashotën, Bislim
4 Zyrapin dhe këtu pasqyrohet periudha dy javore me ç’mbaj mend
5 unë, kur ju keni qenë tek J1, apo jo?

6 PË. Ky organogram don zbërthyer dhe më tutje. Unë në planin
7 tim e kam dhe njëherë me ribotu këtë libër. Duhet për çdo
8 katror, çdo pozicion këtu të paraqiten edhe detyrat dhe
9 veprimet e atij pozicioni, asaj detyre ku e ka marrë personi.
10 Këtu ndërrojnë dy organograme janë të Shtabit të Përgjithshëm.
11 Një është në fillim të librit, një në fund.

12 Ai në fund ndryshon se Azem Sylja bëhet ministër i
13 Mbrojtjes. Ndërsa shefi i shtabit bëhet Agim Çeku. Dhe kam
14 mund t’i bëjë veç dy ndryshime të theksime për t’u kuptu se
15 organogrami ka pasë ndryshime mbrenda vetes. Po vetëm me qenë
16 film se ndryshe nuk mund ët bëhen ato ndryshime me organograme
17 sa herë kanë lëvizë. Kështu ka qenë.

18 PY. E kuptoj që ju jeni përpjekur që të gjitha këto gjëra t’i
19 vendosni në letër dhe në libër. E kuptoj. Dhe ju po thoni që
20 jeni përpjekur që ta bëni dhe sa më të vogël në faqe që të
21 jetë e mundur që të kuptohet.

22 Megjithatë të gjitha këto raste që ishin, këto instanca
23 nën shefin e shtabit, këto janë të gjitha drejtori që janë të
24 ngjashme me drejtoritë që kishit ju dhe në nivel zone
25 operative, apo jo?

1 PË. Përafërsisht njëjta degëzime, i njëjti qëllim dhe njëjta
2 vijë që duhet të ishte. Edhe në nivel të shtabit ka pasë
3 logjistikë, ka pasë J2, ka pasë J1, J3, J4, bile është e
4 veçanta që në nivel shtabit u dash të ketë më shumë drejtori
5 sepse nëse e marrim sikur nivelet politike në nivel komunal
6 dhe nivel qendror, në nivel republike strukturat e qeverisë
7 dhe të shtetit janë më të mëdhaja se strukturat e një komune.

8 Në nivel ushtarak strukturat e Shtabit të Përgjithshëm
9 janë ma të gjera më të mëdha apo duhet të ishin, më drejtë
10 është duhet të ishin, sesa të nivelit të zonës ose të
11 brigadës. Për atë dhe është marrë ky organogram është dhe ma i
12 madh i Shtabi Përgjithshëm më shumë ka funksione, më shumë
13 drejtori dhe ma shumë duhet të kishte akoma.

14 PY. Atëherë t'i kthehem pak asaj dhe të krahasojmë
15 drejtoritë me zonën tuaj operative, me atë organigram,
16 drejtoritë në zonën tuaj operative, në kuptimin e gatishmërisë
17 për betejë, ishin në formë horizontale, ndërsa këtu për arsye
18 hapësire i keni bërë në formë vertikale, apo jo?

19 PË. Po. Kështu është.

20 PY. Për shembull, ju si shefi i J1 ose askush tjetër në fakt
21 nuk është se kishte përgjegjësi komande mbi ndonjë drejtori
22 tjetër si, për shembull, J2, apo jo?

23 PË. Jo. Ato bashkërisht nëse është marrë ndonjë vendim në
24 ndonjë mbledhje të veçantë janë bërë vendime të përbashkëta.
25 Përndryshe ndikim horizontal ose në atë kuptimin komandim

1 horizontal nuk ka pasë. Nuk ka pasë.

2 PY. Atëherë Azem Syla po ashtu edhe Zyrapin i bie që, Sokol
3 Bashotën gjithashtu, që kanë në fakt kontroll, sipas kësaj të
4 paktën edhe pse në fakt kjo i kalonte Azem Sylës, apo jo?

5 PË. Realisht përgjegjësinë duhet ta kishte komandanti i
6 përgjithshëm Azem Syla. Po Azem Syla ka munguar tën kohën
7 sepse ka qëndru në Shqipëri. Këtë rol e ka luajt Sokol Bashota
8 derisa ka qenë prezent, po si duket edhe këto role që janë
9 paraqitë këtu nuk janë luajtur asnjë 20 për qind ashtu siç e
10 duhet. Vetëm kanë qenë të menduara, të vendosura, të
11 koordine, të caktume, funksionale s'kanë qenë.

12 PY. Dhe në vijën e drejtorisë, në të majtë, ne kemi Hashim
13 Thaçi si drejtor politik. Dhe kjo është e ngjashme me
14 drejtoritë J1 deri në 6, apo jo, që i keni këtu vertikale, apo
15 jo?

16 PË. Jo, jo. Kjo ka kuptimin sikur në një qeveri legale
17 ekzistuese, qeveri shteti, kryesor ka qenë për këtë normal
18 sikur t'i përkthenim në civil, Adem Demaçi ka qenun
19 përfaqësues politik sikur do të ishte president, për t'u kuptu
20 drejt fusha ushtarake. Te civilët do të ishte president. Në
21 fushën ushtarake ka qenë përgjegjës politik për luftërat.
22 Hashim Thaçi ka qenë drejtori politike e cila do të ishte e
23 ngjajshme me këto drejtoritë, po nuk është emërtue në bazë të
24 asaj J1, j2, J3, J4 po drejtori politike. Nuk u emëru për
25 shkak se nuk ka qenë e kompletume kurrë. Për shka ka qenë

1 vetëm i zgjedhuri Hashim Thaçi i vendosur me dy-tre persona
2 dhe s'u kompletu si drejtori për ta quajt një J1 apo J2 apo
3 J3. Dhe mbetet këtu drejtoria politike që përfaqëson Hashim
4 Thaçi.

5 Me sa njerëz ka pasur nuk e di. Presidenti a këtu, shqyr
6 që e kemi gjallë, ai tregon po besoj që dy-tre vetë rreth vetë
7 i ka pasë.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar, e kuptoj që ora ka shkuar
9 tashmë 11.00. Mund, ndoshta një gjë të cilës mund t'i kthehem
10 me një pyetje.

11 PY. Do t'i kthehemi kësaj gjëje pas pak, Dëshmitar.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
13 tashmë do të bëjmë një pushim prej gjysmë ore dhe do të
14 kthehemi në sallë në orën 11.30. Mos harroni dhe njëherë që
15 nuk mund të flisni me askënd me dëshminë tuaj këtu në sallë
16 deri pas përfundimit të kësaj çështjeje. Dhe Sekretarja do
17 t'ju shoqërojë.

18 DËSHMITARI: Faleminderit. Faleminderit, Gjykatës.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbyllim
21 seancën.

22 --- Pauza fillon në orën 11.01

23 --- Seanca rifillon në orën 11.30

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

25 Sekretare mund ta sillni në sallë dëshmitarin.

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Për shkak të kohës dhe në interes të
2 saj besoj që do të mbaroj përreth gjysmë ore.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe një
4 herë, ju lutem?

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Besoj që për gjysmë ore do t'i
6 përfundoj pyetjet e mia.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk po
8 ankohe.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Ju lejohet që të ankoheni, i
10 nderuar.

11 [Dëshmitari vijon dëshminë]

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
13 Dëshmitar. Mund të vijojmë me pyetjet nga z. Kehoe.

14 Z. KEHOE: [Përkthim]
15 PY. Dëshmitar, besoj që përreth gjysmë ore unë do t'i mbaroj
16 pyetjet e mia. Kështu që edhe pak na mbetet.

17 Më lejoni që t'u kthehem disa çështjeve më shumë në
18 lidhje me fjalët e përdorura dhe me grushtin në kohën e
19 Rambujesë. Këto ishin fjalët -- nuk ishin fjalët e mia, meqë
20 ra fjala.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Por nëse mund të vendosim këtu
22 Shënimin Përgatitor numër 2 të ZPS-së me numrin 116830, ju
23 lutem, dhe të shikojmë faqen 2, paragrafin 7 të saj. E kuptoj
24 që nuk është në gjuhën shqip dhe për këtë arsye unë do ta
25 lexoj me ngadalë atë në anglisht.

1 PY. Në fund të faqes janë këta tre rreshta. Ky është një
2 shënim që janë shënime që ka mbajtur ZPS-ja në intervistë me
3 ju më 10 nëntor dhe këtu thuhet, pika e 7-të:

4 "Pas 9 shkurtit, pasi të gjithë të tjerët u larguan për
5 në Rambuje, ata", për komandantët e zonave, "bënë një grusht
6 ushtarak dhe vendosën Sylejman Selimin si komandant të UÇK-së,
7 por ai nuk e kreu rolin e tij për shkak se katër nga shtatë
8 zona nuk e njihnin atë si të tillë".

9 Pyetja ime është: Këto gjëra që keni thënë këtu a janë të
10 sakta?

11 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj, sepse Avokati Mbrojtës
12 në fakt i ka keqtrajtuar faktet, sepse ai duhet të thotë që...

13 Z. KEHOE: [Përkthim]

14 PY. A është e saktë që ju thatë që komandantët e zonave kanë
15 bërë grusht ushtarak?

16 PË. Jo, komandantët e zonave nuk kanë bërë grusht ushtarak,
17 por një eksponent i zonave, për shembull, Rustem Mustafa ka
18 qenë i zonës së Llapit dhe Ramush Haradinaj i zonës së
19 Dukagjinit. Njëkohësisht Sylja ka qenë, Sylejman Selimi
20 komandant në zonën e Drenicës. Këta të tre janë pajtu bashkë
21 me ndikimin e sigurisht të Drinit, Ekrem Rexhës dhe prezencën
22 dhe ndikimin e shefit të shtabit, Zyrapi; këta janë tubuar
23 diku në Klinë - nuk e di vendin saktësisht, mos të manipuloj -
24 dhe kanë bërë një vendim të tillë; kanë caktuar Sylejman Selimin
25 komandant të përgjithshëm. Kjo ka ndodh kështu.

1 PY. Faleminderit.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të flas për një çështje që
3 ka dalë në procesverbal. Në fakt këtu bëhet fjalë për Remin,
4 Rrustem Rrustemi që dha dëshmi. Pra, jo Rrustem Rrustemi,
5 Rrustem Mustafa, Remi.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të
7 saktësohet apo nëse doni që të sqarohet më tej kjo çështje z.
8 Kehoe me dëshmitarin?

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, faleminderit, i nderuar. Po.
10 PY. Pra, Dëshmitar, mendoj që ndoshta kemi patur një gabim
11 tek emri. U vunë emrat e komandantëve të zonës. Pra, Rrustem
12 Mustafa bëhej fjalë, jo Rrustem Rrustemi; ndërsa Rrustem
13 Mustafa vinte nga zona e Llapit.

14 PË. Rrustem Mustafa. Këtu shkruan në anglisht Rrustem
15 Mustafa, nuk e di pse e keni ngatërruar ju. Mirë është e
16 shkrume. Rrustem Mustafa - Remi. Pseudonimi "Remi".

17 PY. Në fakt po e sqaronte pala Mbrojtëse tjetër, por le t'i
18 kthehemi tashmë diagramës, dhe ju thamë, dhe ju thatë në fakt
19 përpara pushimit që:

20 "Hashim Thaçi ishte drejtori politik që ishte e ngjashme
21 me drejtoritë e tjera, por që nuk kishte emërtim të tillë, për
22 shembull, J1, J2, J3. Ishte thjesht drejtori për arsye se nuk
23 pati personel. Ishte thjesht Hashim Thaçi aty me dy apo tre
24 vetë. Pra, nuk kishte të gjithë personelin e duhur, kuadrot e
25 duhura që të kishte edhe emërtimin J1, J2, J3. Ishte thjesht

1 një drejtori politike e cila përfaqësohej nga Hashim Thaçi.

2 A është e saktë kjo? A mund ta shpjegoni pak këtë gjë
3 edhe më shumë, ju lutem?

4 PË. Nuk kam çka të shtoj kësaj. Është ashtu siç e thatë ju
5 dhe Hashim Thaçi ka qenë me ndikimet e veta politike, me
6 politikat e luftës më tepër është marrë me takimet e
7 diplomatëve që kanë ardhë të takojnë UÇK-në, sesa që është
8 marrë me ndonjë punë të veçantë, ndonjë urdhër të veçantë s'ka
9 pas nga Hashim Thaçi, s'ka pas as të drejtë ta jep atë urdhër.
10 Nuk ka pas autoritet, s'ka qenë i urdhrave, urdhërdhënës. Nëse
11 kërkoni këtë, z. Kehoe. Hashim Thaçi ka qenë drejtor i
12 drejtorisë politike. Domethënë, ka të bëjë me politikat e
13 luftës, me diplomacinë e luftës; nuk ka të bëjë me anën
14 operacionale, anën luftarake, anën urdhëruese. Kështu e kuptoj
15 atëherë e kam kuptu edhe sot, e kuptoj kështu.

16 PY. A do të ishte më e saktë po të thonim që z. Thaçi merrej
17 me politikën e luftës ose aspektet politike të luftës, sesa,
18 për shembull, politikat e ndryshme të luftës?

19 PË. Nuk e di ku e shihni ju dallimin mes kësaj politikat e
20 luftës dhe politikën e luftës. Megjithatë, do të përpiqem ta
21 them unë si e kam kuptuar.

22 Përfaqësuesi politik i UÇK-së ka qenë Adem Demaçi. Hashim
23 Thaçi ka qenë i një drejtorie politike. Domethënë, ka bë një
24 shërbim në kuadër të asaj politikës të lufte, q'atyne
25 politikave të luftës. Kështu e kam kuptu, kështu e kuptoj edhe

1 kështu duhet të jetë.

2 PY. Zotëri, ju thatë që drejtorja politike ishte tmerrësisht
3 e vogël dhe e tillë sa nuk merrte dot emërtimin J1, J2, J3.

4 PË. Sigurisht që ka qenë i atij niveli të ngushtë. Atëherë e
5 din ma mirë ta shpjegojë z. President është këtu. Përndryshe
6 ajo nuk e ka pas një nivel çfarë dëshironim ne, a çfarë do ta
7 dëshironte lufta, të ishte një parti politike me programe
8 politike, me udhëheqje të politikave të luftës, por ka qenë
9 një drejtori politike. Kështu.

10 PY. Dhe ju keni thënë, në faqen 51. Po përpiqem të kuptoj
11 rreshtin e duhur. Ju lutem, një sekondë. Më falni, në faqen 40
12 në rreshtin 20 thuhej që:

13 "... ai nuk e kishte, nuk ishte i autorizuar që të jepte
14 urdhra, për të lëshuar urdhra".

15 Megjithatë, nga njëra anë, ai, pra, nuk i lëshonte dot
16 urdhrat Xhavit Halitit apo Sokol Dobrunës që janë në anën e
17 majtë të këtij diagrami?

18 PË. Jo atyne, por askujt, as ne në nivelet më të ulëta ai
19 s'ka qenë i autorizum, s'ka qenë autoritet, detyra e tina s'ka
20 qenë të lëshojë urdhra. Detyrë e urdhërdhënësit është
21 komandanti i përgjithshëm, shefi i shtabit e të tjerë.

22 PY. Atëherë do të ishte e drejtë të thuhej nga ky diagram
23 detyra e tij ishte për Azem Sylën dhe Sokol Bashotën dhe deri
24 në njëfarë pike edhe Bislím Zyrapit?

25 PË. Jo deri njëfarë pike, por ma shumti ka kry punë Bislím

1 Zyrapi si shef i shtabit. Përgjegjësinë kuptohet e ka
2 komandanti i përgjithshëm, por punët dhe organizimin,
3 menaxhimin, vendimet, urdhrat më së shumti janë bë përmes
4 Bislum Zyrapit. Nuk e di pse dashtët ju ta minimizoni deri në
5 njëfarë pike. S'e di deri ku është ajo pikë.

6 PY. Është e qartë në këtë moment, Dëshmitar, që Hashim Thaçi
7 nuk ishte i autorizuar, nuk kishte autoritet që të urdhëronte
8 ndokënd apo jo, askënd?

9 PË. Jo, nuk përshkruhet detyra, vendi i punës, qëndrimi,
10 pozicioni i tij nuk përshkruhet me dhënien e urdhrave;
11 përshkruhet me bërjen e politikave. Kaq, sa ka mund të bëj
12 është çështje e tij.

13 PY. Në lidhje me këtë diagram, po të shikojmë pjesën e
14 poshtme te zona 1 kemi Sami Lushtakun. Ndërkohë që në Drenicë
15 kemi pasur -- ka qenë Sylejman Selimi komandant i zonës apo jo
16 përpara Rambujesë?

17 PË. Para se -- para Rambujesë dhe para Sami Lushtakut ka qenë
18 Sylejman Selimi. Më herët nuk ka pas, nuk ka pas zonë.
19 Kuptohet kanë qenë në nivel brigadash. Ka qenë Fehmi Lladrovci
20 komandant brigade; i brigadës tjetër ka qenë Ilaz Kodra e
21 kështu me radhë. Si komandant i asaj zone ka qenë Sylejman
22 Selimi derisa është shpallur komandant i përgjithshëm. Tani
23 pas tij atë rol e ka luajt Sami Lushtaku, komandant i zonës
24 operative të Drenicës.

25 PY. E kuptoj që është -- ndërrohen aq shumë njerëzit,

1 domethënë, sa është ndoshta e vështirë, si një shënjestër që
2 lëviz në vetvete.

3 Z. KEHOE: [Përkthim] Por të kalojmë te diagrama e fundit
4 nëse është e mundur e cila ka emërtimin DHT02715.

5 PY. Këtu, në fakt -- nuk e di a e kemi edhe në shqip këtë
6 organigramë.

7 Në fakt është e njëjta organigramë, por më pas periudha e
8 konferencës së Rambujesë. Dhe siç e shikoni Sylejman Selimi
9 është në krye dhe Agim Çeku është shefi, është shefi i
10 shtabit. Dhe kjo në fakt është pas Rambujesë apo jo? Se Azem
11 Syla është ministri i mbrojtjes apo jo?

12 PË. Po kam dash ta vejë në spikamë në këtë fotografim kështu
13 vizual, ta vejë se ndryshimet që kanë ndodhur nga Rambujeja e
14 prapa ish-in kështu, pra, Sylejman Selimi ishte komandant i
15 përgjithshëm dhe Agim Çeku ishte shef i shtabit të
16 përgjithshëm në vend të Bislir Zyrapi.

17 PY. Dhe kjo ka ndodhur pas Rambujesë kur Çeku, atëherë kur
18 Çeku u bë shef shtabi dhe Azem Syla u përfshi pastaj edhe në
19 qeverinë e përkohshme si ministër i mbrojtjes apo jo?

20 PË. Kjo ka ndodhur se për shkak se Bislir Zyrapi më 1 prill
21 ka shkuar në drejtim të Shqipërisë për ta organizuar
22 operacionin Shigjeta dhe në Kosovë ka mbetën UÇK-ja pa shef
23 shtabit dhe si i tillë është emëruar më 17 prill Agim Çeku,
24 shefi i shtabit.

25 PY. Kur shikojmë këtë diagram të gjitha gjërat përveç

1 personelit që largohet, të gjitha gjërat e tjera janë të
2 njëjta si ato që ju keni thënë në diagramën e mëparshme apo
3 jo? Pjesa e autoritetit, zinxhiri i komandës që Thaçi nuk mund
4 të jepte urdhra ndonjërit me zinxhir komande.

5 PË. E njëjta është sikur organigrami i parë. Përpos këtyne
6 ndryshimeve që i kam vu në spikamë këtu që i shihni edhe ju,
7 të tjerat janë të njëjta, pozicionet dhe urdhrat në mënyrën
8 horizontale nuk janë dhënë. Ndoshta kena mund shoqërisht,
9 organizativisht me thirrë njëri-tjetrit dhe me shku në ndihmë
10 të njëri-tjetrit është konë shumë normale, por për ta udhëru
11 dikënd u dashtë të jetë zinxhiri vertikal i komandës. Hashim
12 Thaçi nuk ka vertikalisht vartës të vet për t'i urdhëruar.
13 Nëse ka urdhëruar, ka urdhëruar q'atë ekip të vogël që ka pas
14 rreth veti. Unë nuk di kën e ka pas edhe sa i ka pas. S'ka pas
15 autoritet t'i urdhërojë të tjerët.

16 PY. Dhe ju këtu thatë që pas Rambujesë dhe z. Emmerson ju
17 bëri disa pyetje që për kohën e Rambujesë po përpiquej që të
18 krijohej qeveria e përkohshme, është e saktë kjo? Do të hymë
19 në disa detaje, por kjo ishte e saktë apo jo?

20 PË. Pas kthimit nga Rambuje, pas emërtimit të ministrit të
21 qeverisë së përkohshme ka fillu të bëhet kompletimi i
22 strukturave të qeverisë së përkohshme. Pas Rambujesë.

23 Z. KEHOE: [Përkthim] Atëherë më lejoni që t'ju tregoj
24 dokumentin SPO000225650. Edhe në shqip duhet të jetë pak a
25 shumë me të njëjtin emërtim.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04765 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Kehoe

Faqe 64

1 PY. Kjo është një -- pra, marrëveshja për të krijuar
2 pikërisht edhe qeverinë e përkohshme të Kosovës me -- e
3 nënshkruar nga z. Hashim Thaçi, Dr. Ibrahim Rugova dhe Rexhep
4 Qosja. Ju a e keni ditur këtë marrëveshje që është bërë për të
5 krijuar qeverinë e përkohshme?

6 PË. Po e kemi ditë dhe e kemi pranë si të tillë. Hashim Thaçi
7 ka udhëhequr edhe delegacionin atje, ka qenë përgjegjës,
8 udhëheqës i delegacionit shqiptar, tuj përfaqësuar UÇK-në dhe ka
9 përfaqësuar Kosovën.

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Pranohet si provë, i nderuar. Dua ta
11 ofroj si provë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E keni fjalën
13 02715?

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, i nderuar.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
16 kundërshtim, z. Pace?

17 Z. PACE: [Përkthim] Ndjesë. Thatë 02715? Se nuk është
18 dokumenti që është në ekran.

19 Z. KEHOE: [Përkthim] Dokumenti në ekran, Gjykatës, është
20 SPOE00225650. Ndjesë në rast se e thashë gabim.

21 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim që ky dokument
22 të pranohet.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
24 dokumenti.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do t'i japim ERN-në e

1 duhur dhe të plotë e cila është SPOE00225650 deri në
2 SPOE00225650 dhe përkthimi anglisht do të jetë Prova Materiale
3 1D69 dhe është konfidenciale.

4 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim që të hiqet
5 niveli konfidencial, sepse është dokument publik. Megjithatë,
6 e keni ju në dorë.

7 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam kundërshtime për ta
8 riklasifikuar si dokument publik.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 1D69 tashmë
10 urdhëroj që të riklasifikohet si dokument publik.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Nëse mund të vendosim në ekran
12 SPOE0054541. Ky është një dokument për të cilin u fol edhe nga
13 pala tjetër Mbrojtëse dje. Një moment, nëse është e mundur, i
14 nderuar Gjykatës.

15 PY. Ky është një dokument me datën 2 prill në Prishtinë, duke
16 treguar edhe pozicionet në qeverinë e përkohshme. Ju e dini,
17 zotëri, që kjo gjë po ndodhte. Pra, po krijoheshin pozicionet
18 e duhura për qeverinë e përkohshme apo jo?

19 PË. Po, ne ishim në dijeni, por nuk ka pyet kush neve dhe as
20 nuk na ka propozu së pakti të jemi edhe ne dikushi. Por ne
21 kena pas më të rëndësishme me e çliru Kosovën; dikush e ka pas
22 më të rëndësishme me u pozicionu në qeveri. Kështu që janë
23 ndarë rolet.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar, do të kërkoja që ky
25 dokument të pranohet si provë dhe të ofrohet, pra, si provë.

1 Është dokumenti SPOE00054541.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
3 kundërshtime?

4 Z. PACE: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime dhe është
5 dokument publik.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE00054541
7 pranohet dhe riklasifikohet si publik.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar, atëherë kjo
9 do të jetë Prova Materiale 1D70.

10 Z. KEHOE: [Përkthim]

11 PY. Më duket se këtë gjë e përmende dje, Dëshmitar dhe në
12 rast se po mund ta kalojmë me shpejtësi këtë pjesë. Në
13 procesverbal, në transkriptin e përkohshëm në faqen 85,
14 rreshti 23 ku ju keni thënë:

15 "Mendoj që pas Rambujesë riorganizimi kaloi drejt krijimit
16 të qeverisë së përkohshme dhe jo të konsolidimit të shtabit të
17 përgjithshëm. Dhe ia thashë edhe Zyrës së Prokurorisë që shumë
18 pak vëmendje iu kushtua luftës. Ne e bëmë atë; komandantët e
19 brigadës".

20 Pra, ndërkohë që këta personat politikë po krijojnë
21 qeverinë e përkohshme ju në terren duhet të vazhdonit luftën
22 kundër serbëve apo jo?

23 PË. Ashtu është, sepse ne nuk mund të zgjidheshim rrugë
24 tjetër. Derisa luftohet çdo ditë, sidomos nga granatimet,
25 fillimi i granatimeve të NATO-s, serbët kanë rrit dominimin e

1 sulmit; kemi pasur çdo ditë luftë. Këta janë marrë më shumë me
2 atë se si ta bëjnë qeverinë e përkohshme. Na jemi konë të
3 detyrum ta mbajmë barrën e luftës.

4 PY. Që të rikthehemi pak, gjatë periudhës së Rambujesë kur po
5 përpiqen që të krijojnë qeverinë, nuk është se po bëjnë diçka
6 për të konsoliduar Shtabin e Përgjithshëm. Kështu që për sa i
7 përket luftës ju dhe kolegët tuaj në terren ishit ata që po
8 luftonit, jo personat që po krijonin qeverinë apo jo?

9 PË. Ashtu është, ashtu është.

10 PY. Dhe që të jemi tërësisht të sinqertë, Dëshmitar, në këtë
11 periudhë kohore ju po luftonit kundër forcave serbe dhe kjo
12 ishte një përpjekje shumë e madhe e fortë, sepse pati shumë të
13 dëmtuar, të lënduar, shumë civilë që u desh të lëviznin,
14 ndërkohë që ju ishit në terren, duke luftuar apo jo?

15 PË. Ashtu është, z. Avokat.

16 PY. Mendoj që duhet të flasim edhe për këtë tani. Megjithatë,
17 mbaj mend që ju keni thënë që ju ishin dhënë dy urdhra nga
18 Shtabi i Përgjithshëm gjatë kësaj kohe. Njëri ka qenë urdhër
19 mobilizimi dhe njërin, tjetrin ia dhatë me ndërlydhje, në
20 fakt, për civilët, për t'u kujdesur për ta që ju po e bënit
21 gjithsesi apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Pra, përveç këtyre dy urdhrave ju nga Shtabi i
24 Përgjithshëm nuk ju ka ardhur gjë tjetër, nuk ju vinte gjë
25 tjetër apo jo?

1 PË. Mua s'më kujtohet që ka ardhë ndonjë urdhër i veçantë.

2 PY. Dhe edhe kur dikush nga Shtabi i Përgjithshëm ka ardhur
3 për t'ju takuar si Zyrapi, ju thjesht jeni takuar me të disa
4 herë apo jo?

5 PË. Disa herë, po.

6 PY. Më lejoni që t'ju tregoj një urdhër për të cilin ju keni
7 folur në intervistën tuaj.

8 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe ka numrin, megjithëse më duket
9 se ky dokument është konfidencial, pasi ka dalë nga një lëndë
10 tjetër. Kështu më kujtohet, kështu që ndoshta nuk duhet ta
11 shfaqim në ekran për publikun këtë dokument, ju lutem.

12 Gjithsesi është IT-05 --

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
14 çaktivizuar]

15 Nuk do ta shfaqim dokumentin.

16 Z. KEHOE: [Përkthim] Dhe jam i sigurt që është më mirë që
17 të jemi të kujdesshëm.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta
19 ndryshojmë më vonë këtë gjë.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Po. Ju kërkoj ndjesë. Mendova se
21 ishit në telefon.

22 Është IT-05-87.1 P0040 [sipas përkthimit] -ET -- Ea, ju
23 kërkoj ndjesë. Jo ET, Ea. M'u duk si T, por qenka A.

24 PY. Ky urdhër është urdhër nga Remi që thotë, që ndiqet, ka
25 ardhur pas në takim të Shtabit të Përgjithshëm. Dhe ju thoni

1 që ju keni qenë në Shtabin e Përgjithshëm më 5 janar të vitit
2 1999 dhe nuk ka ndodhur ndonjë takim dhe ju nuk besoni se ky
3 ka qenë urdhër nga Shtabi i Përgjithshëm apo jo?

4 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj, i nderuar Gjykatës,
5 sepse Mbrojtja nuk e ka shprehur faktin siç duhet.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Më falni. Jo komandant Remi;
7 komandant Drini. Ju kërktoj ndjesë. Faleminderit.

8 PY. Është urdhër nga Drini.

9 PË. Me 5 janar nuk ka pas asnjë mbledhje në Shtabin e
10 Përgjithshëm. Kam qenë unë aty, nuk ka pas mbledhje. Dikun
11 tjetër nëse u mbajt pa dijeninë time. Nuk është konë e
12 domosdoshme që unë me e dit. Ka mund të mbahet dikun, por unë
13 nuk kam njohuri që është mbajt një takim i tillë.

14 PY. Ju i keni thënë ZPS-së, kjo edhe sipas shënimit
15 përgatitor kur e keni parë këtë urdhër që nuk menduat që ky
16 ishte urdhër i vlefshëm, sepse përderisa ky është një urdhër i
17 Shtabit të Përgjithshëm nuk mund të nënshkruhet nga Drini dhe
18 që nuk mendonit që më 5 janar të '99-s të ketë patur ndonjë
19 takim të Shtabit të Përgjithshëm. Sepse 5 janari është në
20 dokument dhe ju në atë datë keni qenë në Shtabin e
21 Përgjithshëm.

22 "Kjo ka qenë mënyra se si Drini sillej në atë kohë. Ai
23 donte të tregonte sikur ishte komandant i UÇK-së edhe kur UÇK-
24 ja hyri në Prizren, por ai ishte thjesht në krye të Akademisë
25 Ushtarake në atë kohë".

1 A e mbani mend që ia keni thënë ZPS-së këtë gjë, zotëri?

2 PË. Krejt është ashtu siç e thatë ju.

3 PY. Dhe ju besoni që ky urdhër është Drini që po përpiqet të
4 tregojë autoritetin e Shtabit të Përgjithshëm sikur e ka ai,
5 kur nuk e ka në fakt këtë autoritet.

6 PË. Realisht ashtu, por këtu është nënshkrimi; nuk është i
7 Drinit, por dikush e ka nënshkruar për Drinin që thotë "për"
8 dhe del Skënder Çeku, S. Çeku.

9 Nuk e kuptoj --

10 PY. Por është gjithsesi në emër të --

11 PË. Po, është në emër të Drinit, e vërtetë, ashtu siç e thatë
12 ju.

13 PY. Dhe qëndrimi juaj është që ky urdhër nuk është i vlefshëm
14 edhe pse thuhet që vjen nga Shtabi i Përgjithshëm.

15 PË. S'ka mundësi në emër të Shtabit të Përgjithshëm që të
16 ketë nënshkruar dikush "për" që nënkuptohet kush është, po as
17 Drini nuk ka qenë atëherë anëtar i Shtabit.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar, ofrojmë për provë këtë
19 dokument, IT-05-87.1 P00040 [sipas përkthimit] Ea. Edhe një
20 herë dokument konfidencial edhe pse nuk jam i sigurt nëse ende
21 e ka -- është ende konfidencial apo jo.

22 Z. PACE: [Përkthim] Informacioni im është që në fakt mund
23 të jetë ofruar, por gjithsesi nuk kemi kundërshtim.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
25 çaktivizuar]

1 Z. KEHOE: [Përkthim] Jam përpjekur që ta bëj këtë edhe më
2 parë.

3 DËSHMITARI: Kryegjykatës, një korigjim. Vetëm një
4 korigjim të vogël.

5 Thashë se e ka nënshkruar për Drinin dikush. Tash e
6 vërtetova që qenka Sylejman Kollçaku, nënshkruesi, që ta keni
7 ju të qartë. Nënshkruesi këtu ku thotë, "Për Ekrem Rexhën"
8 është Sulejman Kollçaku. Jam i sigurt.

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Shumë faleminderit për këtë sqarim,
10 Dëshmitar.

11 Z. PACE: [Përkthim] Tani e shoh që nuk është pranuar,
12 megjithatë, nuk kemi kundërshtim.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
14 Dokumenti IT-005-8875 [sipas përkthimit] pranohet në provë
15 materiale së bashku me përkthimet në anglisht.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po dhe do të marrë
17 numrin e Provës Materiale PD701 [sipas përkthimit] dhe cili
18 ishte vendimi sa i takon klasifikimit?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do
20 riklasifikohet si publike.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Kam një pyetje të fundit. Bëhet
22 fjalë për diagramën e fundit që identifikohet fillimisht si
23 DHT02715. Është vetëm në anglisht. Megjithatë është dokumenti
24 të cilit ne i kemi përmendur dhe më përpara dhe që ka të bëjë
25 me periudhën e konferencës së Rambujesë.

1 Z. PACE: [Përkthim] E kuptoj që ky diagram është krijuar
2 për ta bërë më të qartë shpjegimin në librin e dëshmitarit.
3 Megjithatë nuk është se kemi kundërshtim në qoftë se Mbrojtja
4 do kërkojë që të pranohet në provë materiale.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] Po e mbajtëm shënim. Bëhet fjalë
6 vetëm për një faqe, në qoftë se, domethënë thjesht sa për ta
7 sqaruar dhe për të mos pasur probleme me versionin e
8 përkthyer.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vetëm për një
10 faqe bëhet fjalë?

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Po.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe -- cili
13 është numri i këtij dokumenti?

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Është DHT0715.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
16 DHT027152 [sipas përkthimit] pranohet si provë materiale dhe
17 do klasifikohet si publike.

18 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, faleminderit.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, po
20 dhe caktohet numri i Provës Materiale 1D72 për të.

21 Z. KEHOE: [Përkthim] Sa i takon vendit ku e kemi marrë
22 këtë dokument, pra, është marrë në dokumentin më të gjatë
23 SPOE0020940. Nuk e di në qoftë se ndokush do jetë i interesuar
24 për ta gjetur se ku është marrë ky si fragment. Megjithatë, në
25 qoftë se palët janë të interesuar ky është numri i referencës.

1

2 Të nderuar Gjykatës, më lejoni një moment, ju lutem.

3 [Mbrojta këshillohet]

4 Z. KEHOE: [Përkthim]

5 PY. Ju mora më shumë sesa 30 minuta pas pushimit. Megjithatë

6 tani nuk kam më pyetje të tjera për ju. Faleminderit shumë për

7 kohën.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,

9 z. Kehoe.

10 Z. Roberts, fjala për ju.

11 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

12 Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts:

13 Z. ROBERTS: [Përkthim]

14 PY. Mirëdita, z. Halitjaha.

15 PË. Mirëdita.

16 PY. Unë quhem Geoff Roberts dhe jam Avokati i Mbrojtjes i

17 Rexhep Selimit. Kam disa pyetje për ju. Besoj që do zgjasin

18 edhe pas pushimit të drekës për nja gjysmë ore.

19 Së pari, dua që të mendoni pak për shkurtin e '98-s. Kjo

20 ka të bëjë me diçka që ju keni përmendur në dëshminë e dhënë

21 për Prokurorinë. Në atë kohë UÇK-ja, UÇK-së i referoheshin si

22 terroristë.

23 Z. ROBERTS: [Përkthim] Kështu që në këtë pikë dua që të

24 paraqes në ekran një deklaratë nga një përfaqësues i Shteteve

25 të Bashkuara që është Roberts Gelbard dhe që është Prova

1 Materiale DHS00079 [sipas përkthimit]. Do t'ju lexoj një
2 fragment të tij në mënyrë të tillë që pastaj t'ju bëj pyetje
3 dhe të na jepni shpjegimet përkatëse.
4 PY. Është dokumenti që është vetëm në anglisht, kështu që në
5 mënyrë që të kursejmë kohë do ta lexoj. Pra, është
6 përfaqësuesi i posaçëm; është 22 shkurt 1998 dhe në të thuhet
7 që:

8 "Në të njëjtën kohë neve e kundërshtojmë një grup dhe
9 luftimet të cilat kanë ndodhur nga policia, nga një grup që e
10 quajnë veten UÇK. Siç e kam thënë edhe më përpara ne këto i
11 konsiderojmë veprime terroriste që është një politikë e fortë
12 kjo e Shteteve të Bashkuara për të kundërshtuar veprimet
13 terroriste dhe aktet terroriste si të gjitha organizatat
14 terroriste".

15 A e keni dëgjuar këtë deklaratë më përpara, në atë kohë,
16 a ju kujtohet ta keni dëgjuar këtë deklaratë, Dëshmitar?
17 PË. Po, e kam dëgjuar. Janë ndikimet e politikës jugosllave,
18 propagandat jugosllave edhe sot UÇK-në e quan terroriste. Po
19 UÇK-së nofka e terrorizmit ju ka heqën me vizitën e Holbrooke
20 në Junik kur është taku drejtpërsëdrejti me UÇK-në. E ka pa se
21 UÇK-në është një organizatë luftarake me uniformë, me shenja
22 luftarake, me komandë, me zinxhir komandues, ka thonë është
23 organizata çlirimtare, jo terroriste. Nga ai moment na u ka
24 heq ajo farë nofke e keqe.

25 PY. Po. Në fakt parashikuat pyetjen që planifikoja t'ju bëja

1 më pas se kisha si synim që të gjurmonim pak këtë lloj
2 evolucioni ose zhvillimi. Kjo është deklaratë e cila është
3 bërë në '98 kur juve si UÇK ju drejtoheshin si terroristë që
4 ishte diçka shumë e debatueshme dhe siç thoni juve dukej sikur
5 kjo përsëriste pikëpamjet e regjimit të Millosheviqit.

6 Si pasojë, pas tre muajsh, se kur thoni kur erdhi
7 Holbrooke për të vizituar Kosovën; e keni fjalën për qershorin
8 e '98-s?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe shkoi në Junik, kështu thatë apo jo? Pak a shumë në
11 të njëjtën kohë kur ju mbërritët në Kosovë, pak a shumë kjo ka
12 qenë periudha apo jo?

13 PË. Pak pas mbërritjes time ka qenë në Junik. Është takua me
14 Hajdin Abazin, me nofkën "Lum Haxhiu" dhe atje ka pa që ka një
15 qendër komanduese, ka uniforma, ka shenja, simbole, kanë armë
16 dhe kanë zinxhir komandues, kanë rregull organizativ. Dhe nga
17 ai moment nuk është quajt grup terrorist, por është quajt
18 organizatë çlirimtare.

19 PY. E qartë. E keni përmendur këtë edhe në deklaratën që i
20 keni dhënë Prokurorisë. Për procesverbal është Prova Materiale
21 P707.3, Pjesa 3, faqja 3. Dhe fakti që juve më pas iu
22 drejtoheshin si organizatë çlirimtare, si ushtri çlirimtare,
23 kjo ishte një gjë shumë e rëndësishme për juve si UÇK apo jo,
24 Dëshmitar? Kështu që ju po përpiqeshit që t'i tregonit
25 Holbrooke se sa e organizuar ishte ushtria. Domethënë, ishte

1 një lloj ushtrimi i marrëdhënieve publike, në qoftë se mund ta
2 quajmë kështu apo jo? Ishte një lloj demonstrimi i
3 marrëdhënieve publike nëse mund të shprehem kështu.

4 PË. Ju keni të drejtë, z. Avokat, ashtu ishte dhe ne e bëmë
5 tamam punën që të na vlerësojnë aleatët që ne jemi për çlirim.
6 Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka qenë ushtri mbrojtëse
7 çlirimtare, lufta jonë ka qenë e drejtë, por asnjëherë nuk
8 është pretenduar, as këtu nuk e kam dëgju te ju të thuhet që
9 ka qenë edhe e pastër. Më së paku në botë, nëse ka bë luftë
10 ndonjë organizatë luftarake, ndonjë ushtri ka më së paku në
11 botë dëme kolaterale. Sepse ne s'kemi pas mjete të
12 sofistikume, të granatojmë e të vrasin 100 njerëz përnjëherë.
13 Te ne janë vra njerëz një për një, me ka një plumb dhe nuk ka
14 dëme kolaterale dhe nuk mund të quhet luftë civile, sepse ne
15 s'kemi bë luftë me civilët. Kisha dashtë këtë ta keni
16 parasysh.

17 PY. E kuptoj plotësisht. Ajo çfarë keni diskutuar me kolegët
18 e mi, domethënë sa i takon fazës ose nivelit të organizimit të
19 njësiveve, të njësive në atë ka qenë e bazuar te vullnetarët,
20 tek puna vullnetare. Po ashtu ju i keni dhënë dhe përshtypjen
21 z. Holbrooke sa i takon uniformave dhe rregulloreve të
22 caktuara. Domethënë kjo ishte pjesë e përpjekjes tuaj për t'iu
23 demonstruar, për t'iu treguar Shteteve të Bashkuara që ju
24 ishit partner me ta dhe nuk ishit terroristë. A është e saktë
25 kjo, Dëshmitar?

1 PË. Vërtet ka qenë grupe fillimisht vullnetare dhe ushtri
2 vullnetare, por ka pas një tekst të betimit sikur unë që u
3 betova këtu te ju, dhe nuk është shkel ai betim që është betue
4 se do të jetë i disiplinun, të respektojë urdhrat, rregullat
5 dhe ka pas rregull Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Dhe kjo është
6 vërtetu edhe për Holbrooke edhe për aleatët tanë dhe UÇK-ja
7 ishte ajo që solli aleatët në Kosovë. E vetmja ushtri që
8 lufton në tokën e Kosovës kundër pushtuesit serbo-sllavë pa
9 dalë asnjë centimetër jashtë Kosovës; mbrojtja vetëm shtëpitë
10 e veta dhe tokën e vet, popullin e vet. Prandaj u pranua si
11 luftë e drejtë, mbrojtëse çlirimtare. Po unë du këtu të
12 potencoj që të pranohet edhe si luftë e pastër, jo vetëm si
13 luftë e drejtë.

14 PY. Nuk e vë fare në pikëpyetje këtë gjë. Po thjesht po
15 përpiqem që të kuptoj pak kontekstin në të cilin keni folur me
16 z. Holbrooke në atë kohë. Z. Holbrooke ishte përfaqësues i
17 qeverisë së Shteteve të Bashkuara dhe ju kërkonit që të kishit
18 mbështetjen e kësaj qeverie në atë kohë apo jo?

19 PË. Sigurisht, sigurisht edhe janë bë përpjekje edhe të tjera
20 për të ardhë deri te një bashkëpunim dhe një aleancë me
21 Amerikën, Anglinë dhe shtetet europiane.

22 PY. Po. Ju po kryenit marrëdhënie me publikun, në qoftë se
23 mund të shprehem kështu, në drejtime të ndryshme. Por qëllimi
24 kryesor ishte drejt vendeve anëtare të NATO-s që ju shpresonit
25 që t'ju ndihmonin, t'ju mbështesin në konfliktin tuaj, kështu

1 Dëshmitar?

2 PË. Po ne kemi pas përfaqësues të UÇK-së në diplomacinë
3 evropiane dhe botërore që ka qenë Jashar Salihu, Bardhyl
4 Mahmuti, ka qenë Ramadan Avdiu, Sabri Kiqmari e të tjerë që na
5 kanë përfaqësue nëpër instancat e ndryshme ndërkombëtare si në
6 OKB si në shtetet e ndryshme dhe janë kriju aleanca për ta
7 ndihmuar Kosovën.

8 PY. Disa muaj më pas në tetor z. Holbrooke -- jo, të kthehemi
9 pas. Në atë kohë në qershor, korrik, a është e drejtë të themi
10 që ju prisnit që të pësonit një ofensivë nga forcat serbe; e
11 prisnit ofensivën nga serbët, është e drejtë kjo?

12 PË. Ne e prisnim një ofensivë nga forcat serbe. Kishim
13 informacione dhe ka qenë një tentativë që duhet ta them, mbasi
14 jam këtu para kësaj Gjykate, jo për juve si avokat por për
15 Gjykatën. Ka qenë një tentativë të merren vesh Ibrahim Rugova
16 dhe stafin e vet për një qeveri teknike me Millosheviqin dhe
17 më vonë tjetra marrëveshje që u tentu me Millutinoviqin dhe në
18 këtë marrëveshje me Millosheviqin, që është fjala ata u morën
19 vesh që Millosheviqi ta asgjësonte UÇK-në. Ndërsa këta [e
20 pakuptueshme] ta ndihmojnë rrëzimet e qeverisë Nano në
21 Shqipëri për të ardhë Sali Berisha dhe të mos -- furnizohet
22 UÇK-ja me njerëz dhe me armë nga Shqipëria të bllokohet atje.
23 Kështu që ofensivën e gushtit e kemi prit dhe ofensiva e
24 gushtit është ajo që ka bë ato përçarjet edhe dezertimet edhe
25 dëmtimet edhe shpartallimet e UÇK-së në shumë pjesë të

1 Kosovës.

2 PY. Pra, në qershor kur Holbrooke ju vizitoi pas ca muajsh ku
3 kishit fituar territore të reja në Kosovë, ju prisnit që
4 forcat serbe të mësynin me ofensivë. Dhe në fakt ata mësytn
5 me ofensivë në shator dhe në tetor 1998, kështu?

6 PË. Ofensiva më e madhe e tyre ka qenë më 22 gusht, 23, 24,
7 25 gusht. Pastaj ka pas edhe ofensiva të shtatorit 1, 2, 3, 5
8 shtator si dhe 22, 24, 27 shtator.

9 PY. Kjo çoi në mes të tetorit që të arrihej një marrëveshje
10 ndërmjet Holbrooke dhe Millosheviqit e cila, të paktën
11 përkohësisht çoi në dhënien fund të luftimeve në atë fazë. E
12 kam fjalën këtu për mesin e tetorit, në mos gaboj apo jo?

13 PË. Në mesin e tetorit është konë një marrëveshje që
14 Millosheviqi t'i pranojë vëzhguesit ndërkombëtarë në Kosovë
15 dhe të krijohet një armëpushim i cili është respektuar nga
16 UÇK-ja, por nuk u respektua nga pala serbe.

17 PY. A pajtoheni me mua që kjo pjesërisht ishte si rezultat i
18 përpjekjeve diplomatike të z. Holbrooke që reflektonte për
19 ushtrimin e marrëdhënieve publike që ju kishit dëshmuar më
20 përpara? Domethënë, që të dëshmonit që ju ishit të organizuar,
21 ishit një organizatë si UÇK.

22 PË. E vërteta është ashtu siç e thoni ju. Por për ta bind
23 edhe z. Holbrooke edhe botën ne ishim të vendosur të
24 rezistojmë deri në çlirim ose vdekje. Dhe pozicionet tona disa
25 nga pozicionet që duhet t'i përmendi janë konën të pakalueshme

1 për forcat serbe siç ishte Budakova, Zatriqi, Kleçka.

2 Asnjëherë forcat serbe s'kanë mund ta marrin nën ushtrimin e
3 tyre --

4 PY. Po.

5 PË. -- nën pushtimin e tyre dhe kjo e ka bërë faktorin
6 ndërkombëtar të mendojë se ne jemi të gatshëm për të vdekur
7 për lirinë tonë dhe sigurisht edhe është ndikue në diplomaci
8 që të na përkrahin.

9 PY. Po. Faleminderit.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do ju kërkoja që përgjigjet t'i
11 kishit sa më të shkurtra të jetë e mundur, në mënyrë të tillë
12 që të përfundojmë me marrjen tuaj në pyetje sa më shpjet të
13 mundemi dhe në mënyrë që të mund të ktheheni në shtëpi.

14 PY. Por ajo çfarë doja të nxirrja në pah ishte që ju po
15 përpiqeshit që t'i demonstronit, t'i tregonit Shteteve të
16 Bashkuara që ishit të organizuar dhe mbase në këtë proces
17 merrnit "hua koncepte prej tyre ose rregullore të ushtrisë"
18 dhe besoj që këtë e dëshmuat edhe përmes pyetjeve që ju bëri
19 Mbrojtja e z. Veseli dje. Domethënë që merrnit ose huazonit
20 koncepte ushtarake nga Shqipëria, nga Shtetet e Bashkuara,
21 Franca, Gjermania. Kështu ka qenë, Dëshmitar?

22 PË. Ashtu është.

23 PY. Nuk e di në qoftë se më kuptuat.

24 PË. Ashtu është. S'du me shtua asnjë gjë.

25 PY. Kjo ndodhte që edhe nëse konceptet që huazonit nga vendet

1 e tjera ishin të huaja, të panjohura për ju. Domethënë edhe
2 UÇK-ja në këtë kuptim nuk është se kishte ndonjë kuptim të
3 mirë të këtyre koncepteve ose strukturave që lidheshin me to.
4 Pavarësisht këtyre ju njësoj i huazuat këto koncepte apo jo?
5 PË. Ne nuk i huazuem; i adaptuam në kushte dhe rrethana tona
6 duke u bazuar në traditën tonë kombëtare dhe të kaluarën e
7 luftërave tona për liri. Se shqiptarët janë i vetmi popull që
8 kurrë s'kanë pushtuar asnjë territor të huaj, asnjë popull
9 tjetër. Jam shumë krenar që jam shqiptar.

10 PY. Sikurse edhe e diskutuat edhe me avokatin e z. Veseli ju
11 patë aty rregulloret disiplinore dhe diskutuat dje që në fakt
12 kishte shumë koncepte të cilat nuk pasqyronin realitetin. Në
13 qoftë se doni mund t'ju tregoj edhe në ekran po besoj që e
14 diskutuam këtë gjë dje.

15 PË. Unë besoj që u ezaurua ashtu siç e lamë dje. Mos t'ia
16 hupim kohën Gjykatës.

17 PY. Jo, e vërtetë është kjo. Tani le të kalojmë te një pjesë
18 e kësaj që është me interes për klientin tim. Dua të flasim
19 për rolin e inspektorit të përgjithshëm. Besoj se e mbani mend
20 që këtë e keni diskutuar në faza të ndryshme në intervistën me
21 ZPS-në. Do e paraqesim edhe një herë në ekran atë çfarë keni
22 thënë në mënyrë të tillë që të rikujtoheni për përmbajtjen.

23 Së pari, dua të kuptoj rolin dhe çfarë pjesë keni pasur
24 juve për të luajtur sa i takon kësaj kohe. Unë e kuptoj që ju
25 keni qenë asistent-komandant për moralin në zonën e Pashtrikut

1 nga fundi i '98-s deri rreth 17 marsit të '99-s. A e kam

2 kuptuar drejt, Dëshmitar?

3 PË. Drejt.

4 PY. Besoj se në intervistën që i keni dhënë ZPS-së ju ka

5 treguar Prokurori një dokument ku jepeshin përgjegjësitë e

6 shtabit të komandës së UÇK-së për zonën e Pashtrikut. A ju

7 kujtohet ta keni parë këtë dokument gjatë intervistës me

8 Prokurorinë, Dëshmitar?

9 PË. S'e di për cilin dokument është fjala.

10 PY. Mirë.

11 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do kërkoj që të paraqitet në

12 ekran. Është dokumenti ERN U000-6462. Do i kërkoja Sekretares

13 të paraqesë versionin në anglisht dhe në shqip. Të kalojmë në

14 faqen U000-6463.

15 PY. Në fund të kësaj faqeje, shpresoj që të mund ta lexoni në

16 versionin në shqip, Dëshmitar. Këtu përshkruhen detyrat,

17 detyrimet dhe roli i ndihmëskomandantit për moralin dhe

18 informimin. Nuk e di, e lexoni dot? Në qoftë se nuk është e

19 lexueshme për juve na thoni se mund t'jua përkthejmë,

20 Dëshmitar.

21 Z. PACE: [Përkthim] Përpara, sesa të vazhdojmë më tej

22 Mbrojtja tha që bëhet fjalë nga -- për një dokument të zonës

23 operative të Pashtrikut. A mund t'i tregojmë faqen e parë

24 dëshmitarit që të kujtohet drejt nga për çfarë dokumenti bëhet

25 fjalë që të mos ketë keqkuptime?

1 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk ka asnjë keqkuptim.

2 Megjithatë, në qoftë se e vendosni që të paraqesë faqen e parë
3 mund ta bëjë këtë gjë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
5 vazhdoni me pyetjen.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim]

7 PY. Dëshmitar, a e lexoni dot tekstin në shqip përpara? E di
8 që është kopje e vështirë; nuk është e qartë. Në qoftë se nuk
9 e lexoni dot mund t'jua lexoj unë në anglisht dhe mund ta
10 merrni përmes përkthimit.

11 PË. Është shumë e turbullt; nuk mund të lexohet mirë; nuk
12 mund të lexohet edhe fare gati. Dhe ju thatë që po bëni pyetje
13 për klientin e juve, çka ka të bëjë ky dokument me klientin.

14 PY. Do të arrijmë edhe te kjo pika. Shpresoj që të jetë e
15 qartë. Megjithatë, për momentin më lejoni që të lexoj detyrat
16 në anglisht.

17 "Zëvendëskomandanti për moralin dhe informacionin -
18 detyrat e tij është ngritja e moralit tek ushtari dhe tek ish-
19 ushtarakët. Është i obliguar që t'i vizitojë ushtarakët në
20 pikë kazemat; të shpjegojë në aspektin historik që jemi në
21 okupacion; që të shpjegojë dhe të ndjekë zhvillimet aktuale në
22 vend dhe në botë. Të mbajë shënim sukseset e ushtrisë dhe të
23 shpjegojë këto suksese ushtarëve dhe është detyrë e këtij
24 personi që t'i informojë ata për rëndësinë e ngjarjeve".

25 A pasqyron ky përshkrim natyrën e përgjegjësive që keni

1 pasur ju kur keni luajtur këtë rol, kur keni qenë në këtë

2 post, Dëshmitar?

3 PË. Deri diku. Po pse nuk ma jep komplet ta shoh. Është prej
4 rregullores apo është ndonjë urdhër i cilës komandë është dhe
5 kush është ai kaq i meçëm që i ka përcaktu detyrat kështu.

6 PY. Patjetër.

7 PË. Duhet ta di. Kujt i -- nga kush po e marrë këtë.

8 PY. Do i kërkoja Sekretares të kalojmë te faqja e parë. Kjo u
9 kërkuar edhe nga Prokurori. Në fakt, edhe shpresoj që t'ju
10 ndihmojë faqja e parë. Ky është dokumenti të cilin juve, për
11 të cilin ju diskutoni edhe në intervistën me Prokurorinë.

12 PË. Nuk janë të përshkruara si duhet detyrat dhe obligimet
13 dhe nuk e di kush e ka lëshu këtë dokument. Këto paraqet
14 detyrë edhe për komandantin --

15 PY. E kuptoj.

16 PË. -- se çfarë duhet t'i ketë detyrat komandanti dhe nuk
17 përcakton drejt nivelet komanduese. A është fjala për komandën
18 qendrore apo është fjala për në Prizren për nivel të zonës së
19 Pashtrikut apo nivel të një brigade. Është një dokument i
20 hartuar nga dikush që ka shumë ngjashmëri me ato që kemi pasur
21 ne si detyra por nuk është i pranueshëm si dokument; nuk e kam
22 pranuar as te Prokurori. Nuk ka relevancë.

23 PY. Jo. Thjesht unë po mundohesha që të mësoja se cilat ishin
24 detyrat e përgjegjësitë kryesore tuajat dhe thjesht po
25 mundohesha që të jepja një dokument si bazë për të përshkruar

1 detyrat dhe përgjegjësitë që kishit. Çfarë detyrash dhe
2 përgjegjësish të tjera kishit përveç atyre që lexuam?

3 PË. Po ju tash pyetni për mua apo për klientin e juve? Nëse
4 duhet për mua unë ju flas ton ditën --

5 PY. Jo, po flasim për juve, për ju personalisht, Dëshmitar.

6 PË. -- le të më jep leje Gjykatësi, le të më jep leje
7 Gjykatësi unë foli sa të dush për mu.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetja ishte:
9 Çfarë detyrash të tjera, përgjegjësish të tjera kishe si
10 komandant për moralin?

11 DËSHMITARI: Z. Gjykatës, pyetja është shumë e gjerë që
12 unë s'po du ta mundoj këtë Gjykatë. Përndryshe unë jam shumë i
13 vetëdijsëm çfarë detyra kam pas edhe çfarë kam bë në punën
14 time. Sikur me ju pyet ju, çka jeni ka boni si Gjykatës.

15 Detyra e komandantit për moral dhe politikë ka qenë të
16 zhvillojë moralin; ta ngrisë moralin te ushtarët; të shpjegojë
17 domosdoshmërinë e luftës; të shpjegojë drejtësinë e luftës; të
18 shpjegojë normat ndërkombëtare për të drejtat në luftë; të
19 shpjegojë se si të sillen ushtarët me të plagosurit, me të
20 dorëzuarit, me civilët, me njerëzit e paarmë, me njerëzit që
21 nuk kanë dëme, nuk i bëjnë askujt dhe të bashkëpunohet me
22 civilë, të bashkëpunohet me ndërkombëtarët, të bashkëpunohet
23 me diplomacinë ndërkombëtare.

24 Është një -- gamë shumë e gjonë e detyrave. Më erdhi keq
25 kështu t'ju marrë kohën.

1 Nëse ju duhet folni konkret se çka duhet --

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, na ndihmon goxha.

3 PË. -- unë jam këtu, direkt.

4 PY. Faleminderit. Na ndihmon shumë. Është e rëndësishme për
5 ne për të kuptuar se cili është roli dhe është e dukshme që
6 keni përfshirë një lëmë të gjerë kompetencash, përfshirë këtu
7 edhe bisedat me ushtarët në brigadën tuaj në mënyrë të tillë
8 që ata të kuptonin siç duhet kërkesat, detyrimet. Dhe përveç
9 kësaj, siç e thoni, detyra juaj ishte që të bashkëpunonit me
10 diplomacinë ndërkombëtare.

11 Ky post vinte nga strukturat ushtarake në Shqipëri apo
12 nga ku? Domethënë, ky posti i komandantit për moralin nga ku e
13 keni marrë ose ndihmëskomandantin për moralin më mirë?

14 PË. Unë kam studiu materiale të shumta luftarake dhe e njoh
15 artin ushtarak shumë mirë. Në kohën që kam qëndru në Shqipëri
16 gati viti 1988 e deri në fund gati të këtij viti, 6 muaj, atje
17 kam lexu rregullore të ndryshme; kam parë normativa të
18 ndryshme që rregullojnë raportet mes ushtrisë dhe civilëve dhe
19 kam pas njohur për këto detyra t'i kry e t'i realizoj në
20 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Prandaj jam i njohur shumë
21 mirë në këtë fushë.

22 PY. Ky post në vetvete, pra, ka një komandant ose
23 ndihmëskomandant për moralin në sistemin shqiptar, e dini ju
24 këtë apo jo? Domethënë ka një post të tillë analog në
25 Shqipëri?

1 PË. Ky ka gjithkund edhe në Amerikë edhe në Angli edhe në
2 Shqipëri, ndihmëskomandant për moral dhe politikë në çdo
3 ushtri të botës moderne dhe demokratike.

4 PY. Pra, kjo ishte diçka që personat të cilët kanë pasur
5 përvojë të mëparshme ushtarake që kanë qenë pjesë e JNA-së.
6 Domethënë, me këtë koncept dhe me këto poste ato njiheshin,
7 kështu i takon apo jo?

8 PË. Jo. Ato kanë qenë poste komuniste. Dhe ata nuk e kanë
9 pasë për moral-polik por kanë pasë komisar, komisar politik.
10 Komisari ka qenë me grada dhe me vlera më të fuqishme kanë
11 ndiku se sesa komandanti. Në sistemet moniste. Ndryshon kjo
12 punë.

13 PY. Në rregull. Tani le të kalojmë tek inspektori i
14 përgjithshëm. Besoj se i keni thënë Prokurorit në intervistën
15 e parë në vitin 2020 lidhur me rolin e inspektorit të
16 përgjithshëm në UÇK. Z. Selimi ishte shefi i inspektoratit.
17 Kam përshtypje që me këtë ju keni dash të thoni që ishte
18 inspektor i përgjithshëm apo jo, Dëshmitar? Është e saktë kjo?

19 PË. Inspektor i përgjithshëm ka qenë. Është menduar që të
20 jetë një inspektorat, po ka mbetën vetëm me inspektorin edhe
21 disa shoqërues të vet.

22 PY. Kur thua që ka "mbet vetëm me inspektorin", e keni fjalën
23 që ka qenë vetëm z. Selimi?

24 PË. Vetëm z. Selimi me dy-tre shoqërues të tjerë.

25 PY. Në rregull. Ky post, kjo pozitë besoj që ju -- e

1 përshkruani dhe do lexoj një fragment nga intervista e parë me
2 ZPS-në.

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Pyetja jepet në Provën Materiale
4 P707.1, Pjesa 1, faqja 20 si në shqip dhe në anglisht. Nuk
5 është e nevojshme që të transmetohet.

6 PY. "PY. Cilat ishin detyrat e inspektorit të përgjithshëm?".

7 "PË. Për të inspektuar terrenet e luftës, pozicionet që
8 të inspektonte se cilët ishin kushtet e shërbimit ushtarak të
9 ushtarëve, të bazave dhe vendeve ku ishin të shpërndara ata.
10 Unë nuk e kam pas këtë rol. Personi që e ka pas këtë rol mund
11 t'ju thotë më shumë".

12 PË. Edhe tani po ju them ashtu. Personi që e di më mirë, ai
13 duhet të flet për detyrat e veta, po ashtu siç e kam thënë unë
14 qëndron.

15 PY. Po. Po përpigemi që të kuptojmë se çfarë ndërveprimi keni
16 pasur ju me inspektorin e përgjithshëm dhe çfarë njohurie ke
17 pasur lidhur me rolin e tij në atë kohë. Gjithashtu i keni
18 thënë Prokurorit që ky posti i inspektorit të përgjithshëm
19 vinte nga vendet e NATO-s dhe nuk përkonte me ndonjë pozicion
20 që kishte JNA-ja? A ju kujtohet t'ia keni thënë Prokurorit
21 këtë, Dëshmitar?

22 PË. Besoj që po. Nuk më kujtohet, por besoj që ashtu ia kam
23 thënë. S'po du me e lodh trunin ta di a ia kam thënë a jo.
24 Mendoj që ashtu ia kam thënë.

25 PY. Do lexoj saktësisht çfarë keni thënë në mënyrë të tillë

1 që të jemi të qartë. Për procesverbal është Prova Materiale
2 P707.1, Pjesa 1, faqja 20 dhe pastaj faqja 21 në shqip. Pyetje
3 lidhur me inspektorin e përgjithshëm:

4 "A përkonte ndonjë pozicion me JNA-në ky pozicion, a
5 ishte një pozicion që ekzistonte dhe në ushtri të tjera me sa
6 dini ju?".

7 Ju përgjigjeni si më poshtë:

8 "Strukturat e ushtrisë jugosllave ishin të ndryshëm.
9 Ishin tërësisht struktura komuniste dhe ishin të ngjashme me
10 strukturat e Bashkimit Sovjetik dhe me strukturat e
11 Shqipërisë. Dhe sa i takon strukturave tona ne jemi përpjekur
12 që të krijojmë struktura të ngjashme me NATO-n, megjithëse nuk
13 arritëm dot në atë nivel. Sepse mendonim që po të kishim
14 struktura të ngjashme atëherë rrugëtimet tona do të ishim të
15 ngjashme ose të njëjta".

16 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

17 PË. E saktë është. Gjithmonë jena përpjek të kemi rrugën e
18 njëjtë, strukturat e ngjashme, përshëndetje të ngjashme,
19 sjellje të ngjashme për të na bashkuar me aleatët. E saktë
20 është.

21 PY. Atëherë kjo është në përputhje edhe me punën që bëhet për
22 marrëdhënie me publikun që diskutuam më parë për z. Holbrooke
23 apo jo?

24 PË. Keni të drejtë, keni të drejtë.

25 PY. Atëherë që të jemi të qartë, ata që kishin shërbyer te

1 JNA-ja, tek ushtria jugosllave në çfarëdo lloji kapaciteti si
2 komandant Drini apo Bislum Zyrapi, nuk do ta dinin se çfarë
3 bënte inspektori i përgjithshëm. Do ishte e drejtë ta thonim
4 kështu?

5 PË. Jo. Në logjikën e çdonjërit duhet të kuptohet roli i një
6 inspektori. Inspektori inspekton, kontrollon, vëzhgon, shiqon
7 dhe informon se çfarë gjendje është në atë mjedis. Për çdo
8 njeri normal t'i thuhet se ka ardhë inspektori i tregtisë ai e
9 din se çfarë bën inspektori i tregtisë. Ka ardhë inspektori
10 ligjor dihet se çka bën; ka ardhë ai ushtarak kuptohet. Jo,
11 nuk do të thotë se s'e dinin atë të tjerët çka bën ai.

12 PY. Po ata në ushtritë e tyre në cilat kanë shërbyer nuk kanë
13 patur inspektor të përgjithshëm, a është e saktë kjo? Pra, në
14 rast se nuk kishte patur inspektor të përgjithshëm në ushtrinë
15 jugosllave ata nuk do të kishin patur fare të bënin me një
16 inspektor të përgjithshëm në ato ushtri në të cilat kanë
17 shërbyer apo jo?

18 PË. Në ushtrinë jugosllave ka qenë një qendër e
19 inspektoratit, por ajo është thirrre Gene.

20 PY. Po kjo është ndryshe nga koncepti i inspektorit të
21 përgjithshëm.

22 PË. Krejt ndryshe, krejt ndryshe është, krejt ndryshe.

23 PY. Kuptojmë. Thjesht për të qenë të qartë, si komandant
24 batalioni ose më saktë si ndihmëskomandant për moralin dhe për
25 këtë po flisnim edhe pak përpara, pak minuta përpara, ju

1 inspektonit gjë trupat në mënyrë që, për shembull, të kryenit
2 detyrat dhe detyrimet që ju kishit, të gjitha ato detyrime të
3 cilat ju na i shpjeguat qartazi?

4 PË. Unë si detyrë temen kam kryen, detyra e para ka qenë të
5 luftoj dhe kam qenë gjithmonë nëpër vijat e zjarrit. Si
6 komandant batalioni në çdo betejë kam marrë pjesë. Por edhe si
7 ndihmëskomandant për moral ai nuk më ka rezervu që unë mos të
8 jem në vijat e para; kam pas edhe vërejtje prej Bislir Zyraripit
9 se komandanti duhet të rrijë një distancë më mbrapa që ta
10 ruajë veten për të qenë funksional edhe më tutje UÇK-ja. Unë
11 s'kam pas mundësi të rri më mbrapa për shkak të moralit
12 luftarak të ushtarëve u dashtë të jem në vijën e parë
13 vazhdimisht me ushtarët. Dhe kështu ka qenë.

14 PY. Po, në mënyrë që të vlerësonit gatishmërinë e tyre për të
15 luftuar ju duhet që të shkonit të flisnit me ushtarët dhe të
16 kuptonit në ç'situatë ishin ata. Kjo është e logjikshme apo
17 jo?

18 PË. Ato biseda që ka mund të bëhen janë bë nëpër brifinget
19 tona ku kemi majt si zonë dhe në kontaktet me nivelin
20 komandues të brigadave. Dhe rastin siç e kemi pas me edukimin
21 dhe përgatitjen e komandantëve të batalioneve në nivel të
22 zonës dhe më gjerë.

23 PY. Me rolin që ju kishit ju shkonit për të inspektuar
24 ushtarët në vendet të ndryshme dhe e kam fjalën në rolin tuaj
25 si ndihmëskomandant për moralin.

1 PË. Jo, z. Avokat. Keni ngatërru rolin. Nuk kam qenë unë i
2 detyrum me shku me inspektu grupe të ushtarëve ose njësi
3 luftarake nëpër terren, por unë kam udhëheq një vijë morale
4 politike të ushtarëve në përgjithësi se s'kam mundësi. Është e
5 pamundshme një njeri të shkojë në çdo pikë, në çdo vend te çdo
6 grup. Sidomos në zonën teme ku ka pas rreth 10 000 ushtarë,
7 dhe një territor i shtrimë deri 30 për qind të veprimtarisë
8 luftarake të kësaj zone; 30 për qind të territorit të Kosovës.
9 PY. E kuptova.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] A është e mundur që të vendosim në
11 ekran një dokument i cili shpjegon raporte për mënyrën e
12 organizmit dhe atë ushtarake dhe luftarake të batalionit të 2-
13 të. Ka emërtimin ERN SPOE00226697. Nëse është e mundur që në
14 ekran ta vendosim si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë
15 angleze.

16 PY. A e shihni dokumentin në ekran, Dëshmitar?

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Dhe nëse mund të shikojmë faqen e
18 parë si fillim e më pas, pas rreth 10 sekondash do kalojmë te
19 SPOE0022647 [sipas përkthimit].

20 PY. Në versionin anglisht rreth 5 rreshta më poshtë se
21 fillimi i bëhet një referim për faktin që:

22 "Inspektova forcat e pozicioneve të para...".

23 Pra, këtu tregohet që ka ndodhur inspektim i ushtarëve.

24 PË. Atëherë nuk kam qenë komandant për çështje morale-
25 politike; kam qenë komandant batalioni dhe komandanti i

1 batalionit normal që inspekton --

2 PY. Po.

3 PË. -- pikat e zjarrit. Jo veç kam inspektu, por kam luftu
4 bashkë me ta.

5 PY. Po, ishte gabimi im, në fakt. Ju kërkoj ndjesë. Kjo ka
6 qenë në periudhën kur ju keni qenë komandant batalioni, por
7 ajo që po përpiqesha të thosha është që ka patur edhe individë
8 të tjerë të cilët kanë qenë të përfshirë me punën e
9 inspektimit të njësisë, për shembull, e komandantit të
10 batalionit. Kjo ishte pozicioni i tij ose punë që duhet të
11 bënte apo jo?

12 PË. Ka pas ndoshta shëtitës mes zonave, prej një zone në --
13 ato kanë mujt me u qujt vizita private. Jo thjesht inspektime.
14 Të inspektosh duhet të kesh një normë, një detyrim që ta ka
15 dhënë dikush.

16 PY. Por në këtë dokument këtu referimi është inspektova
17 forcat e pozicioneve të para në atë faqe dhe ka edhe disa
18 referenca të tjera në këtë dokument dhe mund t'jua tregojmë
19 për inspektimin e këtyre zonave të caktuara. Pra, fjala që
20 është përdorur, të paktën në anglisht është "inspektova",
21 "inspektova vendet" apo "ushtarët".

22 Pra, ajo që po përpiqem të them është që është një rol
23 normal për një komandant batalioni që të kryejë këto lloj
24 inspektimesh apo jo?

25 PË. Shumë normale është, krejt siç është mbani shkrimin si të

1 tillë, nuk ndryshojmë asgjë.

2 PY. Dhe kjo për arsye se në qoftë se nuk bëjnë inspektime
3 atëherë ata nuk e dinë se çfarë po ndodh në batalion.

4 PY. Je i detyruar si komandant batalioni të jesh bashkë me
5 ushtarët, të shiqosh se çka bëjnë, t'i kontrollosh se çka
6 bëjnë, t'i inspekton, sa janë, ku janë, çka ju mungon, çfarë
7 veprimi do të ndodhë, kur do të vijojë ofensiva, si duhet
8 mbrojtur, si duhet luftuar. Këto janë detyra të një ushtaraku.

9 PY. Dhe kur ju keni qenë zëvendëskomandant i zonës më pas,
10 keni kryer -- ju është dashur që të bënit inspektime më pas.

11 Pra, pas datës 16 apo 17 mars '99?

12 PË. Më pak m'u ka dashtë mua të bëj inspektime për shkak se
13 kanë qenë përgjegjësitë e ndara më mira; kanë qenë komandantët
14 e brigadave; kanë qenë drejtoritë në nivel të zonës; ka qenë
15 komandanti i zonës ai që ka dalë ndonjëherë me bë inspektime,
16 Tahir Sinani, po pse jo edhe unë kam mund të dal edhe të shoh
17 një zonë apo një brigadë apo një njësi dikun. Shumë normale.

18 PY. Pra, komandantët e brigadës, komandantët e zonës dhe juve
19 vetë edhe deri te komandanti i batalionit kryenin inspektime
20 dhe kjo ka qenë mënyra normale apo roli normal dhe është edhe
21 në një ushtri apo jo?

22 PË. Nuk kisha dashtë t'i jepni aq shumë fuqi fjalës
23 "inspektim", se ka kuptimin, te ne, në gjuhën shqipe, të
24 shkosh t'i vizitosh, t'i shohësh se çka kanë, çka ju mungon,
25 çka ju duhet, çfarë gjendje janë, kanë armatim, në çfarë

1 pozicione janë, si kanë gjendjen edhe në strehim e në të
2 gjitha ato. Kjo është një lloj kontrolli, kontrolli që nuk
3 merr masa kurrfarë, por shkon për të marrë hallet e atyne që
4 janë atje në pozita më të vështira në vijë të zjarrit.

5 PY. Por në rast se një komandant batalioni e kryente këtë
6 punë dhe s'po them inspektim por një këqyrje -- ose vlerësim
7 atëherë komandanti do të duhet që ta raportonte këtë
8 komandantit të brigadës apo jo? Pra, në rast se del diçka nga
9 ky vlerësim, kjo punë vlerësuese që bëhet.

10 PË. Po. Hipotetikisht po ta them, nëse nuk ekziston
11 komandanti i brigadës ose brigada hiç, veç batalioni kujt i
12 jep? Kuptohet e bën për interesa të atij batalioni.

13 PY. Sigurisht. Po, domethënë, prezumimi ishte që pasi
14 ekzistuan brigadat dhe pastaj komandanti i brigadës natyrisht
15 që do t'i raportonte dhe komandantit të zonës, ishte ideja?

16 PË. Po, ashtu ka kuptim.

17 PY. Por ajo që po përpiqesha të thosha është që asnjë nga
18 këta individë me ç'dini ju kishte detyrime raportimi tek
19 inspektori i përgjithshëm apo jo?

20 PË. Jo, se nuk ka pasë vijë të inspektoratit të ishqujt
21 inspektorat, kish qenë inspektorat ai do të kishte inspektorë
22 nëninspektorët të njësive deri në batalione, skuadra. Por nuk
23 ka pas inspektorat. Ka qenë një njeri, një inspektor që u
24 qujt, e ka qujt veten apo e kemi qujt edhe ne të tjerët. Nuk
25 po e përjashtoj atë.

1 Po ai si individ ka shku, ka vizitu, ka vëzhgu, ka
2 kontaktu, ka kontrollu, ka pa gjendjen e mjerë apo të
3 mirëgenies të ushtarëve në të gjitha rrethanat e luftës. Kjo
4 ka qenë detyra e tij. Ju e keni klientin e juaj, pse këto s'jua
5 ka shpjegu deri tash?

6 PY. Ne jemi të interesuar që si e keni kuptuar ju këtë rol,
7 prandaj po jua bëj këto pyetje. Dhe natyrisht ju na e keni
8 dhënë shpjegimin tuaj të mënyrës se si e keni kuptuar ju
9 ndërveprimin me të dhe është shumë e qartë. Besoj që ju e
10 përmendët në fakt që ishin vetëm pak vetë, rreth 2-3 vetë që
11 ishin me z. Selimi. Por askush në fakt nuk erdhi që t'ju
12 prezantohej si anëtar i personelit të inspektorit të
13 përgjithshëm apo jo? Nuk është se ka ardhur dikush që të
14 thoshte, unë punoj për inspektorin e përgjithshëm në atë kohë?

15 PË. Tek unë ka ardhën një rast Rexhep Selimi dhe nuk është
16 paraqit si inspektor fare, por është paraqit si Rexhep Selimi
17 dhe unë e kam njoftë vëllain e Rexhep Selimit, Ramadan
18 Selimin, nga vitet e '80-ta, mos them '79 e këtej. Dhe më ka
19 ardhë mirë që jam taku me të. E kam pyet, "Ku don, ku po
20 shkon, çka ke dalë këne, çka ke ardhë këtu?". Tha "Du me dalën
21 nga zona e tjetër andej nga Maja e Zatriqit; më trego ka muj
22 me kalu që nuk kam forca serbe", se ne mbanim shënim edhe
23 mbanim nën kontroll lëvizjet e forcave serbe.

24 Unë i kam thënë, mbasi je veç veti i dytë je apo tre
25 vetë ishin, ia kam dhënë edhe dy ushtarë të tjerë që ta

1 ndihmojnë për të kaluen. Përkundrazi, kanë ra në pritë dhe
2 kanë bë luftë me forcat serbe dhe ajo luftë u shëndru në
3 ofensivë serbe kundër zonës tonë. Dhe unë pak u "idhnova" me
4 Rexhën. Po i thashë, "Pse bre më bëne bela këtu, çka u bo?".
5 Tha "Na s'patën faj, ramë në pritë". Po realisht ne e fituam
6 atë pritë; i dëmtuam shumë forcat serbe. Një kamion, një
7 autobлиндë i kthyem mbrapsht dhe ai u gëzu që na fitum dhe tha
8 mirë e ki, mirë se ju fituat tash. Kështu që ajo betejë ka
9 zgjat një orë e gjysmë, dy, nuk ka zgjat më shumë.

10 Ky rast është konë me Rexhep Selimin krejt ça kam pas në
11 luftë. Edhe unë e kam njoft si Rexhep Selim, si vëllai i
12 Ramadan Selimit, jo si inspektor. Absolut, as që më ka thënë
13 që, jam unë inspektori apo jo, por ne e kemi mësu prej të
14 tjerëve këtë farë pune më vonë, në fund të luftës e pas lufte.
15 PY. Pra, gjatë luftës ju nuk kishit dijeni që ai ishte
16 inspektor i përgjithshëm?

17 PË. Nga fundi i luftës, po. Po, po nga fundi i luftës, po.
18 Domethënë, mbas prillit e mas e dinim që ishte, por nuk është
19 paraqit asnjëherë me ardhë te ne, me thënë, unë jam
20 inspektori. Ja du me inspektu këtë çështje, du me kontrollu
21 diçka, jo. Në atë kuptim, jo.

22 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nëse mund të shikojmë një dokument
23 P650 dhe ERN-ja është U003-1744. Besoj që e keni parë këtë
24 dokument edhe më parë.

25 PY. Dhe këtë gjë e keni diskutuar në intervistën tuaj me ZPS-

1 në, në rast se ju ndihmon kjo me kujtesën. Nuk jam i
2 interesuar për përmbajtjen e këtij dokumenti, në fakt, fare.
3 Nuk më intereson,

4 Z. ROBERTS: [Përkthim] Por nëse është e mundur të kalojmë
5 te faqja e dytë e këtij dokumenti, e treta në fakt. Po, ajo
6 është faqja.

7 PY. Pra, këta janë individët të cilëve u drejtohet kjo letër.
8 A e mbani mend që e keni diskutuar këto me ZPS-së gjatë
9 intervistës tuaj?

10 PË. Po, po e kemi diskutu, e kemi sqaru.

11 PY. Dhe këtu thuhet në tri kopje: arkivit, inspektorit të
12 përgjithshëm dhe shtabit të përgjithshëm. A e kam kuptuar siç
13 duhet që në fakt kjo letër i ishte drejtuar z. Zyrapi, në
14 fakt, shefit të shtabit?

15 PË. Arkivi për ne don të thotë, arkivi i zonës ku ne i kena
16 ruajt materialet që kanë dalë prej zonës. Drejtuar inspektorit
17 të përgjithshëm është mendu që t'i drejtohem Rexhep Selimit,
18 por realisht iu është dhënë Bislim Zyrapi, shefit të
19 shtabit. Dhe kjo është kry me aq. Ky dokument ka shku në këtë
20 mënyrë. Nuk e di pse është i panënshkrum. Unë po e pranoj si
21 dokument tonin që kemi bë bashkë në nivel të zonës, me Halil
22 Qadrakun.

23 PY. Po përpiqem të shoh -- më falni do ta riformuloj pyetjen
24 --.

25 Unë e kam kuptuar dhe më thoni në rast se e kam gabim që

1 ju prisnit që Bislam Zyrapi të bënte diçka për përmbajtjen e
2 këtij dokumenti, është e saktë kjo?

3 PË. Sigurisht që menaxher, menaxher i gjithë luftës ka qenë
4 shefi i shtabit, por nëse s'kish mund vetë do të vepronte me
5 komandantin e përgjithshëm, me zëvendëskomandantin, po pse jo
6 edhe me inspektorin. Se nëse janë të njëjtës organigramë, të
7 njëjtës njësi, të njëjtës nivel, pse nuk duhet të bisedohej
8 kjo më gjerë?

9 Por ne e kemi kry shërbimin tonë, e kemi kry intervenimin
10 tonë, nëse kemi arrit njënin prej tyre, kujt do qoftë me ia
11 dhonë një dokument. Se s'kemi mujt t'i gjejmë të gjithë. Edhe
12 një të vetmin e kemi pas të vështirë ta gjejmë. Ndodh që
13 dokumenti është shkru dy javë përpara derisa keni mujt me
14 mbërrij deri te vendi. Ndodh që hiç s'e kena gjet personin e
15 kena lënë te Shtabi i Përgjithshëm rojave. Kena thënë, kur të
16 vjen ai jepja qët letër. Kështu ka ndodhun.

17 PY. Po, kjo tregon se sa e vështirë mund të ketë qenë për të
18 dërguar kërkesa deri në Shtabin e Përgjithshëm apo jo?

19 PË. Kanë qenë shprehjet të mëdha për shkak të kryengritjeve,
20 për shkak të luftimeve. Por një gjë duhet t'ju them që nuk ka
21 pas protokoll as zona jonë t'i protokollojë gjënat që ka
22 marrë, as Shtabi i Përgjithshëm nuk ka pas protokoll nëse kemi
23 çu ndonjë letër që me thënë, unë e mora, e sikur ju që e
24 vendosni atje te sekretaria me numër protokolli, nuk ka pas.
25 Nuk ka pas se ka qenë mobile, ka qenë në lëvizje vazhdimisht.

1 PY. Po. Dhe thjesht për të qenë të qartë. Ju keni vendosur
2 inspektorin e përgjithshëm dhe Shtabin e Përgjithshëm si të
3 veçanta, më vete. Pra, ju e kuptonit që inspektori i
4 përgjithshëm nuk ishte pjesë e Shtabit të Përgjithshëm në
5 momentin që keni shkruajtur këtë letër -- keni shkruar këtë
6 letër?

7 PË. Jo, ne kemi menduar kujtdo goftë prej këtyne që ia kishim
8 dhënë. Inspektorit të përgjithshëm, Shtabit të Përgjithshëm,
9 shefit të shtabit do ta krynin punën që njëni prej këtyne ta
10 merrte këtë letër. Nuk e kemi veçuar, nuk bëmë dallime ashtu,
11 as rolet e këtyne nuk i përcaktojmë ne.

12 PY. Dhe ju nuk e dinit që z. Selimi ka qenë inspektor i
13 përgjithshëm në atë moment, siç e përmendët, sepse kjo nuk ka
14 ndodhur deri në muajin prill, më duket.

15 PË. Ashtu është, ashtu është.

16 PY. Pra, ju thjesht -- e dërguat këtë letër me shpresën që
17 dikush të vepronte për të, por nuk e dinit fiks se kush ishte
18 në këtë pozicion?

19 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj. Iu bë pyetja më parë dhe
20 i dha përgjigje pyetjes dëshmitari.

21 Z. ROBERTS: [Përkthim]

22 PY. Përmendët pak më parë një ndërveprim në bisedë që patët
23 me z. Selimi kur në fakt ai ra në pritë.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Roberts, në fakt nuk
25 kemi shënuar këtu përgjigjen për pyetjen e mëparshme.

1 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, faleminderit, Gjyqtar --
2 Gjykatës.
3 PY. Pra, po përsëris pyetjen, Dëshmitar: "Ju e keni dërguar
4 këtë letër thjesht me shpresën që dikush do bënte diçka për
5 këtë gjë dhe nuk e dinit se kush", a është e saktë kjo? Se nuk
6 u shfaq në procesverbal.
7 PË. Ne, për neve ka qenë me rëndësi kushdo qoftë këta të
8 përmendurit apo ata që nuk janë të shënuar në letër, që i
9 takojmë Shtabit të Përgjithshëm, cilido që ta kish marrë këtë
10 letër për neve ka qenë e kryme si detyrë e jona me bo kërkesë.
11 PY. E kuptova. Atëherë le të vazhdojmë me incidentin që
12 shpjeguat për z. Selimi që po kalonte nga zona juaj dhe që ra
13 në pritë, siç e shpjeguat përpara pak minutash. Dhe ju i thatë
14 ZPS-së që i dhatë disa ushtarë atij kur ai ra në pritë, është
15 e saktë kjo?
16 PË. Pa ra në pritë akoma, unë i dhashë ushtarë me e
17 përcjellë, me i tregu rrugën. Edhe më duket se e shpjegova
18 mjaftueshëm.
19 PY. Dhe ai kërkoi ushtarë, por nuk ju urdhëroi që t'i jepnit
20 ushtarë apo jo? Kjo është e saktë se këtë i keni thënë ZPS-së.
21 PË. Jo, ai nuk kërkoi. Ai donte të shkonte vetë me atë dy
22 ushtarë që kish me veti, por unë e ndjeva të arsyeshme që
23 ushtarët e mi e njohin terrenin dhe ta përcjellin që mos të
24 bie në pritë. Edhe ishte prita e pashmangshme. Nuk kërkoi as
25 nuk dha urdhër. As nuk tregoi që është inspektor asnjë send.

1 Vetëm tha, "Dua të kaloj nga ana e Zatriqit në atë anë". Tha,
2 "Tregomë ku nuk ka forca serbe që mos të bie në forcat serbe".
3 Edhe unë ia bonë një vizatim në letër edhe ai u nis me shku
4 tha, "Prit mor merri edhe dy ushtarë të tjerë se të gjinden --
5 e njohin rrugën më mirë". Kaq.

6 PY. Por nuk ka sesi ai t'ju kishte dhënë urdhër që ju t'i
7 jepnit ushtarë. Pra, nuk mund t'ju kishte lëshuar juve urdhër
8 në atë pozicion post që kishit ju?

9 PË. Duhet pak logjikshëm ta kuptoni z. Avokat. Me pas qenë
10 ushtari më i thjeshtë, po don me kalu një rrugë, do me kalu
11 prej një kodre në kodër tjetër, ne e kemi përcjellë; e kemi
12 kriju mundësi që të kalojë mos bien në forca armike. S'ka të
13 bëjë kjo me nivelin e Rexhep Selimit, a ka qenë inspektor, a
14 ka qenë ushtar i thjeshtë. S'ka ajo logjikë s'ekziston.

15 PY. Keni shpjeguar edhe një vizitë në zonën e Pashtrikut dhe
16 kjo ka ndodhur pas vizitës së prillit. Dhe ju i keni thënë
17 ZPS-së që z. Selimi ka vizituar Brigadat 121 dhe 123. E mbani
18 mend këtë informacion që ia keni dhënë ZPS-së?

19 PË. Nuk e di. Ndoshta ka qenë po ajo kohë për të cilën kam
20 fol. Sa ashtu ka qenë dikun, mas mesit të prillit, e njëjta
21 gjë është ka përsëritet. S'besoj se ka qenë vizitë tjetër.

22 PY. Ndoshta po ta shfaqim në ekran mund ta sqarojmë këtë
23 çështje. Duke e parë mund të jetë më e lehtë.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] P708.6 është numri i Provës
25 Materiale dhe është intervista e ZPS-së e nëntorit 2022, i

1 datës 2 nëntor, Pjesa 6, faqja 19 në anglisht dhe faqja 20 në
2 shqip.

3 PY. A mund ta shihni, t'i shihni këto pyetje. Përgjigje të
4 cilat -- fillojnë dhe thuhet:

5 "Ai vizitoi të gjitha brigadat".

6 "PË. Unë e di që ai ka vizituar dy brigada".

7 Pra, fillon në rreshtin 2 në shqip dhe në 7 në anglisht.

8 Pra, në shqip faqja 20 dhe fillon në rreshtin 2 dhe, "Me sa
9 dini ju, ai e vizitoi të gjitha brigadat e zonës operative të
10 Pashtrikut?".

11 "Po, unë e di që dy brigada ka vizituar".

12 PË. Kjo është logjike që ai nëse ka qenë tek unë në nivel të
13 zonës në Nishor, Brigada 123 shumë afër komandës së zonës e ka
14 pas selinë e vet, domethënë, ai ka taku njerëz të Brigadës
15 123, por jo në atë mënyrë specifike komandën ta thërret ose ta
16 bëjë siç duhet bërë një ushtarak tash në rrethanat e sotme.

17 Por atëherë kanë qenë asisoj, e ka vizitu Brigadën 123 dhe në
18 kthim, pasi që u kthy në drejtimin e Brigadës 121 i kam thënë,
19 këto dy brigada mund t'i ketë vizituar dhe është shumë normale
20 nëse ka vizituar se me kënaqësinë teme edhe unë do t'i
21 vizitoja të gjitha.

22 PY. Dhe ju i keni shpjeguar këto vizita si vizita rutinore
23 dhe nuk është se e keni parë atë vetë apo keni folur me të
24 vetë në atë kohë, a është e saktë kjo?

25 PË. Ashtu është.

1 PY. Dhe brigadat të cilat ju mendoni që ai ka vizituar nuk ju
2 ka raportuar ju ndonjë gjë. Pra, për gjërat që ato -- po
3 mendoni që mund të ketë biseduar me Tahir Sinanin?

4 PË. Jo, ai nuk ka lënë ndonjë porosi të veçantë. Se me pas
5 qenë ndonjë porosi e veçantë edhe rëndësi e veçantë Tahir
6 Sinani e kish shtruar në brifing të zonës. Por ka qenë vizita
7 rutinore që nuk ka pas ndonjë diçka të veçantë.

8 PY. Të dyja këto vizita do të kenë ndodhur i bie ose në prill
9 ose pas prillit '99. Pra, prill, maj ndoshta edhe fillim
10 qershorit '99. Është e saktë kjo?

11 PË. Pas gjysmës së prillit, por nuk duhet që të jenë këto të
12 rrumbullakësuar se bëri dy vizita te dy brigadave. E
13 mundshmja ka qenë që ka bë se ishte tek unë dhe kthehej në atë
14 drejtim ka ishte Brigada 121. E mundshmja është që ka vizitu.
15 A ka vizitu a jo, ai e din vetë. Nuk mund ta specifikojmë, ta
16 bëjmë me ngjyrë të rrumbullakëta aty se e bënë këtë, e bënë
17 këtë. Se s'ishte ashtu.

18 PY. Sigurisht.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim] I nderuar, besoj që ndoshta është
20 edhe koha e duhur që të bëjmë pushimin e drekës, sepse dhe do
21 kaloj një çështje tjetër.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 Dëshmitar, tani do të bëjmë pushimin e drekës dhe ju do
24 të riktheheni në sallë në orën 14.30 për seancën e fundit. Dhe
25 mund të vijoni tashmë jashtë sallë me Sekretaren e Seancës.

1 Faleminderit.

2 DËSHMITARI: Faleminderit. Drekën e mirë të gjithëve.

3 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
5 çaktivizuar]

6 Rivijojmë në orën 14.30.

7 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.59

8 --- Seanca rifillon në orën 14.31

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
10 uleni.

11 Trupi Gjykses do të nxjerrë një urdhër me gojë lidhur me
12 riklasifikimin e provave të caktuara materiale, të cilat janë
13 parashtruar në kuadër të dëshmitarit W03825.

14 Trupi Gjykses është informuar që palët janë pajtuar
15 ndërmjet tyre *inter partes*, që prova materiale të caktuara, të
16 pranuar nga Dëshmitari W03825 mund të riklasifikohen si prova
17 materiale publike. Kështu që Trupi Gjykses urdhëron që provat
18 materiale P681, P682, P683, P684, dhe P686 të riklasifikohen
19 si prova materiale publike.

20 Ky është fundi i urdhrit me gojë të Trupit Gjykses.

21 Z. Sekretare, mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kam disa
23 dokumente që duheshin të pranohen si prova. Nuk e di në qoftë
24 se duhet që t'i përmend tani apo më vonë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] und ta bëni

1 tani.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Njëri nga dokumentet ka të bëjë me
3 librin që përmenda gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit.
4 Libri është SPOE00209321. Janë dy faqe që të pranohen
5 si prova materiale. Pra është faqja SPOE00209392 dhe
6 SPOE00209392.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faqja e
8 fundit ishte 9393?

9 Z. KEHOE: [Përkthim] Po, 92 dhe 93. Këto janë faqet e
10 atij libri. Dhe të dokumentit --

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një çast, ju
12 lutem. Nuk e di, libri është pranuar si provë materiale?

13 Z. KEHOE: [Përkthim] Pjesë të tij janë pranuar si prova
14 materiale.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për sa i
16 takon dokumentit SPOE00209321 ka ndonjë kundërshtim?

17 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
19 faqja 92 dhe 93 pranohen si prova materiale.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Ky është dokumenti i ZPS-së. Më
21 konkretisht është dokumenti SPOE00226697. Kërkojmë që pjesë të
22 këtij dokumenti, të cilat ne i diskutuam me dëshmitarin,
23 përkatësisht faqet SPOE00226707 dhe faqen pasuese,
24 SPOE00226708 të pranohen si prova materiale.

25 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim, të nderuar

1 Gjykatës, por në të ardhmen do të ishte më e thjeshtë që
2 dokumentet të kërkohen të pranohen si prova materiale ose pasi
3 bëhet pyetje dëshmitarit, ose në një kohë më të përshtatshme.
4 Domethënë, është më mirë që ta lidhni me pjesën e bërjes së
5 pyetjes dëshmitarit sesa të kërkoni pranimin e provave më
6 vonë, sepse është e vështirë për neve për të ditur për çfarë
7 dokumentesh po flisni konkretisht.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është e
9 vështirë që t'ju ndjek pak. Nuk e di është 226707, apo jo?

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Po. 07-a dhe 08-a.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
12 dokumenti SPOE002269779 [sipas përkthimit] në faqen 226707 dhe
13 226708 pranohen si prova materiale.

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Po këto janë faqet, kjo është e
15 saktë, Gjykatës.

16 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
17 këto faqe do të marrin numri e provës materiale 1D73.

18 Sa i takon librit, në qoftë se pajtoheni më këtë
19 zgjidhje, unë do të propozoja që ato të shtohen te prova
20 ekzistuese materiale, domethënë, te pjesët e tjera të librit
21 që kemi përdorur deri tani, dhe të marrin numrin P712.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
23 çaktivizuar]

24 [Dëshmitari vijon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë se

1 erdhët, dëshmitar.

2 DËSHMITARI: Faleminderit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] R. Roberts e
4 ka fjalën. Do të vazhdojë me pyetjet e tjera të mbetura për
5 ju.

6 Mund të vazhdoni, z. Roberts.

7 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
8 PY. Mirëdita, z. Halitjaha. Shpresoj që të përfundoj me
9 pyetjet e mia për rreth 30-40 minuta. Megjithatë, do ju
10 kërkoja që t'i përgjigjeshit pyetjeve të mia me "po" ose "jo"
11 në qoftë se është e mundur, në mënyrë të tillë që të ecim më
12 shpejtë. Pyetjet janë të formuluar në mënyrë të tillë në
13 mënyrë që u mund të përgjigjeni me "po" ose me "jo", por
14 sigurisht në qoftë se keni nevojë që të shtoni pak informacion
15 më tej, sakaq, bëjeni këtë gjë, por do e vlerësonim shumë në
16 qoftë se do të jepni përgjigje të shkurtra.

17 Z. ROBERTS: [Përkthim] Së pari, do i kërkoja Sekretares
18 që të paraqesë në ekran një pjesë të intervistës me ZPS-në, që
19 është prova materiale 707.3, që është intervista me ZPS-në,
20 Pjesa 3, faqet 30 deri në 31, në versionin në anglisht.
21 Ndërkohë që në versionin në shqip, është faqja 27. Do ju lexoj
22 një pjesë të shkurtër nga rreshti 22 në faqen 30, në versionin
23 në anglisht.

24 Ju kërkoj ndjesë, numri ERN është 08374 -- jo, e thashë e
25 gabim. Ju kërkoj ndjesë, të nderuar Gjykatës, një moment më

1 lejoni që ta kontrolloj. Është intervista e dytë, ju kërkoja
2 ndjesë. Ju kërkoj ndjesë edhe një herë, sepse e kam dhënë
3 gabimisht referencën e provës materiale të Prokurorisë.

4 Domethënë, është prova materiale 708.3 dhe jo 707.3. Edhe një
5 herë më falni për këtë. Për ta përsëritur, bëhet fjalë për
6 faqen 30 në anglisht dhe në faqen 27 në shqip.

7 Në qoftë se do të kalojmë në rreshtin 22 në versionin në
8 anglisht, dhe në se s'gabo, është rreshti 18 në versionin në
9 shqip.

10 PY. Do ta lexoj, ndërkohë mund ta ndiqni në ekran, dëshmitar.
11 Është pjesa e intervistës që i keni dhënë Prokurorisë.

12 "PY. Që ta kemi që qartë, Nexhmedin Krasniqi në këtë kohë
13 ishte komandanti i policisë ushtarake të zonës së Pashtrikut
14 në atë kohë, apo jo?

15 "PË. Po. Po."

16 Vazhdojmë te faqja tjetër.

17 "PY. Dhe Nezir Kryeziu ishte komandanti...

18 "PË. Ishte zëvendëskomandanti.

19 "PY. Zëvendëskomandanti i kujt?"

20 Përgjigja që jepni:

21 "PË. Është i policisë ushtarake."

22 "PY. Pra, dhe si të tillë ata të dy i raportonin Tahir
23 Sinanit dhe juve?"

24 Përgjigja që ju jepni ishte:

25 "PË. Jo, ata s'kanë qenë të obligum me më raportu mu.

1 Pra, ata i kanë raportu Tahirit, Tahir Sinanit. Por në mungesë
2 të tij, më raportonin edhe mua, kanë ardh me më raportu edhe
3 mua."

4 A e shikoni këtë pjesë, Z. Hajitjaha?

5 PË. E saktë, kështu siç e shkruan.

6 PY. Dhe kjo është e saktë, siç e thatë. Domethënë, kjo ishte
7 linja e raportimit. Ata i raportonin Tahir Sinanit, dhe në
8 qoftë se nuk ishte, ose mungonte Tahir Sinani për një arsye
9 ose një tjetër, atëherë ju raportonin juve. Kështu ishte?

10 PË. E qartë.

11 PY. Në dëshminë tuaj ju përmendni z. Sinani. Ju thoni që
12 Tahir Sinani ka filluar të punojë si komandant zonë në mes të
13 prillit. Por ai deri përpara asaj kohe, pra z. Krasniqi i
14 raportonte komandantit të zonës. Domethënë, i raportonte
15 komandant Drinit, përpara se ta të merrte situatën në dorë z.
16 Sinani, apo jo?

17 PË. Nuk ka qenë policia ushtarake e formësuar në kohën kur ka
18 qenë komandant Drini, akoma. Ka mund t'i raportojë, është në
19 rregull ashtu si e thoni ju. Tahir Sinani nuk është nga
20 prilli, por është nga 17 marsi, i caktuar komandant.

21 PY. Mendoj se thashë nga mesi i marsit, jo i prillit.

22 Atëherë, ju po thoni që nga mesi i prillit ka qenë komandant.

23 Ai i raportonte Tahir Sinanit, dhe besoj që këtë na e

24 ilustruat edhe me diagramin e parë më përpara.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Megjithatë mund ta shikojmë edhe

1 një herë tjetër. I kërkoj Sekretares ta paraqesë. Është prova
2 materiale P509, dhe që ka edhe një numër tjetër prove
3 materiale, që është P712. Mund t'ju jap numrin ERN të faqes që
4 dua që të paraqitet në ekran, që është SPOE00209330.

5 PY. Mund të shihni versionin në shqip në të majtë. Është
6 Nexhmi Krasiqi që i raportonte Tahir Sinanit, apo jo? Kështu
7 është?

8 PË. Po.

9 PY. Kjo vazhdoi deri në fund të luftës, apo jo? Domethënë,
10 kjo strukturë raportimi, nuk ndryshoi. Vazhdoi të ishte e
11 tillë deri në fund të luftës, kështu?

12 PË. Nuk ka pasur ndryshime strukturore.

13 PY. Do të lexoj atë çfarë ka thënë z. Krasniqi për të njëjtën
14 temë, sa për të konfirmuar.

15 Z. ROBERTS: [Përkthim] Dhe kjo jepet në dokumentin
16 SPOE0073210. Nuk është e nevojshme të paraqitet në ekran.
17 Megjithatë, z. Krasniqi, pra Nexhmedin Krasniqi, thotë --
18 Nexhmi Krasniqi, thotë si më poshtë:

19 "Menjëherë mbasi unë shkova atje, eprori im i
20 menjëhershëm ishte komandant Ekrem Rexha. Ai u vra në luftë në
21 vitin 2002. Pas lufte, në vitin 2002. Ai ishte komandanti im
22 dhe ai -- më pas, domethënë komandanti, u bë Tahir Sinani, i
23 cili më pas u vra në Maqedoni, pas luftës, në vitin 2002.

24 Përgjegjësia ime ishte që të respektoja urdhrat e Tahir
25 Sinanit dhe Sadik Halitjahës. Deri mbas lufte, këta ishin dy

1 personat të cilëve unë u kam raportuar.”

2 Domethënë, ai raporton që i ka dhënë llogari, ose i ka
3 raportuar edhe Tahir Sinanit, dhe kjo është në përputhje me
4 atë çfarë thatë juve, apo jo, dëshmitar?

5 PË. Një sqarim të vogël. Ai kur ka thënë se i raportoja
6 Drinit, nuk ka qenë komandanti i kompanisë së policisë, akoma.
7 Si individ, ose si grup shumë i vogël. S’ka qenë e formësuar
8 policia. Ta kemi të qartë. Kur ka thënë se i kam raportuar
9 Tahir Sinanit dhe Sadim Halitjahës, nuk ka nevojë raportet dy
10 vija. Në ushtri ekziston një vijë - vertikale. Ja mu, ja
11 atijna. Nëse i ka raportuar Tahir Sinanit, s’ka pasur nevojë
12 edhe mu. Nëse më ka raportuar edhe mua, s’ka qenë Tahir
13 Sinani, e ka kryer me mu. Pra të mos i ngatërrojmë këta të dy.
14 PY. Është shumë e qartë dëshmia juaj, në fakt. E thamë edhe
15 më përpara, që në qoftë se nuk ishte aty, në qoftë se nuk
16 ishte i pranishëm z. Sinani, atëherë ai ju raportonte juve. Ju
17 lutem, thojeni edhe një herë përgjigjen se po flisja edhe unë
18 në të njëjtën kohë.

19 PË. Po përpiqena të jem i saktë, saktë është edhe
20 organigrami, shihet me vija të ndërpreme rruga drejtë meje,
21 kur mungon komandanti, zëvendëson zëvendësi. Për atë caktohet
22 zëvendës-komandant, dhe Nexhmedini -- jo Nexhmedini por
23 komandanti i policisë ka pasur obligim komandantit të zonës.
24 Kushdo qoftë ai, t’i raportojë.

25 PY. Me sa dini ju, e njëjta gjë ka qenë për të gjitha zonat?

1 PË. Nuk kanë pasur të gjitha zonat një nivel të tillë të
2 organizimit. Duhet t'ju plotësoj se komandanti i togës së
3 policisë në nivel të brigadës i ka raportuar komandantit të
4 brigadës. Kjo mund të ishte si pyetje prej juve. Për zona të
5 tjera unë as nuk di, as nuk mbaj kompetencë, as kam
6 përgjegjësi, as kam mundur atëherë me dit me kalu prej zonës
7 në zonë tjetër. S'kam pasur asnjë detyrë. S'kam pse flas për
8 zona të tjera, por s'besoj se kanë pasur nivelin e tillë të
9 organizimit.

10 PY. E kuptoj. Nuk do ju pyes më lidhur me zonat e tjera. Por
11 kur thoni komandanti i togës që i raportonte komandantit të
12 brigadës, e keni fjalën për komandantin e policisë ushtarake?
13 Domethënë, të togës së policisë ushtarake që i raportonte
14 komandantit të brigadës? Për këtë e keni fjalën?

15 PË. Ashtu është. Ashtu.

16 PY. Të kalojmë te tema e fundit. E di që këtë temë e keni
17 diskutuar pjesërisht me kolegët e mi. Kjo temë ka të bëjë me
18 ndikimin e krijimit të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës mbi
19 Shtabin e Përgjithshëm, dhe strukturave të tjera ushtarake.
20 Nga dëshmia e dhënë prej jush, dhe në fakt këtë ja keni thënë
21 Prokurorit gjatë intervistës tuaj, që UÇK-ja ishte një
22 strukturë në lëvizje e sipër, në ndryshim e sipër, dhe nuk u
23 kompletua, ose s'u finalizua asnjëherë sepse lufta përfundoi
24 më herët se kishim pritur ne. Këtë e keni diskutuar në
25 vazhdimësi me kolegët e mi.

1 Qeveria e Përkohshme, e pamë besoj një dokument më herët,
2 një dokument të shkurtit që lidhet me marrëveshjen për
3 krijimin e qeverisë së përkohshme.

4 PË. Jo, dokumenti i shkurtit nuk është. Ju lutemi, shiheni
5 mirë, a dokumenti i prillit. Harruat aq shpejtë? Më vjen keq.

6 PY. Pra, besoj që ka pasur marrëveshje në prill - thotë
7 Avokati, dhe pastaj e korigjon dhe thotë: Kam përshtypjen që
8 marrëveshja ishte në shkurt dhe pastaj komunikata që bëri
9 njoftimin e krijimit të qeverisë së përkohshme është e 2
10 prillit të vitit 1999.

11 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares që të na e
12 shfaqte në ekran që ta shikojmë.

13 DËSHMITARI: Kështu është e saktë. Nuk kemi nevojë ta
14 shfaqim. Kështu është mirë.

15 Z. ROBERTS: [Përkthim]

16 PY. Më duhet që t'ju pyes për disa hollësi të tjera që
17 përmban ky dokument, kështu që duhet ta shohim. Këtu renditen
18 emrat e ministrave të ndryshëm të qeverisë së përkohshme. Te
19 pozicioni 4 kemi ministrin e rendit publik, Rexhep Selimin.

20 PË. Po.

21 PY. Mënyra si e keni kuptuar ju është që kur është krijuar
22 qeveria e përkohshme, individët që ishin anëtarë të Shtabit të
23 Përgjithshëm, i lanë, i lëshuan detyrat e tyre në Shtabin e
24 Përgjithshëm për t'u bërë anëtarë të qeverisë së përkohshme të
25 Kosovës, kështu?

1 PË. Ashtu ka ndodh, po nuk a dasht të lëshojnë se emërtimi
2 diku tjetër nuk e ka heq automatikisht, fizikisht prej
3 betejave dhe prej fushës së luftës, por janë marrë me punë të
4 krijimit të qeverisë. Kanë qenë punët e tyre, unë nuk kam pse
5 të përzihem. Rexhep Selimi ka qenë shumë meritator. Për mua
6 është një hero i gjallë. Ai ka qenë në fillim të luftës, deri
7 në mbarim të luftës. Asnjë minutë s'është ndarë nga lufta. Nuk
8 kam vërejtje pse ai është aty ministër. Shumë i meritum.

9 Por pse janë lënë punë të tjera në duart tona, kam
10 vërejtje shumë. Jo për Rexhepin, për të gjithë Shtabin e
11 Përgjithshëm.

12 PY. Kjo është një perspektivë ose një mendim që ju keni për
13 të gjithë Shtabin e Përgjithshëm, që ju në nivel zone u latë
14 që të trajtonit pasojat e gjërave që ndodhën në atë kohë dhe
15 besoj që këtë e trajtuat me z. Kehoe sot më herët gjatë ditës.

16 PË. E ezaurume është kjo punë. E kryme. E biseduam më herët.
17 Po, ashtu është. Jo unë në emër të të gjitha zonave, unë po
18 flas në emër timin këtu. Mendimi i është ai, konkret.

19 PY. Po. Kishte persona që ndryshëm që u larguan. Për
20 shembull, z. Selimi, z. Sylja, që u bë ministër i mbrojtjes, z.
21 Limaj, u bë zëvendësministër i mbrojtjes. A është kështu? A
22 është e saktë kjo? Nuk përmendet këtu në dokument, por thjesht
23 dua t'ju pyesja në qoftë se ju kujtohet që z. Limaj u bë
24 zëvendës i mbrojtjes. Ju kujtohet kjo, Dëshmitar?

25 PË. Më kujtohet, po z. Limaj në atë kohë ka qenë pej 1

1 prillit në Shqipëri për organizimin e operacionit "Shigjeta".

2 Këtë fakt e di sepse shoqëruesi im e ka përcjellë deri në

3 Maqedoni. Operacioni "Shigjeta" përfundon më 12 qershor, kur

4 përfundon lufta.

5 PY. Ai po e përgatiste si pjesë e detyrave të tij si

6 zëvendësministër i mbrojtjes, kështu? E saktë është kjo?

7 PË. Nuk e di a ka qenë i dërgum si zëvendësministër i

8 mbrojtjes apo si komandant i suksesshëm. Ai ka shku atje për

9 t'u bashkuar me organizimin e operacionit "Shigjeta", bashkë

10 me Bislum Zyrapin dhe komandantë të tjerë. Nuk kanë shku

11 bashkë. Veç e veç kanë shku, për ta pasur ju të qartë, por nuk

12 ka qenë në Kosovë prej 1 prillit.

13 PY. Në rregull. Ju thatë që z. Çeku pastaj e mori rolin në

14 prill të vitit 1999 dhe solli individë ose persona të tjerë në

15 Shtabin e Përgjithshëm, për të zëvendësuar disa prej këtyre

16 njerëzve që ishin larguar për t'u bërë pjesë e qeverisë së

17 përkohshme. A është e saktë kjo, dëshmitar?

18 PË. E saktë është.

19 PY. Nëse do ju përmend disa emra, domethënë ju pyes në qoftë

20 se ju kujtohet dhe në qoftë se mund të na thoni diçka lidhur

21 me tyre. Xhavit Sadia si pjesë e personelit? Ju kërkoj ndjesë

22 se e shqiptova keq, jam i sigurt.

23 PË. Xhavit Sadrija, mirë është. Në rregull është. Ashtu

24 është.

25 PY. Faleminderit. Ilmi Reqica?

1 PË. Nuk e di a ka qenë në atë kohë Ilmiu me Çekun, por e njoh
2 si emër dhe si njeri.

3 PY. Iliaz Dragoti?

4 PË. Iliaz Dragoti ka qenë i Llahushës, në komandë të
5 Drenicës. Nuk ka qenë në Shtab të Përgjithshëm. Je kah flet
6 tash për kohën e TMK-së, e ke kaluar kohën e luftës. Të lutem
7 kthehu pak te 12 qershori. Je kah flet për Shtabin e TMK-së,
8 jo të UÇK-së.

9 PY. Mbase mund të na ndihmoni me emra të tjerë të peronave që
10 ju e dini që janë kyçur në Shtabin e Përgjithshëm në atë kohë,
11 ndërmjet prillit dhe qershorit të vitit 1999.

12 PË. Po s'mund t'i kthejmë ata të TMK-së se në UÇK se është
13 kohë kaluese. Nëse flasim për UÇK-në, flasim për UÇK-në. Kur
14 kalon transformimin në TMK, atëherë flasim për TMK-në. Ilaz
15 Derguti ka qenë në Shtab të Përgjithshëm në TMK. Ilmi Reqica,
16 po. Nuk janë në UÇK. Në atë kohë që flisni ju, jo.

17 PY. A dini nëse ka pasur persona të tjerë të cilët kanë qenë
18 pjesë e Shtabit të Përgjithshëm në atë kohë, domethënë,
19 ndërmjet prillit dhe qershorit. Persona të cilët erdhën për të
20 zëvendësuar ata të tjerët që u bënë pjesë e qeverisë së
21 përkohshme?

22 PË. Nuk jam i detyrur me i ditë, po as që kam pas kohë me i
23 ditë. Na jena kanë në ofensivë çdo ditë, kemi pas operacione
24 luftarake. Sepse në NATO granatonte dhe forcat armike donin të
25 depërtonin te civilët tanë, që i mbronin. Me çdo kusht donin

1 që të vrisnin policë -- civilët tanë.

2 PY. E kuptoj. Duhet të ketë qenë situatë goxha e vështirë.

3 Thjeshtë po përpigem që të kuptoj marrëdhënien. Pra, Shtabi i
4 Përgjithshëm vazhdonte të ekzistonte, por ju nuk është se keni
5 pasur marrëdhënie të shumta ose të konsiderueshme me të gjatë
6 kësaj periudhe. Domethënë, në periudhën prill deri në qershor
7 të vitit 1999? Kështu? Po, apo jo?

8 PË. Kjo që thoni ju, nuk mund të them që s'ka pasur kurrfarë
9 kontakti, por shumë pak. Shumë pak kontakte me shtabin. Sepse
10 u vështirësu puna për shkak të ofensiva të mëdha serbe, dhe
11 nuk ishte Çeku me përvojën e Bislimit në terren më afër nesh.
12 Ai ishte diku, por ne nuk e kontaktonim -- ashtu.

13 PY. Dhe z. Çeku, në diskutim, nuk është se kishte përvojë të
14 mjaftueshme ashtu siç kishin komandantët e zonave, që kishin
15 luftuar për vite të tëra ose për një kohë të konsiderueshme në
16 ato role që kishin, apo jo?

17 PË. Z. Çeku kishte përvojën e Kroacisë dhe nivelin e kishte
18 edhe me gradat që kishte edhe me kulturën ushtarake, por nuk
19 kishte shumë përvojë të Kosovës dhe terrenin e Kosovës e
20 kishte të pashkelur. Nuk muj me thanë se Çeku ka qenë i
21 papërvojë. Çeku ka qenë i një niveli të duhur, dhe në vendin e
22 duhur.

23 PY. Më herët përmendët TMK-në. Kjo është formuar në shtator
24 të vitit 1999, dëshmitar, apo jo?

25 PË. Po, besoj se nuk është objekti i kësaj Gjykate TMK-ja.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04765 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts

Faqe 119

1 Nuk kisha dasht me u zgjat. Ju thatë do t'i biem shkurt, veç
2 "po", "jo". Çka u ba tash, nuk di? Nëse doni, zgjatemi sa të
3 thotë Kryetari i Gjykatës. Sa të keni qejf.
4 PY. Jo, thjeshtë e kisha lidhur me kohën. TMK-ja mendoj që
5 është krijuar më 21 shtator të vitit 1999, ose afërsisht në
6 këtë kohë, dhe në periudhën nga prilli i vitit 1999 deri më 21
7 shtator, komandantët e zonave kanë qëndruar në pozicionet e
8 tyre. Domethënë, zonat kanë funksionuar edhe pas luftimeve,
9 pas përfundimit të luftimeve në qershor. Domethënë,
10 komandantët e zonave vazhduan të qëndronin në pozicionet e
11 tyre, në postet e tyre në qershor, korrik dhe gusht. A është e
12 saktë kjo?
13 PË. Më vjen keq, kam shumë respekt për juve, z. Avokat, dhe
14 jeni simpatik, por nuk ka mund të vazhdojë lufta prej 12
15 qershorit deri në 20 shtator ose më 19 shtator. Çmobilizimi,
16 demobilizimi, çarmatimi, krejt ato procedura janë bërë se
17 luftë nuk ka pas prej 12 qershorit e mbrapa. Dhe nuk kisha
18 dasht asnjë fjalë ta flas mbas 12 qershorit. S'mbaj kurrfarë
19 përgjegjësie e as -- nuk e di pse e ngatërroni.
20 PY. Thjesht po përpiqem të kuptoj se cila ishte situata.
21 Pajtohem dhe e kuptoj plotësisht pozicionin tuaj që nuk kishte
22 luftë, nuk kishte luftime pas datës 12 qershor. Thjeshtë po
23 mundohem të kuptoj që çfarë strukturash ekzistonin atëherë.
24 Ishte për shembull ende Tahir Sinani në zonën tuaj, te zona
25 juaj, dhe pas kësaj date Tahir Sinani ishte komandant zone. A

1 është e saktë kjo?

2 PË. Jemi ndërruar. Komandant zone ka qenë, është ndërru ka
3 ardhur tjetër kush. Por pse ju duhen këto, a doni ju me
4 konkuru në TMK apo çka është në pyetje. S'e kuptoj unë çfarë
5 halli keni me TMK-në? Ajo tash është ndërru në FSK. A doni të
6 bëheni oficer, vërtetë, ju? Hallall.

7 PY. Mendoj që ditët e mia kur mund të bëhesha oficer kanë
8 kaluar. Thjeshtë po mundohem që të kuptoj strukturën në atë
9 kohë, në vitin 1999, dhe si zëvendëskomandant shpresoj që të
10 keni mundësi që t'i përgjigjeni pyetjeve të mia lidhur me këtë
11 periudhë. Pra, edhe në këtë kohë kemi një komandant zone dhe
12 kemi të njëjtat detyrime raportimi dhe detyrime dhe lidhje, si
13 me thënë, të cilat i kemi përshkruar gjatë asaj periudhe, edhe
14 pse nuk kishte luftime, njëlloj vazhdonin që të ekzistonin
15 detyrimet e raportimit që i shpjeguam pak më herët, apo jo,
16 dëshmitar?

17 PË. Pyesni më direkt, ju lutem, z. Avokat. Unë në atë kohë që
18 po flisni ju kam qenë në G5, në Shtab të Përgjithshëm të TMK-
19 së. Mëshoni pyetjet direkt, thatë do të pyetur me "po" dhe
20 "jo". Tash dredhje e përdredhje, një orë me fol kush kanë qenë
21 strukturat. Cila a relevanca me thanë?

22 PY. Do të përpiqem që të jem më i drejtpërdrejtë. Në qershor,
23 korrik, dhe në gusht të vitit 1999 a vazhduat që të kishit
24 takime me brigadat, për shembull me komandantët e brigadave? I
25 vazhduat takimet me ta në këtë periudhë?

1 PË. Në këtë periudhë është bërë koncentrimi i UÇK-së nëpër
2 vend stacionimet e tyre dhe është bërë çmobilizimi. Në radhë
3 të parë janë dorëzuar armët. Në radhë të dytë është ndryshuar
4 edhe uniforma e UÇK-së dhe struktura komplet, por ne e kemi
5 pasur një kontakt të vazhdueshëm për t'i ruajtur luftëtarët,
6 mos me u shpërnda pa u çarmatosur, pa u demobilizuar.
7 Përndryshe kishte një rrezik të anarkisë, që ata do të shkonin
8 nëpër shtëpitë e veta, ndoshta do të hakmerreshin, ndoshta ku
9 me ditë se çfarë do të bënin? Kështu ishte. Nëse doni ta keni
10 të qartë. Po ju pyesni konkret, pse po --
11 PY. Pra ende ishin strukturat ushtarake që po ndryshoni pak
12 nga pak ndërkohë që po çmobilizoheshin ushtarët në periudhën e
13 qershorit, korrikut, gushtit dhe shtatorit të vitit 1999, duke
14 përfshirë këtu edhe takime me komandantët e brigadave, besoj
15 për të kuptuar se si -- dhe për të diskutuar se si po shkonte
16 ai proces. Një nga temat që mund të jenë diskutuar?
17 PË. Do të përgjigjem me një "po" dhe do të provoj të jem
18 shumë i shkurtër.
19 PY. Po ishit shumë i qartë që pavarësisht kësaj gjëje, nuk
20 kishte rrezik që të rifillonin luftimet, sepse ju folët për
21 çmobilizimin dhe në fakt për ju ishte e qartë që konflikti
22 përfundoi më 12 qershor edhe pse strukturat ushtarake dhe
23 zinxhiri i raportimit vijoi edhe pas asaj date.
24 PË. Pas 12 qershorit Ushtria Çlirimtare e Kosovës asnjë
25 kompetencë nuk ka pasur në hapësirën e Kosovës përpos të

Dëshmitari: W04765 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 122

1 mbyllur nëpër vendqëndrimet e tyre. S'kanë pasur të drejtë të
2 dalin me armë, s'kanë pasur të drejtë të ndër marrin asnjë hap
3 sepse ka qenë KFOR-i, EULEX-i, UNMIK-u. Nuk e di pse e kërkoni
4 ju por kështu ka qenë.

5 PY. Faleminderit shumë, z. Halitjaha. Faleminderit, ky ishte
6 fundi i pyetjeve të mia.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
8 z. Roberts.

9 DËSHMITARI: Z. Gjykatës, një minutë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
11 çaktivizuar]

12 DËSHMITARI: Një minutë desha me thanë unë që mos ta
13 ngarkojmë shumë Gjykatën me këto zvarritje të mëdha, duhet të
14 flas për Jakup Krasniqin. Nëse Jakup Krasniqi ka ba gabime, ka
15 mundësi çdo njeri. Engjëll kurrkush s'jemi. Por nëse ai ka ba
16 faje, unë krejt do t'i marr përsipër. Veç ndërroni deklaratat.
17 Vendimet. M'i jepni mua. Unë e mbaj burgun e Jakup Krasniqit.
18 Le të shkojë në shtëpi.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni. Z.
20 Alagendra.

21 Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra:

22 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

23 PY. Mirëdita, z. Halitjaha. Unë quhem Venkateswari Alagendra
24 dhe jam Avokatja Mbrojtëse e z. Krasniqi. Kam pak pyetje për
25 ju.

1 Ju thatë që e dinit që z. Krasniqi ishte zëdhënësi i UÇK-
2 së. A është e saktë kjo?

3 PË. Po.

4 PY. Z. Krasniqi e ka luajtur këtë rol gjatë gjithë luftës?

5 PË. Unë e di që po. Jo gjithë luftës, se lufta ka filluar
6 shumë herët, por nga momenti që është shpallur i tillë, deri
7 në fund po. Deri sa ka kalu në qeverinë e përkohshme.

8 PY. Po, dhe në qeverinë e përkohshme ai ka vijuar duke
9 luajtur të njëjtin rol. Pra si zëdhënës. E kam të saktë këtë
10 informacion?

11 PË. Jo, jo, jo, jo. Çka ka lyp në Qeverinë e Përkohshme - a
12 kanë zëdhënësi i UÇK-së. S'ka pasur të njëjtën punë me bo.
13 UÇK-ja ka përfunduar më 12 qershor, ai ka vazhduar në qeverinë
14 e përkohshme. Nuk -- mos e ngatërroni kohën.

15 PY. E kisha fjalën zëdhënës i Qeverisë së Përkohshme. Është e
16 saktë kjo?

17 PË. Në Qeverinë e Përkohshme nuk ka qenë zëdhënës. Ju pyetni,
18 klienti juaj është. Po s'ka qenë zëdhënës. Zëdhënës ka qenë në
19 UÇK.

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nëse mund të shfaqim në ekran
21 dokumentin SPOE00054541 dhe është prova materiale 1D70, të
22 nderuar.

23 PY. Po, e keni dokumentin përpara, zotëri?

24 PË. Po.

25 PY. Poshtë numrin 9, nëse mund ta shihni dokumentin ju lutem.

1 PË. Ministri i pushtet lokal: Ramë Buja. Zëdhënësi i
2 qeverisë: Jakup Krasniqi. Nëse kështu paska qenë, unë nuk e
3 kam dit këtë fakt, dhe po më vjen shumë keq që pse të jetë në
4 këtë nivel kur ai ka meritë ndonjë ministër apo edhe
5 kryeministër.

6 PY. Dhe pas periudhës si zëdhënës në qeveri, për Qeverinë e
7 Përkohshme, z. Krasniqi u emërua si ministër i rindërtimit dhe
8 i zhvillimit. Është e saktë kjo?

9 PË. Po këtë e kam dit, për këtë po. A tjetrën nuk e kam mbaj
10 mend. S'e kam mbaj mend.

11 PY. Dhe ky -- kjo ka qenë në fakt edhe një emërim që bëhej
12 nga LBD-ja, jo nga UÇK-ja, apo jo?

13 PË. Emërimet e Qeverisë së Përkohshme i ka bërë Qeveria e
14 Përkohshme. E keni këtu kryeministrin e Qeverisë së
15 Përkohshme, Presidentin Hashim Thaçin, i cili e di sesi i ka
16 emëruar nëpër struktura të qeverisë.

17 PY. Nëse mund t'i referohemi numrit 7, në atë dokument në
18 ekran. Ministër i rindërtimit dhe zhvillimit dhe aty thuhet
19 LBD, apo jo?

20 PË. Këto janë kanë marrëveshje mes grupimeve që kanë përbërë
21 Qeverinë e Përkohshme. Nuk ka pasur parti të mirëfillta.
22 Partia që ka qenë më herët, edhe ajo s'ka qenë parti por ka
23 qenë një grumbull i madh i lëvizjes, LDK-ja, ata nuk e kanë
24 njohur, qeveria e ekzilit s'e ka njohur qeverinë e përkohshme,
25 dhe nuk u bashkëngjiti në bashkë qeverisje. E kanë njohur këto

1 partitë më të vogla, LBD-ja. Domethënë, aty e ka kuptimin që
2 vjen ky ministër i rindërtimit dhe zhvillimit nga LBD-ja, nga
3 ajo parti e vogël, për të cilat janë marrë vesh me qeveris
4 bashkë. Kështu e ka kuptimin.

5 PY. Po. Faleminderit. Do të vijoj. Zotëri, kur u intervistoi
6 Prokuroria ju u thatë që e kishit takuar dy herë z. Krasniqi
7 gjatë luftës. A e mbani mend ta keni thënë këtë?

8 PË. Po, sigurisht. Dy herë por nuk më kujtohen ndoshta të dy
9 herët, por e kam taku dy herë, jam i bindur që e kam taku.

10 PY. Në rregull, ja do flasim për ato dy takime. Takimi i
11 parë, ju thoni në deklaratën që i keni dhënë Prokurorisë, që
12 ka ndodhur në Divjakë, dhe thoni që z. Krasniqi ju dha një
13 vendim me anë të të cilit ju emëronte si zëvendës
14 ndihmëskomandant për moralin. E mbani mend këtë? Është e
15 saktë?

16 PË. Kjo është takimi i dytë. Takimi i parë është kur kam
17 ardhur unë në luftë, kam bërë një vizitë në fshatin e Jakup
18 Krasniqit, Negroc, dhe një mik i tij, që e kam pasur shok në
19 Zvicër, më ka lutur që të shkoj te ai me bujt atë natë. Unë e
20 kam pyetur a ekziston këtu, mbasi është fshati i Jakup
21 Krasniqit, Jakupi këtu. Më ka thënë "po" dhe kam shku me
22 gjithë atë mikun, dhe shumë kojshi të Jakupit. Kemi ndenjor
23 bashkë atë natë në shtëpinë e Jakup Krasniqit. Aty e kam
24 njohur për herë të parë.

25 Kjo është hera e dytë në Divjakë, që kam marrë atë

1 vendimin. Kam shku me dërgu një raport me ja çu Bislim
2 Zyrapit. Raportin e masakrës në Reçak, që është bërë lufta e
3 Reçakut, dhe nuk e kam taku atë. Kam taku Jakup Krasniqin.
4 Edhe ai më tha, prit pak se ke një vendim të shtypur për ty.
5 Kush e ka marrë atë vendim, kush është përgjegjësi unë nuk di,
6 po më është dhënë prej Jakup Krasniqit. Kjo është. Vendimi për
7 moral dhe politikë, në nivel të zonës. Akoma pa u bë unë
8 zëvendës komandant.

9 PY. Po, Okej. Kemi pak ngatërrim për datat në të cilat ju dha
10 juve ai dokument nga z. Krasniqi. Kështu që nëse mund ta
11 qartësojmë këtë pjesë ju lutem, me ju zotëri. Vizita e parë,
12 pra ju thoni ka qenë një vizitë kur ju keni shkuar në shtëpinë
13 e z. Krasniqi, është e saktë kjo?

14 PË. Po në qershor të vitit 1998.

15 PY. Në rregull. Dhe kjo ka qenë në Negrovc?

16 PË. Në fshatin e Jakupt Krasniqit në Negrovc.

17 PY. Nga i cili vjen z. Krasniqi?

18 PË. Aty ku jetonte ai, ku kishte shtëpinë.

19 PY. Në rregull, dhe diçka që pamë në procesverbal sot
20 paradite.

21 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Në faqen 21, rreshtat 7 deri
22 në 10. Nëse mund t'ia shfaqim dëshmitarit. Pra faqja 21,
23 rreshtat 7 deri në 10. Dhe ju na thatë që z. Krasniqi vjen nga
24 zona e Rahovecit?

25 PË. Jo, jo, jo. S'është kjo. As mund kurrkush ta thotë atë

1 punë. S'mund t'ia ndërrojmë ne vendbanimin për dëshira të
2 dikujt. Kurrë s'ka jetuar në Rahovec, Kurrë në jetën e vet.
3 Nuk e di a ka shkel në Rahovec. Jo.

4 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Domethënë, është gabim që e
5 shikojmë, të nderuar, në procesverbal. Thjeshtë për ta
6 sqaruar.

7 DËSHMITARI: Krejtësisht gabim. Unë s'e kam thënë, jo se
8 jo, por kush do që e ka thënë, nuk është e vërtetë.

9 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] [Mikrofoni i çaktivizuar]

10 PY. Prokuroria në nëntor -- ishte mikrofoni i fikur më
11 përpara -- kur u sqaruan disa çështje, ka qenë kohët e fundit,
12 në fakt, në datë 10 nëntor.

13 PË. Asgjë nuk kam kuptu fare.

14 PY. Në datën 10 nëntor ju jeni takuar me Prokurorinë dhe keni
15 disa çështje, ose ata kanë sqaruar disa çështje me ju. E mbani
16 mend këtë takim?

17 PË. Po.

18 PY. Dhe në ato shënime që janë mbajtur, ju keni përmendur
19 faktin që z. Krasniqi ka qenë në shtëpinë e tij në Negrovc,
20 dhe juve ju krijua përshtypja që aty -- ka qenë atje se donte
21 të kishin drita dhe internet në shtëpi. A e mbani mend këtë
22 gjë?

23 PË. Po, kështu kam thënë.

24 PY. E kam sqaruar këtë gjë me z. Krasniqi dhe tha që në vitin
25 1998 nuk kanë pasur internet në shtëpi. A mund të jetë e

1 mundur kjo?

2 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj, i nderuar, sepse natyra
3 e sqarimeve nga ky person nuk është e duhura.

4 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

5 PY. Më kanë informuar që në vitin 1998, në Negrovc nuk ka
6 pasur internet në të gjithë fshatin. Jeni dakord ju?

7 PË. Ka pasur drita dhe kompjuter. E kam thënë internet.

8 Ndoshta është gabimisht e shkruar. S'e kam thënë, se jam i
9 vetëdijshëm. S'kemi pasë as celularë në vitin 1998. S'ka pasë.
10 Edhe unë e di që s'ka pasë internet. E di krejt bota, në
11 Kosovë që s'ka pasë.

12 PË. Në rregull. Faleminderit. Tani dëshiroj të kaloj te
13 deklarata juaj.

14 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Dhe kjo është P078 [sipas
15 përkthimit], në faqen 20 deri në 21. Pra, P708.6, në versionin
16 shqip, dhe bëhet fjalë për faqen 22, rreshtat 3 deri në 10.

17 DËSHMITARI: Po urdhëroni, pyetja ç'është?

18 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

19 PY. Po.

20 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Po i referohem rreshtave 20,
21 deri në 25, edhe në faqen tjetër. Ndërsa në shqip rreshtat 3
22 deri është 10 në këtë faqe që kemi në ekran.

23 PË. Pyetja cila është? Po, po, të qartë unë e kam.

24 PY. E lexuat? Atëherë, sipas deklaratës tuaj, na thatë që
25 jeni takuar me z. Krasniqi në fund të nëntorit të vitit 1998.

1 Ky ka qenë takimi i dytë.

2 PË. Jo. Takimi i dytë ka qenë diku rreth 20 janarit, apo 22
3 janarit, pasi u përfundue lufta në Reçak. Masakra e Reçakut ka
4 qenë e kryer, ka fillu me 15 janar, 16, 17, 18, 19. Pasi u
5 krye kjo luftë unë kam shku dhe jam taku unë. Në Divjakë.
6 Tash, Kleçkë, Divjakë janë dy fshatrat të lidhme, me kah 20
7 shtëpi.

8 PY. Ju e keni lexuar dëshminë tuaj, deklaratën tuaj? Keni
9 pasur mundësinë ta lexoni atë? Deklaratën që i keni dhënë
10 Prokurorisë, të datës 2 nëntor të vitit 2022? Aty thuhet që
11 jeni takuar me z. Krasniqi në fund të nëntorit, dhe kjo ka
12 qenë hera e parë kur jeni takuar me të.

13 PË. Absolut këtë takim s'e mbaj mend unë hiç. Kush, qysh ka
14 ardhur ajo aty, nuk e di u e keni gjetur. Krejt çka i kam
15 thënë Prokurorit, krejt i pranoj si të vërteta dhe kjo nuk --

16 PY. Pra --

17 PË. Ka mundësi, *I am sorry* [Në anglisht], ka mundësi me u
18 kanë unë emëruar në atë kohë. A i takuar kur po them unë. Ka
19 mundësi, i emëruar në atë kohë me qenë si zëvendëskomandant
20 për moral dhe politikë në nivel të zonës. A i takuar jam diku
21 në rreth datës 20 janar. Kështu ka mundësi, kjo a korrekt.

22 PY. Dhe takimi ju thoni ka qenë rreth datës 20-22 janar?

23 PË. Po.

24 PY. Në rregull. Por ju e pranoni që jeni emëruar në datën 15
25 nëntor, në një takim në fakt që ndodhi në Brashanc si

1 ndihmëskomandant për moralin, apo jo?

2 PË. Vështirë e kam t'ju bëj ushtarë krejtve, oficerë. Shumë
3 zor e kam sqarimin. Thamë se emërtimi mundet me u ba një muaj
4 përpara, dy muaj përpara, ndërsa vendimi është më vonë. S'kam
5 faj unë se s'e kupton ushtrinë. S'je kanë ushtare.

6 PY. Por, në rast se mund të shikojmë një pjesë tjetër të
7 deklaratës tuaj.

8 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Në faqen 22, në anglisht, të
9 dokumentit P708.6, rreshtat 11 deri në 25, ndërsa në shqip
10 janë faqet 22 deri në 23, rreshtat 22, deri në 11 të faqes së
11 mëpasshme.

12 DËSHMITARI: Pyetja? Urdhëroni. Unë të qartë e kam.

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

14 PY. Kuptoj, sipas deklaratës që ju i keni dhënë Prokurorisë,
15 zotëri, thuhet:

16 "...Unë shkrova një raport për këtë betejën prej katër
17 ditësh dhe doja që të raportoja te Bislimi. Nuk e gjeta
18 Bislimin. Ja dorëzova raportin dikujt tjetër, që ishte aty.
19 Emri i tij ishte Avni. Ishte një tip nëpunësi..."

20 E mbani mend ta keni thënë këtë?

21 PË. Po, kështu është e vërteta.

22 PY. Dhe vazhdoni duke thënë:

23 "Në atë moment pashë, takova Jakupin. Ishte në oborr. U
24 takuam. Bëmë një bisedë prej rreth pesë minutash. Kishte të
25 bënte me gjendjen time shëndetësore, për betejën dhe luftën,

1 dhe si dhe gjërat që kishin ndodhur me civilët.”

2 Pra e shihni, kjo është, sipas deklaratës tuaj, kjo që
3 është takimi i dytë.

4 PË. Kjo është takimi i dytë. Është normal kështu. Krejt siç e
5 thatë ju.

6 PY. Dhe sot po na thoni që në këtë takim ju është dhënë ai
7 dokumenti nga z. Krasniqi?

8 PË. Po. Siç duket dokumenti ka qenë shumë herët aty. Veç më
9 ka thënë: “Prit, merre këtë me vete. Je kanë emëruar me kohë.”
10 Një gjë duhet ta kuptoni zonja avokate. Në ushtri ka urdhra me
11 gojë dhe me shkrim. Në ushtri ka emërime dhe vendime. Emërimi
12 mund me qenë shumë herët. Vendimi mundet të shkruhet shumë
13 vonë, ose s’ke -- ka mujt edhe mos me u shkru hiç fare, se
14 luftë a kanë. Mjafton me gojë me të emëru një epror që ti je
15 emëruar për q’atë detyrë. Dhe në këtë kuptim, mua më ka thënë
16 “ndal, prite se e ke vendimin.” Dhe e kam marrë q’atë letër në
17 dorë. Kështu ka qenë.

18 PY. Po në fakt ju e kishit luajtur rolin e ndihmëskomandantit
19 për moralin që prej nëntorit të vitit 1998, apo jo.

20 PË. S’du me u përgjigj më. Nuk përgjigjem më. Unë them dhjetë
21 herë se emërimi jem ka qenë prej dhjetorit. Vendimi u marr në
22 atë kohë. E keni të qartë apo s’e keni? Ju lutem përkthejani
23 anglisht dikush se s’a kah e merr vesh. Nuk a në rregull. Sa
24 herë duhet ta përsëris. Më thuaj. Dhjetë herë, njëzetë herë.
25 Po i lodhni këta njerëz të tjerë, jo mua.

1 PY. Ndjesë, por në procesverbal thuhet që ju u emëruat në
2 dhjetor. Tani, nëntor apo dhjetor. Thjeshtë që të jemi të
3 qartë edhe që procesverbali të jetë i saktë, ju lutem.

4 PË. Prej dhjetorit. Ose fundi i nëntorit. Se s'është datë e
5 saktë. Fillimi i dhjetorit, fundi i nëntorit. Ai vendim e ka
6 datën, po ai vendim u morr shumë vonë. Emërimi është fundi i
7 nëntorit, fillimi i dhjetorit.

8 PY. Dhe ky emërim ndodhi në një takim në Breshanc?

9 PË. Emërimi vetëm më ka ardhur si njoftim se je i emëruar
10 kështu, kështu. S'ka pasë nevojë takim, as mbledhje, as
11 konferencë, as kongres me majt për një vendim.

12 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Nëse mund të vendosim në ekran
13 dokumentin SPOE00226697 deri në 226716. Faqeve të cilat do t'u
14 referohem janë faqet 226714 dhe 226715 dhe janë njësoj edhe në
15 versionin në gjuhën shqipe.

16 DËSHMITARI: E kemi folu më herët. Është ezauruar kjo. Tre
17 herë është përsëritur qe kjo. Është e saktë. Siç është, është
18 puna. Mbajeni për vete kështu.

19 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

20 PY. Nëse mund të shkojmë te paragrafi 2 në versionin në
21 anglisht, të faqes 226715.

22 PË. Po, çfarë keni me pyetjen?

23 PY. A do të ishit dakord me mua që në këtë paragraf thuhet:

24 "Emërimi im, Sadik Halitjaha, ndihmëskomandant për
25 çështje moralopolitike në Brigadën 123."

1 A jeni dakord?

2 PË. Kalimi pej brigadës në zonë ka qenë tre javë ditë, tre
3 javë deri sa u themelua zona. S'ka pasë mundësi me ushtruar
4 edhe detyra asnjë ditë. Nuk jam prej atyne komandantëve që
5 marr përsipër detyra që s'i kam ushtruar unë. Nuk është ushtruar
6 kjo detyrë. Nuk është ushtruar. A kanë e mundshme me pasë mbetur
7 zonë -- brigada ma gjatë si brigada, mos me arrit me u bashkuar
8 nënzona apo zona. Unë kisha qenë në nivel të brigadës, me atë
9 detyrë që kam pas në nivel të zonës. Po kjo nuk u ushtruar në
10 nivel të brigadës. Se brigada u shndërrua në zonë për tre
11 javë.

12 PY. Po. Po të shikojmë një faqe më parë, kemi datën e takimit
13 si data 15 nëntor e vitit 1998, në faqen 226714. A e shihni
14 të, zotëri?

15 PË. Realisht me të thënë unë këtë takim nuk e mbaj mend fare,
16 por e pranoj materialin si temin dhe punoni me këtë material
17 ashtu siç është. Çka ju intereson, pyetje, vetëm pyesni.

18 PY. Sipas këtij dokumenti, emërimi ndodhi në nëntor të vitit
19 1998, 15 nëntor të vitit 1998. A mund ta sqarosh, a është e
20 saktë kjo?

21 PË. Shife më poshtë, e ke datën, 27 i të nëntit, 1998. Ku e
22 ke atë të tetorit, nëntorit? Ku e ke gjetur?

23 PY. Te versionin shqip --

24 PË. 15, po, 15.11.1998. Është diskutuar kjo punë, por vendimi
25 është marrë kah fundi i këtij muaji, ndërsa zona është bërë

1 menjëherë mbas tre javëve. Ka mujt me u diskutu. Unë nuk kam
2 qenë në këtë mbledhje. Nuk më kujtohet kjo mbledhje. Pa mua
3 është diskutuar. Unë s'kam qenë aty --

4 PY. Edhe ka kaluar shumë kohë, zotëri.

5 PË. Jo, jam i kthjellët kështu, shumë mirë jam i kthjellët.

6 Nuk kam harresa. Po unë sigurisht s'kam qenë në atë mbledhje.

7 Kam pasur ndonjë luftim diku dhe ku e di ku kam qenë. Se shumë
8 jam i qartë jam, shumë kthjellët i kam.

9 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Atëherë nëse mund të kalojmë
10 te materiali P707.1, dhe bëhet fjalë për faqen 21, rreshtat 12
11 deri 17. Në shqip bëhet fjalë për faqen 22, rreshtat 3 deri në
12 9.

13 DËSHMITARI: Ma jep versionin shqip ma nalt, çoje pak
14 përpjete këtë.

15 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim]

16 PY. Janë rreshtat 3 deri në 9 të asaj faqeje.

17 PË. Okej.

18 PY. Është në pjesën ku thuhet:

19 "S'më kujtohet që të kem bërë shumë raporte. Një apo dy
20 raporte, nëse kanë qenë me shkrim, dhe i janë drejtuar Jakup
21 Krasniqit."

22 PË. I vetmi raport është që kam dasht me ja dhanë Bislim
23 Zyrapit me datën 20 a 22, nuk më kujtohet saktë. E kam taku
24 Jakup Krasniqin aty, dhe biseda që u zhvillu me të. Reportin e
25 kam lënë në dhomën ku ka qenë punëtori teknik, s'e di si e ka

1 pasur emrin. Nuk jam kam dhënë Jakup Krasniqit, por kujt do që
2 ja kisha dhanë unë, në nivel të shtabit ose punëtori i
3 shtabit, apo roja e Shtabit të Përgjithshëm, për ne ka qenë
4 shumë normale se s'kemi mundur ti me prit me taku kur do
5 Bislam Zyrabin, Jakup Krasniqin, Agim Çekun, apo -- s'mundesh
6 se lufta nuk na ka dhënë atë komoditet ne me u taku, me
7 bisedu, me dhanë raporte, me na dhanë vulën e protokollit. Nuk
8 ka pasur fare protokoll.

9 PY. Pra, ju nuk raportoni te z. Krasniqi dhe as ndonjë
10 raportet tuaja nuk ja keni drejtuar atij. A është e saktë kjo?

11 PË. S'e kemi pasur as detyrë me raportu te ai. Kurrkush s'na
12 e ka ngarku atë detyrë. Nuk kam pas detyrë në.

13 PY. Faleminderit shumë, nuk kam pyetje të tjera.

14 PË. Faleminderit edhe prej juve.

15 Z. EMMERSON: [Përkthim] Përpara se z. Pace të bëjë
16 pyetjet plotësuese, do i kërkoja Trupit Gjykes që të merrej
17 me një prej provave materiale që z. Kehoe prezantoi të --
18 është një provë e re materiale, dhe ky është një dokument i
19 cili është përdorur gjatë kundërpvetjeve të Mbrojtjes. Mendoj
20 që pesë minuta janë mjaftueshëm.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
22 çaktivizuar]

23 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po pesë minuta mjaftojnë.

24 Do të doja që të paraqiten në ekran dy dokumente. Në të
25 majtë dua që të paraqitet dokumenti P712 dhe në të djathtë dua

1 që të paraqitet në ekran dokumenti 1D72. Atëherë, versionin në
2 anglisht në të majtë të ekranit, ju lutem. Dokumenti është i
3 sakti, vetëm thjeshtë do ju kërkoja që ta zvogëloni pak në
4 mënyrë që të shikoni të gjithë dokumentin në një faqe. Kjo
5 vlen për të dyja versionet. Për versionin në shqip dhe në
6 anglisht, dhe shikojmë plotësisht të dy dokumentet.

7 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Emmerson:

8 Z. EMMERSON: [Përkthim]

9 PY. Z. Halitjaha, këto janë dokumente në anglisht. Megjithatë
10 ju e njihni mirë organigramën tuaj, organigramën që keni
11 hartuar vetë, kështu që dua që t'i krahasoj këto dy
12 organigramat, dhe ose duhet të përdor dokumentin në anglisht,
13 ose në shqip. Kështu që dua që të përcaktoj afatin kohor, në
14 qoftë se më lejohet. Shikojmë në rend kronologjik se plani,
15 ose organigrama në të majtë, përshkruhet në fund që i takon
16 periudhës përpara konferencës së Rambujesë. Sigurisht që kjo
17 ka qenë çështje e rekordit publik, megjithatë besoj që është
18 rënë dakord ndërmjet palëve dhe kjo vjen nga transkriptimi i
19 datës 14 korrik të këtij viti, në faqet 104 deri në 105, që
20 datat për seancën e parë të Ramubujesë ishin 6 shkurt 1999,
21 deri më 23 shkurt. Dhe pastaj u bë një pauzë, ndërkohë që faza
22 e dytë ka qenë nga data 15 mars deri më 23 mars.

23 Pra, kur ju po përshkruani këtu periudhën përpara
24 konferencës së Rambujesë, e keni fjalën për periudhën që
25 përfundon ne 6 shkurt. A është e saktë kjo, se më datë 6

1 shkurt ka filluar konferenca e Rambujesë. Domethënë, është
2 përpara datës 6 shkurt, a nuk është kështu, dëshmitar?

3 PË. E saktë është.

4 PY. Megjithatë në qoftë se do shikojmë kolonën vertikale në
5 mes, shohim se nën komandantin e përgjithshëm, Azem Sylën dhe
6 zëvendëskomandantin dhe shefin e shtabit, jeni ju. Domethënë,
7 është pozicioni i juaj, ju e keni vetëvendosur veten nën
8 administratën J1. Domethënë, emri i parë këtu është Adem
9 Grabovci, dhe pastaj vjen emri juaj. Ju na thatë që ju keni
10 qenë në Shtabin e Përgjithshëm nga fillimi i janarit, apo jo?

11 PË. Nëse s'keni harruar, z. Emmerson, Avokat Emmerson, unë ju
12 thërras mirë në emër. Si duket ju s'mund t'ia qëlloni:

13 Halitjaha, Halalala. Unë kam qenë nga gjysma e dhjetorit deri
14 në 15 janar, në Shtab të Përgjithshëm, dhe q'atë pjesë nuk a
15 mund ndryshe mos ta -- mos ta pozicionoj në këtë formë. Dhe
16 isha në --

17 PY. Po.

18 PË. -- jo në J1-shin, kur ishte shef Adem Grabovci. Ademi ka
19 mungu pastaj, nuk ka qenë fare aty. Ku ka shku, nuk e di dhe
20 unë kam qendru. Deri më 15 janar, kur ka filluar masakra e
21 Reçakut.

22 PY. Nuk kemi shumë kohë, jemi nën presion kohe, por
23 megjithatë i takon që ne po flasim për periudhën nga fundi i
24 dhjetorit deri nga mesi i janarit, kur ju thoni që keni qenë
25 aty.

1 Pra flitet nga fundi i dhjetorit, deri nga mesi i
2 janarit. Për këtë periudhë kohe po flasim, apo jo? Për këtë
3 kohë po bisedojmë? Duhet të jetë kështu besoj, se jeni këtu,
4 z. Halitjaha.

5 PË. Po, z. Avokat. Po, z. Avokat, por organigrama nuk cakton
6 data. Veç etapat. Etapa para Rambujesë. Ka mund para Rambujesë
7 të llogaritet prej dhjetorit, prej nëntorit, dhe pas Rambujesë
8 deri në fund të luftës. E keni të qartë besoj.

9 PY. Po.

10 PË. Nuk ka të bëjë me datat.

11 PY. Do vijmë edhe te kjo pikë, por përderisa jemi këtu, në
12 organigramë, duhet të ketë qenë nga fundi i dhjetorit. Pra, po
13 shikojmë një periudhë që mund të jetë nga fundi i dhjetorit,
14 deri nga gjysma e parë e janarit. Domethënë, deri te masakra e
15 Raçakut. Apo jo?

16 PË. Kjo ishte qëndrimi im në Shtab të Përgjithshëm. Etapa e
17 organigramës është prej janarit, 1 janarit, e deri në
18 shkuarjen në Rambuje. Pas shkuarjes në Rambuje është kjo etapa
19 e dytë, organigrama e dytë. Edhe në shqip e keni kjo që është
20 versioni i dytë.

21 PY. Pra ta sqarojmë. Kjo zgjat, kjo organigrama e parë fillon
22 nga 1 qershori, deri në fillimin e Rambujesë. Domethënë, deri
23 më datë 6 shkurt. Kështu?

24 PË. Kështu do të ishte, prej 1 qershorit të vitit 1998, po të
25 ishte e mundshme, por s'ishte ashtu. Kjo diku, për afërsisht

1 këta njerëz që janë vendosur këtu, diku janë nga janari i
2 vitit 1998.

3 PY. Ju lutem përqendrohuni te pyetja që po ju bëj, se
4 përkundrazi do të harxhojmë shumë kohë. Pra, bëhet fjalë për
5 një periudhë një mujore. Domethënë, nga fillimi i janari, deri
6 më datën 6 shkurt.

7 PË. Ashtu, ashtu.

8 PY. Kjo përshkruhet, apo jo. Faleminderit, ndalojmë këtu.

9 Ju e keni vetë pozicionuar veten nën J1-shin, megjithatë
10 kjo vija horizontale me këtë vizën që shkon poshtë. Kjo nuk
11 sugjeron që ju keni qenë nën komandën e z. Veseli, apo jo? Apo
12 që ju edhe z. Veseli, le të themi, kenë qenë përgjegjës për
13 financën. Nuk është kjo ajo që doni që të thoni, apo jo?

14 Z. PACE: [Përkthim] Këto pyetje janë bërë në pyetje të
15 tjera, ku dëshmitari e sqaroi shumë mirë, domethënë, këtë
16 pjesën e shigjetave me shkëputje dhe pa shkëputje.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po mundohem që të sqarohem.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem mos
19 përsërisni.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim]

21 PY. Pra, edhe një herë pyetja. Ju nuk po sugjeroni që kemi të
22 bëjmë me një vijë ose linjë komandimi vertikale, apo jo, z.
23 Dëshmitar?

24 PË. Këto shigjeta bëjnë veç lidhjen e këtyne J-ve,
25 drejtorive, departamenteve. Unë jam --

1 PY. Shumë mirë.

2 PË. Unë, unë --

3 PY. Ndaloni, ju lutem. A e pranoni, e pranoni po them unë, që
4 duke marrë parasysh ajo që çfarë keni thënë ju, këto gjashtë
5 kategoritë, nga J1 deri në J6, duhet që të identifikohen
6 horizontalisht, të vendosen horizontalisht, jo vertikalisht. A
7 pajtoheni me mua lidhur me këtë?

8 PË. Pajtohem, se janë barazim janë horizontalisht. Nuk janë
9 vertikalisht. Se vertikalisht krijohet pabarazi. Por për punë
10 që me nzon faqja, një organogramë, e thamë edhe më herët, a
11 dashtë shumë organigrama për me e shpjeguar krejt këtë punë.

12 PY. Tani le të kalojmë te dokumenti i dytë që u paraqit nga
13 z. Kehoe. Atëherë, këtu përshkruhet siç thuhet në fund fare të
14 këtij dokumenti, që diagrami ka të bëjë me periudhën e
15 konferencës së Rambujesë. Ju thatë që z. Veseli nuk ka qenë i
16 pranishëm në periudhën e organigramës së parë. Megjithatë, ju
17 e keni të pasqyruar këtë si zbulim kundërzbulim. Domethënë,
18 përgjegjës për këtë pikë, si pjesë e organigramës. Ju thoni që
19 kjo organigramë ka qenë në fuqi në periudhën gjatë konferencës
20 së Rambujesë. Apo thoni që ka qenë në fazën e parë, domethënë,
21 nga data 6 deri më datë 23 shkurt, apo nga -- dhe në periudhën
22 e dytë, q ka qenë nga 15 deri më 23 mars? Domethënë, gjatë --
23 në cilën fazë të Rambujesë. Në fazën e parë apo në fazën e
24 dytë? Domethënë, kujt faze të Rambujesë i drejtohet, ose i
25 referohet kjo organigramë?

1 PË. Z. Avokat Emmerson, kjo organigramë ka qenë prej kalimit
2 të Rambujesë, që kanë shku kjo strukturë, deri më 12 qershor.
3 Zotin Veseli as e ka heq kurrkush, as e ka shkarku kurrkush.
4 Ka mbetur emri i tij se s'e ka zëvendësu kurrkush. E kuptoni
5 apo s'doni ta kuptoni? Po më duket sikur doni me nxjerr --

6 PY. Ndaloni një sekondë.

7 PË. -- sytë, jo vetullat me ja qit.

8 PY. Ndaloni për, pak ju lutem. Ju e keni përshkruar këtë si
9 periudhën e konferencës së Rambujesë, e cila ka zgjatur nga 6
10 shkurti deri më 23 mars. Unë po ju pyes se kur gjatë kësaj
11 periudhe, në çfarë periudhe, pra, i përkon kjo organigrama që
12 keni hartuar juve? Cilës periudhe i takon? Apo po thoni që
13 titulli është i gabuar, titulli i organigramës? Ne kemi Agim
14 Çekun si shef Shtabi -- më prisni një sekondë, ju lutem. Kemi
15 Sylejman Selimin që është komandanti i përgjithshëm, dhe siç e
16 shikojmë Azem Syla është larguar dhe është bërë ministri i
17 mbrojtjes. Kështu që a mund të na thoni, ju lutem, se në çfarë
18 periudhe gjatë konferencës së Rambujesë, me cilën periudhë ka
19 të bëjë kjo diagramë? Kujt periudhe i përkon kjo diagramë?

20 PË. Unë e kam sqaru shumë mirë. Juve e keni shumë të qartë,
21 por se çfarë po doni, veç ju e dini. Unë e kam sqaru shumë
22 mirë. Askush nuk është shkarkue.

23 PY. Jo, po ju pyes unë ju.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,
25 po përfundojmë se kemi edhe gjëra të tjera për të bërë, kështu

1 që ju lutem, thojani qëndrimin, bëjani pyetjen. Bëjani në
2 mënyrë të drejtpërdrejtë pyetjen.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim]

4 PY. Unë do ju sugjeroja që ky është një dokument i cili është
5 hartuar gjatë atij procesi. Sepse sikurse mund ta shijojmë në
6 dokumentin 1D70, që është dokumenti i fundit që e pamë në
7 ekran --

8 Edhe shumë pak kam, nuk do vonohem shumë.

9 PY. Është dokumenti 1D70. Është dokument që e keni parë nga
10 dy-tre herë, pra keni versionet në shqip dhe në anglisht.
11 Megjithatë, mund ta lexoni rreshtin e parë të këtij dokumenti,
12 dhe të dytin në shqip, dhe këtu do të shihni që kjo është
13 bazuar në marrëveshjen e arritur midis subjekteve politike në
14 Rambouillet, më datë 23 shkurt. Domethënë, në periudhën e
15 fundit, apo ditën e fundit të periudhës së parë të Rambujesë,
16 përpara se të bëhej pushimi.

17 Në qoftë se e shikoni listën, do vini re që Adem Grabovci
18 është ministri i financës dhe nuk është më në ashtu siç
19 pasqyrohet në organigramën tuaj, që është përgjegjës për
20 administrimin brenda Shtabit të Përgjithshëm. Dhe shohim
21 gjithashtu që edhe z. Veseli është ministër i inteligjencës, i
22 Shërbimit Informativ të Kosovës dhe ajo çfarë keni bërë në
23 këtë organigramë të dytë, mendoj unë, është që të keni
24 përzierë emërimet që në fakt janë bërë më datë 23 shkurt, me
25 një situatë ku ju nuk e dinit se çfarë po ndodhte. Kështu që

1 ju keni vazhduar me organigramën e mëhershme, të mëparshme.
2 Sepse është shumë e qartë nga lista që kemi këtu përpara,
3 krahasimisht me atë çfarë është hartuar mbështetur në një
4 marrëveshje të arritur më 23 shkurt të vitit 1999, gjatë
5 Rambujesë, që pra, kjo organigrama e dytë është thjeshtë një
6 lëmsh dhe nuk është një dokument i cili pasqyron situatën. A
7 pajtoheni?

8 PË. Po përgjigjem. Është e përzime në mendimin tënd. Nuk
9 është e përzime organigrama me listën tënde, se askush ata nuk
10 i ka shkarkue, e kupton. Për t'u heq ai prej atje -- pse e kam
11 heq veten unë prej atje, ku kam qenë te Adem Grabovci? Kam pru
12 kah poshtë në nivel të zonës? Sepse kam ndërru pozicionin.
13 Këta nuk i ka hequr kurrkush me asnjë vendim. Më tregon -- më
14 tregon Kadri Veseli apo cilido prej këtyne që janë në këtë
15 listën këtu, që me q'atë vendim është shkarku, është gabim
16 organigrami jem. Deri sa nuk ka pasur shkarkim prej kësaj,
17 kanë mjt ndoshta me lujt dy role, ka mujt me ardhun në Shtab
18 të Përgjithshëm sa herë ka dashtun ai, se s'ka pas njeri që e
19 ka zëvendësu tjetër. Ju lutem, por nuk -- a keni ju të qartë a
20 s'e keni. S'kam çka baj.

21 PY. Faleminderit.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

23 Keni pyetje plotësuese, z. Pace?

24 Z. PACE: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

25 Pyetje vijuese nga z. Pace:

1 Z. PACE: [Përkthim]

2 PY. Mirëdita, z. Dëshmitar. Dëshiroj që t'ju tregoj një
3 dokument që ju tregua edhe gjatë pyetjeve të Mbrojtjes.

4 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, është dokumenti
5 1D00071 dhe përfundon me ET në fund. Nëse është e nevojshme,
6 mund të jap edhe numrin ERN.

7 PY. Dëshmitar, të lutem shikoni dokumentin në të majtë, në
8 fillim të dokumentit, a e shihni që thotë që:

9 "... Shtabi i Përgjithshëm në takimin e vet të 5 janarit të
10 vitit 1999 nxjerr këtë urdhër ..." dhe pastaj thotë "URDHËR".

11 A e shikoni, Dëshmitar? E shikoni, Dëshmitar?

12 Gjatë kundërpjetjeve të Mbrojtjes sot, është faqja 58 e
13 transkriptimit në kohë reale, ju thoni:

14 "Nuk ka pasur asnjë takim, asnjë mbledhje më 5 janar. Unë
15 kam qenë aty në Shtab të Përgjithshëm. Ndoshta takimi ka
16 ndodhur diku tjetër. Nuk ishte e nevojshme që unë të kem ditur
17 çdo gjë. Mund të jetë mbajtur por aty nuk është mbajtur."

18 Gjithashtu, ju thoni në faqen 60 se sa i takon këtij
19 dokumenti, kjo është mënyra se si vepronte Drini në atë kohë.
20 Dua që të përqendrohemi te pika 1 deri në 3 e dokumentit që
21 keni përpara. Ju lutem lexojeni, dëshmitar, shiheni pak.
22 Ndërkohë që unë do të lexoj vetëm pikën e tretë. Atëherë
23 thuhet:

24 "Marrja në shfrytëzim e objekteve dhe e automjeteve nga
25 pika 1 dhe 2 e kësaj urdhërese bëhet me vendim të Shtabit të

1 Përgjithshëm ose me vendim të komandës së ZOP-së.”

2 Tani, Sekretare, dëshiroj që të tregoni një tjetër
3 dokument. Është nga lista e dokumenteve që ju treguan pak më
4 përpara. Në qoftë se nuk mund ta shfaqë sekretarja në ekran,
5 kemi edhe dokument të shtypur të këtij dokumenti.

6 Z. KEHOE: [Përkthim] Është dokument i ri ky? Me -- po
7 prezantoni dokument të ri, Prokuror?

8 Z. PACE: [Përkthim] Po, është një dokument i cili lidhet
9 me kundërpjetet. Lidhet me pyetjet e bëra prej Mbrojtjes, dhe
10 prandaj po prezantoj këtë dokument të ri.

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Kjo është e palejueshme, të nderuar
12 Gjykatës, nuk duhet të lejohet Prokuroria që të prezantojë në
13 dokument të ri tani, sepse ne duhet të kemi mundësi që të
14 shikojmë dokumentin.

15 Z. PACE: [Përkthim] Nuk ka asgjë të palejueshme. Avokati
16 i Mbrojtjes mund të bëjë pyetje për këtë dokument, në qoftë se
17 ka paqartësi lidhur me të.

18 Për Sekretaren, dokumenti për të cilën e kam fjalën është
19 SPOE00227677 deri në SPOE00227682. Ndërkohë versioni në
20 anglisht ka të njëjtin numër, përfundon me ET dhe do të doja
21 që të paraqitej dokumenti në faqen 678.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Më falni, të nderuar Gjykatës -

23 Z. PACE: [Përkthim] Besoj që ndërhyrja juaj u
24 kundërshtua.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë as nuk e

1 shfaq dot në ekran. Në qoftë se do bëjmë pyetje lidhur me këtë
2 dokument, të paktën duhet të kemi mundësi që ta shikojmë këtë
3 dokument. Të dimë se çfarë përmban ky dokument. Ky është
4 dokument i cili nuk është në listën e dokumenteve të
5 Prokurorisë. Sa herë që ne nuk jemi në një situatë të
6 ngjashme, kur nuk e kemi dokumentin në listën tone të
7 dokumenteve, Prokuroria kundërshton dhe ankohet. Kështu që
8 duhet që të kemi kohën që të shikojmë dhe të njihemi me
9 përmbajtjen e këtij dokumenti.

10 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ju vendosët
11 lidhur me të.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, kam
13 vendosur, mund ta përdorni dokumentin. Janë pyetje plotësuese
14 dhe dokumenti është pjesë e materialeve të Prokurorisë, apo
15 jo?

16 Z. PACE: [Përkthim] Po, është pjesë e dokumentit që sapo
17 kemi shtuar.

18 PY. Atëherë, Dëshmitar, ju kërkoj ndjesë për këtë diskutim.
19 Tani shikoni pak dokumentin në të majtë. Është dokumenti në
20 shqip. A e keni parë më herët këtë dokument, Dëshmitar?

21 PË. Edhe pak ngrite ma nalt ta shoh edhe fundin e dokumentit.
22 Tash më keni nxjerrë një tjetër dokument. Fjala ishte për
23 tjetër dokument ma herët. Tash është një dokument tjetër.

24 PY. E saktë, Dëshmitar.

25 Z. PACE: [Përkthim] Në qoftë se do të shikojmë fillimin e

1 faqes, pra me ç'kuptoj, Dëshmitar, nuk e keni parë më herët
2 këtë dokument, apo jo?

3 PË. Jo, jo, nuk e kam pa këtë, por --

4 PY. Po datën e a shikoni, që është në fillim fare, 5 janar,
5 1999? A e shikoni datën në këtë dokument, Dëshmitar?

6 PË. E shoh. Duhet të flas për dokumentin që ke ma parë, z.
7 Prokuror. Nuk e di a është procesu te Gjykata, dhe te
8 Sekretaria, por u fol sot mbasdite për dokumentin e tillë. Unë
9 dhashë vlerësimin, që thashë se koka e nënshkrime e Sylejman
10 Kollqakut.

11 PY. Dëshmitar, faleminderit, por pyetjet i bëj unë.

12 PË. Më falni edhe ju.

13 PY. Dëshmitar, ju lutem përqendrohuni te dokumenti te
14 dokumenti që keni përpara dhe jepini përgjigje pyetjeve që ju
15 bëj. Ju thatë që e shikoni datën 5 janar, 1999. A ju kujtohet
16 që kjo është e njëjta datë që është data që pamë te dokumenti
17 që kishte të bënte me takimin e Shtabit të Përgjithshëm, që
18 pamë para pak çastesh? A ju kujtohet kjo, dëshmitar?

19 PË. Datat janë të njëjta, por përmbajtja s'është e njëjtë,
20 dhe nuk është --

21 PY. Jo, Dëshmitar, faleminderit. Pyetja ime -- iu përgjigjët
22 pyetjes që kisha.

23 A e shikoni këtë dokumentin që keni përpara, që ai ka të
24 bëjë me një mbledhje të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe
25 përmendet Divjaka këtu. E shikoni këtë pjesë, Dëshmitar?

1 PË. Po.

2 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem uleni pak më
3 poshtë faqen. Të shohim pikën 4 të këtij dokumenti.

4 PY. A e shikoni që këtu thuhet:

5 "Marrja e vendimit për Mobilizimin e Automjeteve,
6 (xhipave, ekskavatorëve, e të gjitha mjeteve të tjerave për të
7 cilat kemi nevojë)" dhe këtu mbyllet kllapa.

8 A keni njohur lidhur me këtë, Dëshmitar?

9 PË. Nuk kam njohuri. Kam kundërshtim, edhe sot edhe atëherë
10 do të kundërshtoja, kush e ka dhënë të drejtë që Drini në emër
11 të Shtabit të Përgjithshëm dhe me nënshkrim të Sylejman
12 Kollçakut mbledh makina, xhipa, BMW-ja, dhe material të
13 popullit. Kjo është e padrejtë, krejtësisht dhe nuk është
14 zbatu kjo. Kjo veç ka qenë tentativë e tyne.

15 PY. Dëshmitar, ju e shihni që ky dokument ka të bëjë me të
16 njëjtat mjete, automjete të cilat i përmendët edhe juve, apo
17 jo?

18 PË. Po.

19 Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj që të kalojmë te dokumenti
20 tjetër, Sekretare e seancës. Dokumenti ka numrin e referencës
21 SPOE00226468.

22 Z. KEHOE: [Përkthim] Kemi të njëjtin kundërshtim. Nuk e
23 kemi parë këtë dokument. Nuk është në listën e dokumenteve ose
24 të materialeve të ZPS-së dhe i takon se kemi ndryshim
25 rregullash, se këtë nuk e kemi parë si dokument më herët.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
2 çaktivizuar]

3 Z. PACE: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju kërkoj ndjesë.
4 Edhe një herë po e përmend numrin e dokumentit. Është
5 SPOE00226468 deri në 6480. Në versionin në shqip dhe në
6 anglisht.

7 PY. Dëshmitar, në të majtë të ekranit ka një dokument që
8 është shkruar me shkrim dore. A e keni parë më përpara këtë
9 dokument, Dëshmitar?

10 PË. Jo, s'e kam parë. Nuk e kam parë. E ka datën 5 të parit,
11 1999.

12 PY. Dëshmitar, përsëri, a thatë 5 janar apo thatë 1 janar,
13 apo 5 janar?

14 PË. 5 janar.

15 PY. Se është 5 janar këtu përpara në ekran.

16 PË. 5 janar, 5 janar.

17 PY. Dhe kjo është e njëjta datë si data e dokumentit që pamë
18 më përpara, këtë dokumentin që ishte i nënshkruar nga Kollçaku
19 në emër të Drinit, për takimin e Shtabit të Përgjithshëm,
20 kështu?

21 Z. KEHOE: [Përkthim]

22 DËSHMITARI: Për të njëjtën mbledhje flitet, për të
23 njëjtën temë.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, një sekondë. Unë do
25 kundërshtoj, sepse po paraqiten këto dokumente që s'i kemi

1 parë asnjëherë dhe jo vetëm kaq, por i kërkohet dëshmitarit që
2 të japë dëshmi lidhur me të. Janë pyetje sugjestionuese.

3 Z. PACE: [Përkthim] Nuk ka asgjë sugjestionuese lidhur me
4 këto dokumente.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'i
6 përgjigjeni.

7 Z. PACE: [Përkthim]

8 PY. A ju kujtohet data e mbledhjes së Shtabit të Përgjithshëm
9 dhe e dokumentit të nënshkruar nga Kollçaku në emër të Drinit,
10 që e pamë më herët?

11 PË. Unë nuk kam parë asnjëri dhe nuk kam marrë pjesë në
12 mbledhje. Përndryshe, jam kanëë në Shtab të Përgjithshëm. Po të
13 ndodhte, do ta shihja dhe do ta dija.

14 PY. Dëshmitar, nëse shihni pikën 4 në dokument që keni në
15 ekran përpara. A e shihni që aty lexohet:

16 "Marrja e vendimeve për mobilizimin dhe për
17 automjetet..."

18 Ku thuhet:

19 (kamionë, ekskavatorë, xhipa, e të tjerë).

20 A ju kujtohet kjo, Dëshmitar, në qoftë se kjo është e
21 njëjta me materialin, dokumentin që ju tregua pak më përpara,
22 që është ai dokumenti që është nënshkruar nga Kollçaku në emër
23 të Drinit?

24 PË. I njëjtë është me materialin më përpara që e kemi kaluar
25 këtu. E kemi diskutuar, nuk e di a është procesu ai material.

1 Po habitem, avokatët thonë "S'e kena pa". U diskutu sot
2 pasdite ai material, më herët, dhe jam në kundërshtim me këto,
3 grumbullimin e këtyne mjeteve. Nuk e di për ku kanë dashtë t'i
4 dërgojnë, apo ndoshta ka qenë etje për përfitime, profiter të
5 luftës. Përndryshe, nëse kanë mendu për mobilizim, të gjithë
6 popullsisë - diçka tjetër. Por nuk jam me këtë dokument, as
7 atëherë s'isha kanë dakord, as sot.

8 Z. PACE: [Përkthim] Do të vazhdojmë më tej. Sekretare e
9 seancës, a mund të jepni provën materiale P164.80-ET [Sipas
10 përkthimit]. Numri i provës materiale është ERN002-0800, dhe
11 më tej U002-2802.

12 Për të pranishmit në sallë, do i referohem transkriptimit
13 të djeshëm nga faqja 10196 deri në 10197.

14 PY. Dëshmitar, sa i takon këtij dokumenti, dje ju thatë ky
15 nuk është dokumenti juaj, nuk është nga zona operative e
16 Pashtrikut, nuk e keni parë gjatë luftës, dhe nuk ka qenë
17 asnjëherë dokument i vlefshëm. A ju kujtohet që e keni thënë
18 këtë dje, dëshmitar?

19 PË. Kështu e kam thënë unë. Ky dokument u gjet në arkivin e
20 TMK-së pas lufte, në Prizren. Për mua nuk ka qenë i ditur, as
21 i vlefshëm.

22 Z. PACE: [Përkthim] Zonja Sekretare, hiqeni këtë dokument
23 dhe do ju kërkoja që të shfaqni në ekran dokumentin P0707.3-
24 ET, përkarshi P0707.3-AT. Në të majtë ju lutem shfaqni
25 versionin në shqip, dhe në të djathtë versionin në anglisht.

1 PY. Dëshmitar, ky është një pjesë e dëshmisë me ZPS-në në
2 vitin 2020, që përshkruan dokumentin që sapo patë, dhe për të
3 cilin ju bënë pyetje nga ekipet e Mbrojtjes. Do të filloj të
4 lexoj në versionin në anglisht nga faqja 9, rreshti 21 dhe në
5 shqip nga faqja 8 e më poshtë. Juve ju bëhet kjo pyetje:

6 "A ju kujtohet që të merrnit këtë botim për luftën
7 speciale?" Ju thoni:

8 "PË. Më lejoni pak çaste sa t'i hedh një sy."

9 "PË. Po, nuk më kujtohet se në qoftë se e kam lexuar apo
10 e kam shkruar."

11 "PY. Nuk ka problem."

12 "PY. Ajo që shkruhet këtu mund të jetë dhënë -- mund të
13 krem qenë unë që e kam shkruar. Mbase e kam shkruar, por nuk
14 më kujtohet. Nuk kam asgjë kundër kësaj, por kam të njëjtin
15 opinion sot, sepse serbët e kanë ndërtuar shtetin mbi bazën e
16 rrenave, të mashtrimeve."

17 A ju kujtohet ta keni thënë këtë, Dëshmitar?

18 PË. Ndoshta e kam thënë kështu, por dokumenti është shumë më
19 përtej kësaj. Është krejtësisht ekstrem dhe është ngjyrosje
20 ideologjike. Unë as e kam përdorur, as e kam e kam njohur më
21 përpara, pos atëherë kur ma keni tregu ju në Prokurori. Dhe u
22 konstatu se është i nënzonës së Llapit. Në fund e ka të
23 shkruar "Nënzona e Llapit".

24 PY. Dëshmitar, a mund ta sqaroni për Gjykatësit, se pse në
25 vitin 2020, kur ju është treguar ky dokument, ju keni thënë që

1 mund ta keni shkruar ju që nuk keni asgjë kundër këtij
2 dokumenti, por ndërkohë, gjatë kundër pyetjeve dhe tani që ju
3 bëra pyetjet, ju duket sikur doni të distancoheni nga ky
4 dokument? A mund t'ia shpjegoni dot Gjykatësve pse është ky
5 qëndrim i ndryshëm sot?
6 PË. Tema që ka qenë unë, për çështjet morale dhe politike,
7 kam mendu që të mos jem unë autori. Tani, ai vërtetohet dhe
8 nuk e di pse duhet të jetë në dyshim, kur shihet poshtë në
9 fund është që nënzona e Llapit, edhe besoj që jam sqaruar.
10 S'është dokument i imi, s'e kam pas në dorë gjatë luftës
11 kurrë. Është gjet në arkivin e TMK-së në Prizren. Është i
12 LKQK-së. Me lexu të gjithë dokumentin, tregon se është
13 organizatë që ka qenë në kohën e paraluftës: Lëvizja Kombëtare
14 Çlirimtare e Kosovës."

15 Nuk jam unë kah distancohem, po realiteti a ky.

16 Z. PACE: [Përkthim] Do të kaloj në temën e fundit të
17 pyetjeve.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet që të
19 largohemi fiks në orën 16.00, sepse disa prej kolegëve,
20 personelit të Gjykatës, duhet të shkojnë diku tjetër. A mund
21 të përfundoni tani?

22 Z. PACE: [Përkthim] Do të mundohem.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
24 çaktivizuar] Mbas pushimit.

25 Z. KEHOE: [Përkthim] Jo, nuk ka pushim.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbas dy
2 javësh.

3 Z. PACE: [Përkthim] Pra, sado që të përpiqemi, nuk do të
4 përfundojmë sot apo nesër, kështu që dëshmitari do të duhet që
5 të vijë përsëri.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

7 Z. PACE: [Përkthim] Në atë rast i takon që nuk ka
8 problem, duhet të përfundojmë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendova që
10 do përfundonim, por ka persona, siç e thashë, që duhet që të
11 largohen nga këtu, kështu që --

12 Ka një urdhër të propozuar që është P682. Trupi Gjykues
13 vëren se duhet që të bëhet një korigjim. Sa i takon provës
14 materiale P682, dhe ERN-ve të pranuar në këtë provë më datë 7
15 nëntor të vitit 2023, nuk ishin të sakta. Referenca e
16 transkriptimit është P9516, në rreshtat 12 deri në 15.

17 Faqet janë SITF00055872 dhe SITF00055873, të cilat duhet
18 të ishin pranuar si prova dhe jo dokumenti SITF00055783 dhe
19 SITF00055877.

20 A dëshironi të komentoni lidhur me këtë, z. Prokuror?

21 Z. PACE: [Përkthim] Jo, faleminderit, të nderuar
22 Gjykatës.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
24 Si rezultat, Trupi Gjykues korigjon procesverbalin që është
25 prova materiale P682, për të përfshirë faqet SITF00055872 dhe

1 SITF00055873, dhe jo faqet të cilat janë përmendur më 7
2 nëntor.

3 Ky është fundi i urdhrit gojor. Do të mblidhemi përsëri
4 në orën [sipas përkthimit] 4 dhjetor, në orën 9.00.

5 Por përpara se ta mbyllim, do të largoheni. Përfunduar me
6 ditën e sotme, por do të duhet që të ktheheni përsëri më datë
7 4 dhjetor. Faleminderit për praninë tuaj sot. Faleminderit për
8 durimin dhe do të shihemi përsëri më datë 4.

9 Mund të largoheni nga salla e gjyqit.

10 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam një
11 dokument që dua që të regjistrohet si provë materiale.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta
13 regjistrojmë, do ta mbajmë shënim kur të kthehemi.

14 Z. PACE: [Përkthim] Ju lutem, Gjykatës, duhet t'i thoni
15 dëshmitarit që të mos flasë me asnjëri për dëshminë e tij.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Besoj se e di
17 kaq gjë dëshmitari.

18 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
20 përfundon këtu.

21 --- Seanca mbyllet në orën 16.01

22

23

24

25